

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

NDËRGGJE GJE NË QELIZË

HARUN JAHJA
(Adnan Oktar)

Përktheu në shqip nga anglishtja:
Halit Beka (Methasani)
Nëntor, 2013

Sjellë në shqip nga: *Halit Beka (Methasani)*

0

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Versioni anglisht botuar në shkurt 2006

Consciousness in the cell

Botuar nga

GLOBALPUBLISHING

Talatpaşa Mah. Emirgazi Caddesi

Ibrahim Elmas Is Merkezi

A Blok Kat 4 Okmeydani - Istanbul

Tel: (+90 212) 222 00 88

Shtypur dhe lidhur nga

Entegre Matbaacilik in Istanbul

Sanayi Cad. No: 17 Yenibosna-Istanbul

Phone: (+90 212) 451 70 70

Të gjitha përkthimet nga Kur'ani janë prej

Kur'anit Fisnik:

Një Pasqyrimi Ri i domethënies së tij në anglisht prej

Haxhijve Abdalhaqq dhe Aisha Bewley

Botuar prej Bookwork. Norwich, UK. 1420

CE/1999 AH

Shkurtime të përdorura:

Pbqmt- paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, që pason referencat ndaj profetëve.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Besimi në darvinizëm kërkon braktisjen e logjikës dhe mençurisë.
3. Mjeti në trupin tuaj që mund të kopjojë një milionë faqe të dhënash për 20 minuta.
4. Përsosmëria e ADN-së I kundërvihet teorisë së evolucionit
5. Trajta e qelizës kundërshton teorinë e evolucionit
6. Si e njohin qelizat njëra-tjetrën?
7. Të dhëna shpjeguese të ekzistencës së Zotit mund t'i çlirojnë njerëzit nga besimet jofetare.
8. Rafineria e naftës në trupin tonë.
9. Energjia e jetës në qelizat tuaja: Molekula Trifosfat Adenosinë (ATP)
10. Kush e drejton trafikun e ngjeshur të qelizës?
11. Mëlçia si një laborator gjigand
12. Qelizat që vetëvriten për ta mbrojtur trupin nga cënimi.
13. Mjetet bakterie-shkatërruese në mëlçi.
14. Ti kurrë nuk e kontrollon frymëmarrjen, sepse disa prej qelizave e kryejnë atë për ty.
15. Qelizat tuaja mund të bëjnë çka t'i s'mundesh dot.
16. Jeta juaj vazhdon për shkak të ndarjeve të ndërgjegjshme të punës së qelizave tuaja.
17. Që të ndodhin gjërat në qelizat tuaja, lypset njohuri.

18. Kur ha sheqer, një fabrikë e madhe në trupin tënd futet në punë.
19. Provë e qartë e krijimit: Veshkat që dallojnë mes glukozës, proteinës dhe natriumit.
20. Ç'ndodh në trupin tënd kur presioni i gjakut bie.
21. Ndërgjegja e sistemit të qarkullimit.
22. Oksidi i natriumit: Molekula e mrekullisë që hap enët e gjakut.
23. Vetëm një shembull mjafton për të provuar gjepurat e Darwinizmit.
24. Çdo proteinë e veçantë në trupin tuaj ka një dizajn të patëmetë dhe detyra jetike.
25. Enzimat që identifikojnë gabimet.
26. Besimi në Darwinizëm është aq logjik sa edhe besimi në përrallën e Zanave.
27. Enzimat kanë ndërgjegje, dituri dhe aftësi.
28. Planifikimi i shkathët dhe prodhimi i kryer nga qelizat e kockës.
29. Harmonia mrekulluese në krijim kundërshton Darwinizmin
30. Hemoglobina – Gjuetari i oksigjenit të gjakut.
31. Qimet e imëta në sistemin e frymëmarrjes përcaktojnë drejtimin pagabueshëm.
32. Ajo çka do të lexosh tani ndodh në trupin tënd, mu këtë çast.
33. Enzimat Lisozome në shërbim të trupit.
34. Ç'mrekulli e madhe është të frymosh!
35. Rrjeti i ndërlikohjes mes qelizave.

36. Burimi i dhimbjeve të lindjes dhe qumështi i gjirit: Një hormon i prodhuar në tru.
37. Po sikur kurrë të mos ndjenit etje?
38. Hormonet – molekulat që mund të dallojnë mes gjinive.
39. A mundet vallë që fuqia pas veprimeve të ndërgjegjshme të një qelize t'i përkasë një hormoni që nuk di për ekzistencën e vet?
40. Asnjë formulë nuk mund të dalë vetvetiu, prej rastësisë.
41. A mund të kenë veshkat tuaja njohuri mjekësore?
42. Hormonet që refuzojnë Darwinizmin.
43. Mushkëritë kanë repartin e tyre të vet të mbrojtjes urgjente.
44. Po të mos ishin enzimat, ty do të duheshin 40.000 vjet për ta lexuar këtë.
45. Antitruapat mund të luftojnë mikrobe që ata s'i kanë takuar kurrë më parë.
46. Qelizat e sistemit të imunitetit janë krijuar me kujtesë të madhe.
47. Në çka shikoni – por që nuk mendoni për të- ndodhe njohuritë e pafund dhe mrekullitë.
48. Hollësitë e madje edhe molekulave janë të mjaftueshme për të shkatërruar teorinë e evolucionit.
49. Jeta juaj mvaret nga diçka aq e hollë sa një fije pambuku.
50. Rrjeti më i ndërlikuar i botës ndodhet në trurin tonë.

51. Gjithçka mëson është një shembull i madhësisë së krijesës së Zotit.
52. Mashtrimi i evolucionit

DY FJALË LEXUESIT

Një kapitull i veçantë i është kushtuar rrëzimit të teorisë së evolucionit sepse kjo teori përbën bazat e të gjitha filozofive antispiritualiste. Mbase Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit – e kësaj ekzistencën e Zotit – gjatë 140 vjetëve të fundit kjo ka bërë që mjaft njerëz të braktisin fenë e tyre ose të bien në dyshim. Prandaj është një shërbim i domosdoshëm, një detyrë e rëndësishme për t'i treguar gjithkujt se kjo teori është një mashtrim. Meqenëse disa lexues mund të gjejnë rastin të lexojnë vetëm një prej librave tona, ne e mendojmë të përshtatshme t'i kushtojmë një kapitull për të përmbledhur këtë temë.

Të gjithë librat e autorit i shpjegojnë çështjet që lidhen me fenë në këndvështrimin e ajeteve kuranore, dhe i fton lexuesit të mësojnë fjalët e Zotit dhe të jetojnë prej tyre. Të gjitha subjektet që lidhen me ajetet kuranore janë shpjeguar në atë mënyrë që nuk lënë dyshim apo vend për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i sigurtë, shqeto dhe i rrjedhshëm i autorit sigurojnë që gjithkush i çdo moshe, prej çdo grupi shoqëror mund t'i kuptojë ato. Falë rrëfimit të tyre ndikues, të kthjellët, ata mund të lexohen me një të ulur. Madje edhe ata që e kundërshtojnë me ashpërsi spiritualizmin janë ndikuar prej faktit që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të mohojnë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen më vehte, ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do ta vlerësojnë diskutimin si mjaft të

dobishëm, duke u mundësuar atyre të përcjellin reflektimet dhe përvojat e veta tek njëri-tjetri.

Përpos këtyre, shkruar për kënaqësinë e Zotit, ndihmesa në botimin dhe leximin e këtyre librave do të jetë një shërbim i madh ndaj Islamit. Librat e autorit janë të gjithë tejet bindës. Për këtë arsye, për të përcjellë fenë e vërtetë tek të tjerët, një nga metodat më efikase është nxitja e tyre për t'i lexuar këto libra.

Ne shpresojmë që lexuesi do të shohë përmes recensioneve të librave të tjera të tij. Materiali i tij i pasur burimor mbi çështjet që lidhen me fenë është mjaft i dobishëm, dhe kënaqësi për t'i lexuar.

Në këto libra, përndryshe nga disa libra të tjerë, nuk do të gjejmë këndvështrimet personale të autorit, shpjegime të bazuara në burime të dyshueshme, stile që nuk i shkojnë përshtat respektit dhe nderimit që i takojnë subjekteve të shenjta, as argumenta pesimiste e të pashpresa që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.

RRETH AUTORIT



Tani duke shkruar me pseudonimin e shkrimtarit Harun Jahja, ai ka lindur në Ankara më 1956. Pasi kreu arsimimin filor dhe atë të mesëm në Ankara, ai studjoi arted në Universitetin Mimar Sinan të Stambollit dhe filozofinë në Universitetin e Stambollit. Qysh prej 1980-ës ai ka botuar mjaft libra me temë politike, shkencore dhe fetare. Harun Jahja është i mirënjohur si autor i veprave të rëndësishme që zbulojnë mashtrimin evolucionist, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjet e errëta mes Darwinizmit dhe ideologjive të tilla gjakatare si fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, përkthyer në 41 gjuhë, përbëjnë një përmbledhje të më shumë se 45.000 faqe me 30.000 ilustrime.

Emri i tij i shkrimtarit është përbërje e emrave Harun (Aaron) dhe Jahja (Gjon), në kujtim të dy profetëve të shquar të cilët luftuan kundër mungesës së besimit ndër njerëzit. Vula e Profetit në kpakët librave të tij është domethënëse dhe është e lidhur me përmbajtjen e tyre. Ajo përfaqëson Kur'anin (Shkrimin përfundimtar të Shenjtë) dhe Profetin Muhamed (pbqmt), i fundit i profetëve. Nën

udhëzimet e Kur'anit dhe të Sunetit (Mësimet e Profetit), autori e bën qëllim të tij hedhjen poshtë të çdo dogme themelore të ideologjive pazot dhe të ketë “fjalën e fundit”, në mënyrë që të heshtë plotësisht kundërshtimet e ndritura kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (pbqmt) i cili arriti diturinë e fundit dhe përsosmërinë morale, si shenjë e synimit të tij për të afruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahjasë ndajnë një synim të vetëm: të përcjellë porosinë e Kur'anit, të nxisë lexuesit që t'i trajtojnë çështjet e fesë si ekzistencën dhe Njëjësin e Zotit dhe jetën e Përtejme dhe të nxjerrë në dritë themelet e dobëta të sistemit të pafé dhe ideologjitë e zvetënuara.

Harun Jahja gëzon një lexueshmëri të gjerë në mjaft shtete, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, nga Polonia në Bosnje, nga Spanja në Brazil, nga Malajzia në Itali, nga Franca në Bullgari e Rusi. (Dhe tani, edhe në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni a Mal të zi e Lugina e Preshevës – në trojet shqiptare në Ballkan e më gjerë, në gjithë botën – ship). Disa prej librave të tij janë të disponueshme në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, portugjisht, urdu, arabisht, shqip, kinezisht, svahili, hausa, dhivelisht (folur në Mauritani), rusisht, serbo-kroatisht-bosnjakisht, polonisht, malajisht, ujugurisht, turqisht, indonezisht, bengali, hollandisht dhe suedisht.

Si mjaft të mirënjohura rretheqark botës, këto vepra kanë shërbyer në rikuperimin fetar në Zot tek mjaft njerëz duke fituar një largpamësi dhe thellësi në besimin e tyre. Urtësia dhe çiltërsia e librave të tij së bashku me stilin e veçantë që e bën lehtësisht të kuptueshëm, ndikojnë në cilindo që i

lexon ato. Ata që i trajtojnë seriozisht këto libra, nuk avokojnë më ateizëm apo çdo ideologji tjetër të zvetënuar a filozofi materialiste, ngase këto libra karakterizohen prej një efikasiteti të shpejtë, rezultati përfundimtar dhe pakundërshtueshmëri. Edhe nëse ata vazhdojnë me to, do të jetë vetëm një këmbëngulje sentimentale, ngase këto libra i hedhin poshtë këto ideologji qysh nga themeli i tyre. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore të mohimit janë tani ideologjikisht të mundura, falë librave të shkruara nga Harun Jahja.

Ky padyshim është si rezultat i mençurisë dhe kthjelltësisë së Kur'anit. Autori synon thjeshtësisht të shërbejë si mjet i kërkimit njerëzor për të gjetur rrugën e drejtë të Zotit. Asnjë përfitim material nuk është kërkuar në botimin e këtyre veprave.

Ata që i nxisin të tjerët t'i lexojnë këto libra, që të hapin mendjet dhe zemrat e tyre dhe t'i udhëzojnë ata të bëhen shërbëtorë të përkushtuar të Zotit, japin një shërbim të paçmuar.

Ndërkohë, do të ishte vetëm një harxhim i kotë kohe dhe energjie të propagandosh libra të tjerë që krijojnë huti në mendjet e njerëzve, duke i çuar ata në kaos ideologjik, dhe që qartësisht nuk kanë ndikim preçiz e të fortë në heqjen e dyshimeve në zemrat e njerëzve, sikundër edhe vërtetohet nga përvoja e mëparëshme. Është e pamundur që librat e synuar për të theksuar fuqinë letrare të autorit të kenë një efekt kaq të madh, në vend të synimit fisnik të ruajtjes së njerëzve nga humbja e besimit. Ata që dyshojnë në këtë mund të shohin të gatshme se synimi i vetëm i

librave të Harun Jahjasë është të tejkalojë mosbesimin dhe të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksei dhe ndikimi i këtij shërbimi janë shfaqur në bindjet e lexuesve.

Një gjë duhet mbajtur në mendje: arsyeja kryesore e vazhdimit të mizorisë, sherrit, dhe të tjera sprova të hidhura që vuajnë shumica e njerëzve është sundimi ideologjisë së mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të mosbesimit dhe duke përcjellë mrekullinë e krijimit dhe moralin Kuranor që njerëzit të mund të jetojnë sipas tyre. Duke patur parasysh gjendjen e sotme të botës, që shkon poshtë e më poshtë nëpër spiralen e dhunës, korrupsionit dhe konfliktit, ky shërbim lypset qartësisht të jepet me shpejtësi dhe efikasitet, ndryshe do të jetë shumë vonë.

Në këtë përpjekje, librat e Harun Jahjasë marrin një rol parësor. Me vullnetin e Zotit, këto libra do të jenë një mjet me të cilin njerëzit e shekullit të 21-të do të përftojnë paqen, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

HYRJE

Teoria e evolucionit u hodh në dritë nga natyralisti Çarl Darvini në mes të shekullit të 19-të, kur niveli i shkencës dhe teknologjisë s'ishte veçse primitiv, krahasuar me të sotmen. Shkencëtarët e shekullit të 19-të punuan në laboratore relativisht të thjeshtë. Me pajisjet më të pasofistikuara që ata kishin në dispozicion, shkencëtarët nuk mund të shihnin as bakteriet. Madje, ata ishin nën ndikimin e mjaft besimeve të rreme të mbetura nga Mesjeta.

Një nga këto ide të gabuara ishte se organizmat e gjallë kishin një strukturë themelore të thjeshtë – një besim që mund të gjurmohet mbrapsh gjer tek filozofi i lashtë grek, Aristoteli, i cili shkroi se jeta mund të kish ndodhur vetvetiu dhe rastësisht, si rezultat i një materie inorganike që u bashkua vetë në një mjedis të lagësht.

Duke zhvilluar teorinë e tij, Darvini ndërtoi paragjykimin se gjërat e gjalla kishin vetëm një strukturë të thjeshtë. Biologë të tjerë të ciët më vonë përvetësuan dhe mbrojtën teorinë e Darvinit ndanë këtë teori të njëjtë. Për shembull, nga këqyrja e qelizave që ofronin mikroskopët e shekullit të 19-të, Ernst Haeckel, mbështetësi më i madh i Darvinit në Gjermani, besonte se një qelizë ishte një «bullungë e vogël

kombinim i thjeshtë albuminoz i karbonit», jo shumë e ndryshme nga një thërrime mikroskopike xhelatini.¹

Teoria e evolucionit ishte e bazuar në këtë dhe të tjera pargjykime. Autorët e teorisë, si Hekel (Haeckel), Darvini, dhe Huxley, besonin se ngaqë jeta ishte krijuar nga struktura fare të thejshta, ajo mund të kish ndodhur ashtu vetë, rastësisht. Por ata ishin gabim, sigurisht.

Gjatë 150 vjetëve të fundit, që nga koha Viktoriane gjer tani, si shkencë dhe teknologjia kanë hedhur hapa të mëdha. Shkencëtarët kanë zbuluar strukturën e vërtetë të asaj çka Hekel përshkruante si një «bungëll e vogël e thejshtë». Ata janë mahnitur tek shihnin se qeliza nuk është aspak aq e thjeshtë sa ç'besohej dikur, por përmban një numër sistemesh të ndërlikuara të papërfytyrueshme që kurrë nuk mund të ish konceptuar, e aq më pak të kuptohej, në kohën e Darvinit.

Kur shpjegon strukturën e kësaj qelize, biologu me nam, profesor Majkëll Denton (Professor Michael Denton), bën këtë krahasim:²

Që të rrokësh realitetin e jetës siç ka qenë zbuluar prej biologjisë molekulare, ne duhet të zmadhojmë një qelizë një miliardë herë gjersa ajo të jetë me diametër njëzet

¹ (John Farley, *The Spontaneous Generation Controversy from Descartes to Oparin*, botimi i dytë., Baltimore: The Johns Hopkins University Press, 1979, f.. 73)

² (Michael Denton, *Evolution: A Theory in Crisis*, London: Burnett Books, 1985, f. 328)

kilometra dhe t'i ngjajë një balonë gjigande ajrore aq të madhe sa të mbulojë një qytet të madh sa Londra ose Nju Jorku. Çka do të shihnim pastaj do të ishte një objekt i një ndërlíkimi të pashoq dhe dizajn përshtatës. Në sipërfaqe të qelizës do të shikonim miliona vríma, si ata të dritarezave të rumbullakta të anijeve të stërmëdha kozmike, hapje-mbylljeje që lejojnë një rrjedhë të vazhdueshme materialesh të vërshojnë brenda-jashtë. Nëse do të hynim në një nga këto vríma ne do të gjendeshim në një botë teknologjije supreme dhe ndërlíkimi trullósës...

Ky libër do të paraqesë mrekullinë e krijimit në qelizën e gjallë, një kryevepër në miniaturë që posedon një sistem shumë më të ndërlíkuar e të mahnitshëm se sa një anije hapësire. Ne do të tregojmë sesi organelet brenda qelizës së bashku me enzimat, proteinat dhe substancat e tjera që ajo prodhon, kryejnë funksione qëllimplota që kurrë s'mund të priten prej tyre. Ne do të japim shembuj të tríliona qelizave, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, në trupin e njeriut, çdonjëra prej të cilave shfaq inteligjencë dhe zgjuarsi mbinjerëzore. Edhe një herë, ne i kujtojmë vetes se si e tërë kjo nuk mund të jetë thjesht një punë rastësie e pandërgjegjshme, por si një produkt i Zotit.

Prova të krijesës së Zotit, dhe manifestim i fuqisë së Tij eprore, mençurisë dhe zhdërvjelltësisë janë të kudondodhura. Ngado që të kthehemi, ne vijmë ballë-për-ballë me krijesën e Zotit që na shtyn ta lartësojmë Atë me lavdërim.

Një arsye pse ky libër përqëndrohet tek qeliza në veçanti është, edhe një herë tjetër, për t'u paraqitur të

vërtetën atyre që mohojnë Zotin duke thënë se jeta është vetëm si rezultat i rastësisë. Gjallesat janë mjaft të ndërlikuara, pafundësisht shumë të hollësishme që të kenë ardhur ashtu kot, vetiu. Është e qartë se ato janë krijuar nga një Mendje dhe Fuqi superiore. Ky libër synon gjithashtu të shpjegojë manifestin superior në krijesën e Zotit dhe përmes tij të lëvdojë Atë.

DIZAJNI INTELIGJENT, ME NJË FJALË – KRIJESA

Zoti nuk ka nevojë për projekt, që të krijojë.

Është me rëndësi që fjala dizajn të kuptohet siç duhet. Që Zoti ka krijuar një dizajn pa të meta nuk domethënë se Ai fillimisht bëri një plan dhe pastaj shkoi pas tij. Zotit, Perëndisë së Tokës dhe e qiejve, nuk i nevojitet asnjë dizajn me qëllim që të krijojë. Zoti është i lartësuar mbi të gjitha mangësi të tilla. Planifikimi i tij dhe krijimi ndodhin në një çast.

Saherë që Zoti don diçka që të ndodhë, Atij i mjafton vetëm të thotë «Ji!»

Siç na e thonë ajetet në Kur'an:

Urdhri i Tij kur Ai dëshiron diçka është vetëm t'i thotë asaj «Ji» dhe ajo është. (Kur'ani, 36:82)

(Zoti është) Nismëtari i qiejve dhe Tokës. Kur Ai vendos për diçka, Ai vetëm i thotë asaj «Ji!» dhe ajo është. (Kur'ani, 2: 117)



ADN-ja, molekula që gjendet në bërthamën e qelizës, është banka e të dhënave. Përpara se çdo qelizë të ndahet më dysh, lypset që më parë të bëjë një kopje të ADN-së së saj.

BESIMI NË DARVINIZËM LYPS BRAKTISJEN E LOGJIKËS DHE MENÇURISË

Të gjitha qelizat në trupin tuaj shumohen duke u pjesëtuar. Gjatë këtij procesi, edhe ADN-ja në bërthamë të qelizës duhet të kopjohet. Procesi i përsëritjes së ADN-së kryhet pa gabim, më së shumti në një mënyrë të rregullt, skajshmërisht të organizuar që e tmerron vëzhguesin e vëmendshëm.

Molekula e ADN-së, që përmban një bazë të dhënash në miniaturë prej tre trilion shkronjash, është si një palë shkallë të spërdredhura rreth vetes duke formuar një heliks. Në fillim të kopjimit helikasa e enzimës së ADN-së fillimisht i afrohet molekulës së ADN-së dhe zë të zdrilojë heliksin, ashtu sikurse hapet zinxhiri. Fijet dyshe të ADN-së në heliks, më parë të mbështjella rreth njëra tjetrës, kësisoj ndahen, helikasa e ADN-së është gjithmonë gadi të kryejë detyrën e saj në kohë, pa ndonjë gabim, pa rrëmujë apo të bëjë qoftë edhe gabimin më të vogël, dhe pa e dëmtuar kurrësesi ADN-në.

Pastaj është radha e një tjetër enzime, polimerasës së ADN-së. Detyra e saj është të plotësojë çdo fije ADN-je të shpështjellë me një tjetër. Që të bëhet kjo, ajo lypset të gjejë e të sjellë të dhënat organizuese të përshtatshme për secilin fill. Por prit! Një enzimë, përbërë vetëm prej atomesh dhe molekulash, prej saj nuk mund të presësh që të ketë

njohuri, ndërgjegje, apo mendje të vetën. Megjithatë ajo mund të identifikojë llojin e të dhënave të duhura për të plotësuar gjysëm-fillin e ADN-së dhe pastaj, të gjejë përbërësit e domosdoshëm, kudo që të jenë në qelizë, dhe t'i shpjerë ata ku nevojiten. Gjatë tërë këtij procesi, ajo nuk bën as gabimin edhe më të vogël. Ajo identifikon një për një të tri trilion shkronjat me qëllim që të plotësojë fillin e ADN-së saktësisht. Në të njëjtën kohë, një tjetër enzimë polimerase punon në fijet e tjera të ADN-së dhe e plotëson atë në të njëjtën mënyrë. Dhe ndërsa ndodh e gjitha kjo, enzimat «heliks-stabilizuese» i mbajnë të veçuara të dyja fijet e ADN-së për të shmangur pështjelljen e tyre prapë mbi njëra-tjetrën.



ADN-ja është në formën e një heliksi. Që ajo të kopjohet, mjaft enzima – sërish prodhuar në bazë të të dhënave në ADN – kryejnë procesin duke shpërfaqur inteligjencë dhe organizim maksimal.

Gjatë këtij procesi të kopjimit të ADN-së, mjaftë enzima punojnë me disiplinë ushtarake për të kryer procesin që kërkon dituri dhe njohje. Po t'ju jepej juve një shkrim që përmban tre miliardë shkronja dhe do t'ju kërkohet ta ri-shtypnit, me siguri nuk do ta kopjonit pa gabime. Me siguri që do të bënit të paktën një gabim diku, duke kapërcyer një rresht ose të paktën një shkronjë a dy. Megjithatë, këto enzima mbarojnë një proces të ngjashëm vazhdimisht, pa bërë gabime të filla.



Përpara se ADN-ja të kopjohet, enzimat e quajtura helikase mbërrijnë për të shpëstjellë heliksin e ADN-së, ashtu siç do të hapje një zinxhir. Format portokalli tregojnë veprimet e enzimës.


Darvinizmi thotë se të gjitha këto enzima, të dhënat e përfshira në miliardat e shkronjave të ADN-së, procesi i kopjimit të ADN-së, dhe i tërë ky organizim i pagabueshëm ka ndodhur si rezultat i një zinxhiri rastësish. Besimi i evolucionistëve në këtë supozim të pabesueshëm – në fakt i pamundur – është një gabim i madh dhe kërkon trajtim serioz. Arsyeja e vetme për besimin qorr të evolucionistëve në këtë teori tejet të palogjikshme është përkushtimi i tyre ndaj materializmit, së bashku me vendosmërinë e tyre në mohim të ekzistencës së Zotit.



Me qëllim që të dy fijet e shkëputura të ADN-së të mos mpleksen sërish me njëra-tjetrën, enzimat heliks-stabilizuese, (treguar me të gjelbërt në diagramë) i mbërthejnë fijet në vend.

PAJISJA NË TRUPIN TUAJ QË MUND TË KOPJOJË NJË MILIONË FAQE TË DHËNASH PËR NJËZET MINUTA

Dihet prej shumë kohësh se qelizat shumohen nëpërmjet pjesëtimit. Gjatë këtij procesi, ADN-ja që gjendet në bërthamën e çdo qelize duhet të kopjohet për çdo qelizë bijë e re. Gjatë këtij procesi kopjimi, një ngjarje mahnitëse ndodh, që kërkon shqyrtim



Në këtë pikë, enzimata e quajtura polimerase ADN-je fillojnë bashkëngjitjen e pjesëve të duhura të të dhënave tek secili fill, për të formuar dy helikse ADN-je


Banka e të dhënave, e përbërë prej tri miliardë shkronjash, është e aftë të depozitojë sasi masive të dhënash rreth organizmit të gjallë. Për të shkruar të gjitha të dhënat e përmbajtura në ADN do të duhej një enciklopedi prej afërsisht 1000 vëllime, me një sasi prej një milioni faqesh.

Kështuqë, përsëritja e ADN-së dhe kopjimi i një milioni faqesh enciklopedi janë të krahasueshme. Por a e dini ju se sa kohë duhet për këtë proces të përsëritjes së ADN-së?



Si rezultat i bashkëpunimit dhe disiplinës së pagabueshme, proceset inteligjente të këtyre molekulave të pandërgjegjshme, ADN-ja kopjohet përsosmërisht, pa gabime

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Në këto diagrama, format e verdha përfaqësojnë enzimat e polimeraseve të ADN-së, të cilat kryejnë procesin e kopjimit



Mes 20 dhe 80 minutash!

Tani, kjo do të thotë se ekuivalenca e një milioni faqesh të shkruara mund të kopjohet, pa gabime a mangësi, në një kohë më pak se dy orë – dhe nganjëherë, nën një gjysmë ore. Asnjë fotokopjatriçe apo ndonjë pajisje tjetër teknologjike e mundshme sot nuk mund ta përfundojë këtë proces kopjimi pa gabim, në një kohë kaq të shkurtër. Dhe, ki parasysh se asnjë makineri teknologjike nuk e kryen këtë

proces, ndërsa qelizat që ne as nuk mund t'i shohim dot me sy të lirë, po. Tani pyet veten:

Kush e posedon fuqinë dhe mendjen, vullnetin dhe njohurinë që bën të mundur këtë organizim mahnitës? Ç'e kupton se ADN-ja duhet të kopjohet kur një qelizë ndahet? Ç'e bën të mundur këtë përsëritje në mënyrën më të shpejtë e të përsosur, dhe bën që çdo gabim të ndreqet menjëherë?

Qartësisht, është e palogjikshme dhe pa kuptim të pretendosh se i gjithë ky sistem i ndërlikuar, i përsosur e i pagabimtë të jetë si rezultat i rastësisë. Silli bashkë të gjitha atomet në univers, në kushtet e duhura, dhe prapë nuk do mund të krijoje dot sistemin që të kryejë përsëritjen e ADN-së në çdo organizëm të gjallë.


Është fare e qartë se Ai që krijoi këtë sistem të përsosur, i Cili ka vazhduar ta krijojë atë për miliona vite është Zoti, Mbajtësi i diturisë së pafund, ndërgjegjes, dhe fuqisë.

PËRSOSMËRIA E ADN-së HEDH POSHTË TEORINË E EVOLUCIONIT.

Në një molekulë të ADN-së njerëzore, ka aq të dhëna të mjaftueshme sa të mbushësh një milionë faqe enciklopedi. Por rregulli në këto të dhëna është gjithashtu jetësisht i rëndësishëm. Pyet veten nëse qindra shkronja të hedhura kuturu do të mund të bashkoheshin për të formuar një artikull të kuptueshëm lajmesh. A mundet që miliona shkronjash të njëjta ta ujdin veten sëbashku përsosmërisht dhe siç duhet për të formuar një gazetë të tërë? A mundet kush të pretendojë se e tërë kjo është produkt i një rastësie qorre? Sipas kuptimit darvinist, të gjitha këto zhvillime mahnitëse, janë fare e mundshme të ndodhin rastësisht.



Darvinizmi mendon se ai ka mashtruar të gjithë popullsinë e botës si fëmijë të vegjël. Kjo ideologji e paraqet rastësinë si të kishte ndërgjegje hyjnore, dhe thotë se ajo diqysh posedon një dituri gjeniu dhe më të madhe sesa të gjithë njerëzit në botë. Sipas evolucionistëve, koha është e vetmja gjë e



domosdoshme për këtë gjeni të quajtur rastësi, për të formuar trurin e të gjithë atyre njerëzve që kanë jetuar për mbi mijëra vjetë. Dhe jo vetëm truri, por edhe mendja e tyre, kapaciteti për të menduar, arsyetimi i tyre, kujtesa, dhe qindra veti të tjera fizike e shpirtërore. Nëse pajiset me materie dhe kohë të mjaftueshme, rastësia ka fuqinë për të krijuar njerëz, milingona, kuaj, xhirafa, pallonj, flutura, fiq, ullinj, portokaj, pjeshkë, shegë, shalqinj, domate, banane, tulipanë, vjollca, luleshtrydhe, dardha, trëndafila dhe qindra e qindra gjëra të gjalla që as mund t'i sjellësh ndërmend. Dukshëm, i gjithë ky pretendim nuk është asgjë pos gjepura. Krijuesi i të gjitha gjërave është Zoti.

TRAJTA E QELIZAVE HEDH POSHTË TEORINË E EVOLUCIONIT

Në trupin tuaj janë afërsisht 200 lloje të ndryshme qelizash, megjithatë ato ndryshojnë nga njëra-nga tjetra në fare pak anë. Një nga dallimet më të rëndësishme është forma e tyre. Ndonëse qelizat nervore, qelizat e muskujve, dhe qelizat e gjakut të gjitha kanë të njëjtën ADN themelore, ato funksionojnë me efikasitetin më të madh, falë formave individuale të përsosura, në të gjithë pjesët e trupit ku ato kryejnë detyrat e tyre.

Dy shembuj të qelizave me forma të ndryshme janë qelizat e nervave dhe qelizat e gjakut. Qelizat nervore kanë zgjatime të gjata, të quajtura aksone (axon), nga palca e kurrizit gjer tek këmbët dhe mund të arrijnë gjer në një metër gjatësi tek njerëzit. Në këtë mënyrë, kur ngacmimi kalon nga një qelizë tek tjetra, nuk ka kohë të humbur. Ngacmimet kalojnë drejt e tek ku do të shkojnë.

Rruazat e kuqe të gjakut të quajtura erithrocite (erythrocytes), gjithësesi, përndryshe qelizave nervore, janë vetëm afërsisht 7-7 mikrometra në diametër. Pikërisht ngaqë ato janë aq të vogla nënkupton se ato përshkojnë kapilarët më të vegjël me lehtësi, dhe pa u deformuar. Përpos kësaj, forma e tyre bikonkave (dylugëshe) maximizon vendin e sipërfaqes tej e mban së cilës oksigjeni shkëmbehet me dyoksid karboni. Nëse ke parasysh se të tilla qeliza janë me miliona në një milimetër kub gjaku, s'është e vështirë të llogarisësh sipërfaqen masive mbi të cilën kryhet ky shkëmbim gazrash.

Qelizat në sy dhe vesh gjithashtu janë specializuar përsa i përket formës. Koklea (cochlea), brenda veshit të brendshëm, përmban qeliza shqisash të cilat kanë maja si qime që prodhojnë ngacmime nervi në përgjegje të dridhjeve zanore në veshin e mesit. Diçka e ngjashme me këtë, qeliza të ndjeshmërisë së lartë të retinës në sy janë dizajnuar gjithashtu të kryejnë funksionin e tyre në mënyrë më të mirë të mundshme. Qelizat konike në retinë përmbajnë mjaft pigmente të ndjeshmërisë së lartë, sikurse edhe një shtresë që përmban lidhjet nervore. Ky organizim i jep qelizave konike një ndjeshmëri mjaft të lartë ndaj dritës.

Edhe në zorrët e holla, ka qeliza ushqim-thithëse me formë të përshtatshme për të kryer funksionet e tyre të veçanta. Muret e brendshme të zorrëve janë veshur me miliona qime si gishta të quajtura villi. Në secilin villus ka mikroville që janë edhe më të imta. Kombinimi i këtyre qimeve rrit sipërfaqen e kontaktit për honepsje dhe thithje të vlerave ushqimore.

Mos harro kurrë se të gjitha miliardat e qelizave në trupin e njeriut janë aty nga pjesëtimi i vetëm një qelize fillestare, e cila zuri fill nga bashkimi i spermës me vezën. Të mendosh se secila prej këtyre qelizave ka zgjedhur formën e tyre të veçantë dhe pastaj diqysh morën formën e trupit është fare pa logjikë. E gjitha kjo tregon se qelizat janë krijuar në mënyrën më efikase për të kryer funksionet e tyre. Pra, domethënë, ato janë krijuar nga Zoti, Poseduesi i diturisë dhe zgjuarsisë së pafundme.

*Ne do t'u tregojmë atyre shenjat
tona në horizont dhe brenda vetë
tyre gjersa të jetë e qartë për ta se
kjo është e vërteta. A nuk ju
mjafton që Zoti juaj është
dëshmitar i gjithçkaje?*


(Kur'ani, 41:53)

SI E NJOHIN QELIZAT NJËRA-TJETRËN?

Në shkollë të mesme ose në kolegji ne kemi studjuar se si janë formuar qëniet njerëzore. Në fazën e parë të tij, embrioni është një çikë ind i paformë, por sikurse ai vazhdon të rritet, disa qeliza formojnë krahët, disa të tjera

organet e brendshme, dhe pak të tjera lihen mënjanë për sytë. Çdo qelizë e di ku lypset të shkojë, ç'organ do të formojë, në ç'skallë ajo duhet të shumohet, dhe kur të ndalë pjesëtimin. Por pjesa në vijim jep një tjetër fakt mahnitës rreth zhvillimit të embrionit.

Nëse i ndajmë qelizat e embrionit që i përkasin organeve të



ndryshme – duke ulur sasinë e kalciumit në mjedis – dhe pastaj më vonë, t'i përziejmë këto qeliza së bashku në një mjedis të përshtatshëm, do të shikojmë se duke ardhur sërisht në kontakt, qelizat që i përkasin të të njëjtit organ e njohin njëra-tjetrën dhe formojnë një grup të dallueshëm qelizash që i përkasin të njëjtave organe (Ahmet Noyan, Yasamda ve Hekimlikte Fizioloji (Physiology in Life and Medicine - Fiziologji në jetë dhe mjekësi - edicioni i 10-të . Ankara: Meteksan Publications, 1998, f. 40).

Domethënë, nëqoftëse qelizat në fillim janë të ndara nga njëra-tjetra, pastaj bashkuar sërisht, qelizat që përbëjnë të njëjtët organe e njohin njëra-tjetrën dhe ribashkohen prapë.

Por si mundet që këto qeliza, të cilat nuk kanë tru apo sistem nervor, as sy e veshë, e njohin njëra-tjetrën? Si ka mundësi që këto substanca, të formuara nga disa molekula pa tru apo ndërgjegje, e njohin llojin e tyre të qelizave nga një grup? Si mund t'i njohin ato se më vonë do të bashkohen për të formuar një organ? Cili është burimi i ndërgjegjes së dukshme të shfaqur nga këto molekula të pandërgjegjshme.

Burimi i ndërgjegjes së tyre është Zoti, Perëndia e botës, i cili e krijoi krejt gjithësinë nga hiçi.

Ne do t'u tregojmë atyre shenjat tona në horizont dhe brenda vetë tyre, gjersa të jetë e qartë për ta se kjo është e vërteta. A nuk ju mjafton që Zoti juaj është dëshmitar i gjithçkaje? (Kur'ani, 41:53)

PROVA SHPJEGUESE TË EKZISTENCËS SË ZOTIT

Sipas pretendimeve darviniste, të gjitha gjallesat vijnë nga rastësi kot së koti. Por mijra sistemet e ndërlikuara në trupin tonë e mohojnë këtë dokërr të rastësisë. Një shembull është struktura si qime, detyra e vetme e të cilës është ta lejojë qelizën të lëvizë që nga ana e saj, përbëhet prej mijëra hollësisish të imta.

Disa qeliza lëvizin duke përdorur struktura mikroskopike, të quajtura cilia, që i ngjajnë qerpikëve. Për shembull, secila prej qelizave të palëvizshme në rrugën e frymëmarrjes posedon qindra cilia. Duke lëvizur sëbashku të gjitha në një kohë, njësoj si rremat në kanotazh gare, kjo strukturë i mundëson qelizës të ecë përpara.

Po të bëjmë një prerje tërthore, mund të shikojmë se është mjaft e organizuar dhe e përbërë nga një rreth prej nëntë dopio mikrotubuletash rreth periferisë dhe dy mikrotubuletash teke në mes.

Secila prej mikrotubuletave dopio ka një unazë me 13 mikrofilamentesh dhe një tjetër me 11 mikrofilamente.

Mikrotubuletat janë të përbëra prej një proteine të quajtur tubulin.


Mikrotubuletat kanë edhe dy zgjatime, një krah i quajtur dynein. Funkzioni i kësaj proteine është që të veprojë si një motorr për *cilian* dhe të japë fuqi mekanike.

Molekulat që përbëjnë proteinën tubuline praktikisht rrjeshtohen së bashku si tullat që formojnë strukturën cilindrike. Megjithatë, organizimi i molekulës tubuline është shumë më e ndërlikuar sesa vendosja e tullave.

Sipër janë 10 zgjatime të shkurtëra dhe 10 zgavra nga poshtë çdo tubulini. Këto zgavra dhe zgjatime janë krijuar të nxëna të shtrënguara mbrenda njëra-tjetrës, duke krijuar kështu një strukturë mjaft të qëndrueshme. Madje edhe difekti më i vogël në pikërisht këtë dizajn të veçantë i këtyre zgavrave apo zgjatimeve do të çonte në dëmtim të qelizës.

Të gjithë këto komponente që ne kemi përmbledhur shkurtimisht dhe thjesht kompozojnë vetëm një *cilium* të vetëm, dhe qëllimi i vetëm i tij është të lëvizë vetëm atë qelizë, prej trilionave qelizave të trupin tuaj. Një sistem i tillë gjithëpërfshirës ndodhet në çdo qelizë të sistemit të frymëmarrjes të çdokujt që ka jetuar dhe vazhdon të jetojë sot. Pos të tjerash, ky sistem i ndërlikuar i përbërë prej shumë pjesësh të ndryshme është nënstruktura e një ciliumi në një qelizë që as nuk mund ta shohim me sy të lirë. Mund të merret me mend sa e vogël kjo sipërfaqe është, duke ndjekur krahasimin: duke i futur të gjitha hollësitë e shpjeguara më lart në një nga qimet e flokëve tuaj do të ishte aq e ndërlikuar saqë truri ynë nuk mund ta

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



rokë dot. Por cilia e qelizës për të cilën po flasim ka mu atë substrukturë aq pakrahasimisht të vogël.

Shkurtimisht, Zoti ka vendosur një mekanizëm tejet sistematik dhe të ndërlikuar në një vend mjaft të vogël për ta parë me sy të lirë. Është fare e pamundur për rastësinë të mendojë për lëvizjen e një qelize e ta fusë një sistem të tillë në një vend aq të vogël. Kjo është e mundur vetëm me mendjen superiore dhe të pafund, diturinë dhe fuqinë e Zotit.

RAFINERIA E NAFTËS NË TRUPIN TONË

Energjia që ty të duhet për t'u ngritur nga aty ku je dhe të zësh të ecësh, të marrësh frymë, të hapësh e të mbyllësh sytë – me një fjalë, energjia që të duhet për të qenë gjallë, është prodhuar në centralin elektrik brenda qelizave tuaja, të quajtura mitokondria. Po të këqyrim procesin e kryer në mitokondri, bëhet e qartë pse krahasimi i tyre me centralin elektrik nuk është egzajerim.



Mitokondrioni, i përbërë prej proteinash që gjenden në qelizë, punon si një central elektrik për të prodhuar energjinë që i nevojitet qelizës

Në podhimin e energjisë në qelizë, oksigjeni luan një rol kryesor. Oksigjeni ka mjaft ndihmësa. Praktikisht në të gjitha fazat e prodhimit të energjisë, enzima të ndryshme luajnë rolin e tyre. Në çdo hap të veçantë të këtij procesi, enzimat që e kanë kryer punën e tyre ndërrojnë turnet me të tjera enzima që vijnë në punë për hapin tjetër. Kjo është bërë në mënyrën më të ndërgjegjshme, dhe kështu, energjia e magazinuar në ushqime shndërrohet në një formë të dobishme për qelizën, si rezultat i një procesi kimik të pafund, mjaft procese të vogla, dhe qindra enzima të ndryshme futen në veprim. Në tërë këtë ndërrim të enzimave, nuk ka as edhe hutinë më të vogël, apo qoftë edhe ndonjë ngatërrim rendi. Të gjithë punëtorët bëjnë detyrën e tyre, si të ishin pjesë e një skuadre të mirëdisiplinuar.

Dhe kështu, mund të thuhet se stacioni elektrik që ndodhet në një qelizë, vetëm një e qindta e milimetrit në përmasë, është shumë më e ndërlikuar sesa një rafineri nafte apo hidrocentral.



Centrali elektrik në qelizat tona, secila sa 1/100 e një milimetri, është shumë më e ndërlikuar sesa një rafineri naftë ose një hidrocentral. Energjia e prodhuar nga bashkëpunimi inxhinierëve, teknikëve dhe dezinjatorëve, duke përdorur teknologjinë më të përparuar, është prodhuar shumë më ekonomike dhe praktike prej qelizave tona. Të cilat nuk kanë ndërgjegje apo inteligjencë dhe që janë formuar prej disa atomeve.

Në centralin elektrik të qelizave tona, çdo hollësi është marrë në konsideratë; që nga përdorimi ekonomik i energjisë e deri tek kthimi i mbetjeve në dobi. Secila prej këtyre hollësive ka qenë planifikuar dhe krijuar pa asnjë gabim.

Një rafineri është ndërtuar dhe mbajtur në punë prej inxhinierëve që dinë se ç'është nafta, të cilët e kanë analizuar naftën bruto në laborator, dhe të cilët veprojnë në bazë të atyre të dhënave teknike. Do të ishte e pamundur të ndërtohej një rafineri prej cilitdo që nuk di ç'është nafta.

Në të njëjtën mënyrë, dituri lypset edhe për të prodhuar energji në një qelizë që është shumë më e ndërlikuar se një rafineri nafte. Është dukshëm qesharake të sygjerosh se një qelizë ka aftësinë për të mësuar. Po atëherë, si e nxjerrin këtë prodhim qelizat?

E vërteta është: asnjë qelizë nuk e ka mundësinë të mësojë ndonjë proces biologjik, në kuptimin bukalisht të fjalës. Nëse qeliza nuk mund ta kryente dot këtë proces kur shfaqet fillimisht, atëhere ajo nuk do të kishte chans t'i fitonte aftësitë e domosdoshme më vonë – thjesht sepse oksigjeni, i cili luan një rol aq qendror në prodhimin e energjisë, ka një efekt shkatërrimtar në qelizë. Qelizës do t'i duhej të shfaqej së bashku me vetinë mbrojtëse. Kjo është vetëm një prej mjaft provave se qelizat nuk janë shfaqur si rezultat i ndonjë rastësie, por janë krijuar nga Zoti në një çast.

Me këtë mjeshtëri, shfaqur në një vend sa 1/100 e milimetrit, Zoti na tregon fuqinë e tij të pakufishme.

ENERGJIA E JETËS NË QELIZAT TUAJA -MOLEKULA TFA-

(Molekula TFA- Trifosfat Adenosina)

Energjia që ne përftojme nga ushqimi nuk mund të përdoret drejt e prej qelizave tona për të kryer procesin e domosdoshëm të ekzistencës së vazhdueshme. Së pari, energjia paketohet në një molekulë të veçantë të quajtur trifosfat adenosinë, ose ATP³. Më vonë, ajo përdoret për të kryer të gjithë fabrikimin dhe transferimet që ndodhin në qelizë.

Proceset që përdorin
ATP dhe llojet e
energjisë së prodhuar



Trupi përdor 48 kilogram TFA në ditë. Por mjaft e çuditshme, në çdo çast gjatë ditës, sasia e TFA-së në trup nuk e kalon qoftë edhe një gram. Arsyeja për këtë është se TFA-ja nuk është magazinuar, por në vend të saj është përgatitur në paketa të posaçme për përdorim të menjëhershëm. Kurrë mos harro se jeta e qelizës mvaret nga kjo energji. Për këtë arsye, prodhimi i TFA-së duhet të


³ Terminologjia anglisht: ATP Molecule - Adenosine Triphosphate.

bëhet shumë shpejt. Dhe kështu, në çdo sekondë, secila prej afërsisht 100 trilionë qelizave konsumon dhe rigjeneron 10 milionë molekula TFA-sh.

Si mbahet kjo shpejtësi?

Saherë që një qelize i nevojitet energji, thyhet lidhja fundore e grupeve trefosfate të molekulës TFA; dmth, paketa e energjisë është hapur. Me këtë thyerje të një lidhjeje fosfati, çlirimi i energjisë më pas i lejon qelizës të kryejë funksionin e saj me lehtësi. Dhe ky proces mahnitës vazhdon me shpejtësi çuditëse dhe pandarë.

Ndërgjegje në qelizë – harun jahja




ATP është një paketë energjie e prodhuar në qelizë. Figura 3D e molekulës ATP, treguar sipër, tregohet më në hollësi djathtas. Ajo përmban grupe trifosfatesh me lidhje fosfati energjie të lartë dhe atomeve

SHKRIRJA E MOLEKULËS ATP ÇLIRON ENERGI

1-ATP ka tre grupe fosfatesh. Saherë që një hallkë këputet, çlirohet energji.

2-Nëse vetëm një hallkë këputet, atëhere formohet ADP-ja. Nëse dy grupe fosfatesh shkëputen, formohet AMP-ja.

3-Me lëshimin e grupit të fundit të AMP-së, e gjithë energjia e molekulës ATP kalon tek molekulat përkatëse



The diagram illustrates the chemical structure of ATP and its hydrolysis. It shows Adenine, Ribose, and three phosphate groups. The breakdown steps are: ATP → Adenosine + AMP + energy; ADP + water → AMP + energy; and AMP + water → Adenosine + energy.

Pa dyshim, është e pamundur për një molekulë të përbërë prej atomeesh që të përcaktojë kërkesat e qelizës për energji e pastaj ta prodhojë atë energji të duhur. Që ky prodhim kryhet në mënyrën më efikase dhe me sistemin më të përshtatshëm të paketimit nuk mund të jetë pjellë e rastësisë. Krijuesi i qelizës dhe të çdo veprimi e procesi të molekulave brenda qelizës është Zoti; është Ai që e vë

molekulën TFA në shërbim të gjallesave në një mënyrë të përsosur.

KUSH E DREJTON TRAFIKUN E NGJESHUR NË QELIZË?

Aparati tretës (Golgi), që gjendet në çdo qelizë, luan një rol të rëndësishëm në paketimin sërish të proteinave të sintetizuara dhe fthillin e përzgjedhjen mes llojeve të ndryshme të proteinës.



Organizimi i qelizës është shumë më ndërlikuar dhe më efikas se çdo fabrikim njerëzor. Në një proteinë të prodhuar në qelizë, merren hapa që përfshihen në prodhimin e produkteve në fabrikë dhe shpërndarjen e mëvonëshme të tyre ku ato nevojiten.

Proteinat e shumëllojshme që gjenden në pjesë të ndryshme të qelizës sintetizohen në një tjetër pjesë të qelizës e quajtur retikulumi endoplazmik, ose ER. Pak minuta pasi proteinat sintetizohen, ato dalin shumë shpejt nga ER për tek aparati Golgi. Ka mjaft arsye pse ato i

nënshtrohen ndryshimeve të lloj-llojshme pasi janë bërë. Për shembull, tek disa prej tyre bashkëngjiten grupe karbohidratesh, tek të tjerat fosfate ose grupe fosfatesh, dhe tek akoma të tjera, acide yndyrore. Këta modifikime varjojnë sipas llojit të proteinës dhe se ku do të përfundojë ajo. Trupi Golgi i spastron këto proteina dhe i ndan e paketon ato, sipas llojit dhe destinacionit. Ai gjithashtu prodhon paketat sipas llojit të qelizës për ku protina është destinuar të shkojë. Megjithatë, me qëllim që veprimtaria biokimike e mijëra proteinave të sintetizuara në ER mos të ngatërrohet, procesi lypset të kryhet me ndjeshmëri të madhe, dhe secila proteinë duhet të drejtohet kah destinacioni i saj.

Këtë trafik e organizojnë organelet e vockëla të njohura si trupi apo aparati Golgi. Ky shfaq një vetëdijësim të madh në çdo proces që kryen. Njeh proteinat që atij i vijnë, i ndan ato, përcakton nevojat e tyre, kryen prodhimin e vet sipas nevojave të tyre, identifikon funksionin e tyre, i paketon ato, dhe organizon rrjedhën e trafikut pa asnjë rrëmujë. Ai që e frymëzon qelizën dhe organelet brenda saj, me aftësinë për të vendosur dhe zbatimin e njohurisë është Zoti i botëve – pra, Allahu.

Ata që shtangen përpara këtyre mrekullive qelizore dhe që dëshmojnë diturinë superiore të Zotit mund të tronditen vetëm prej pretendimeve të evolucionistëve që e gjitha kjo ka ardhur si rezultat i rastësisë.

*Ai krijoi qiejt dhe tokën me urtësi të përsosur
dhe Ai ju dha formën më të bukur dhe vetëm
tek Ai është e ardhmja.*

(Kurani, 64:3)

MËLÇIA SI NJË LABORATOR GJIGAND


Askush nuk mund të pohojë se një laborator i pajisur plotësisht me teknologjinë më të fundit mund të jetë bërë ashtu vetë, rastësisht. Por evolucionistët pohojnë se laboratori i ndërlikuar i pashoq i mëlçisë është bërë vetë, duke avokuar këtë pohim pa asnjë provë fare. Kjo, sepse darvinizmi është një sistem besimi bestytnish, një magji që të qorrn mendjen.

Pesëqind procese të veçanta ndodhin në vetëm një qelizë të mëlçisë. Shumica e këtyre (të cilat ndodhin pagabueshmërisht në milisekonda, dmth, një e mijta e sekondës) akoma nuk është prodhuar në kushte laboratorike. Qelizat e mëlçisë e shndërrojnë ushqimin që ne hamë në energji të depozituar, që është glicogjen, të cilën mëlçia e depoziton dhe e kthen në glukozë sipas nevojës së trupit për të plotësuar nevojat e tij për energji.

Shkurtimisht, edhe ndërkohë që hamë të gjitha llojet e ushqimeve që na pëlqejnë, mëlçia shfrytëzon, shndërron apo magazinon këtë energji ushqimi sipas nevojave të

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

trupit tonë. Dhe qysh nga njeriu i parë e gjer tani, trilionja qeliza mëlçie kanë vepruar saktësisht me të njëjtën ndërgjegje dhe njohuri pa u ngatërruar.



QELIZAT QË KRYEJNË VETËVRASJE PËR TË RUAJTUR TRUPIN NGA DËMTIMI.


Mjaft qeliza prodhojnë një sërë proteinash me qëllim që të shkatërrojë vetëveten kur ato bëhen të tepërta, difektoze apo të sëmura. Sidoqoftë, përsakohë që një qelizë është e dobishme për trupin, këto proteina pengohen për të bërë punën e tyre vdekjeprurëse. Nëqoftëse qeliza sëmuret, shndërrohet në tradhëtare ose kanceroze, apo fillon të kërcënojë shëndetin e organizmit, proteinat vrasëse lëshohen dhe vihen në veprim për të vrarë qelizën cënuese.

Aftësia e qelizës për të marrë vendimin e duhur në kohën e vendin duhur është tejet e rëndësishme. Në rast se ajo nuk mundet, dmth kur proteinat vrasëse janë aktivuar në një qelizë të shëndoshë, atëherë indi i shëndetshëm do të vdesë, dhe atëherë rezultati do të jetë vdekje e krejt organizmit. Por, nëse një sasi qelizash të sëmura apo të dëmshme u lejohet të shpëtojnë, atëherë edhe organizmi do të vdesë.

Një qelizë që ka vendosur të bëjë vetëvrasje dhe aktivon proteinën e tij vrasëse, fillimisht tkurret dhe tërhiqet nga fqinjët e saj. Së shpejti në sipërfaqen e saj shfaqen filluska, dhe duket se po valon. Pastaj bërthama e saj e në fund vetë qeliza shkatërrohen. Qeliza të tjera përreth gëlltisnin çikëlat e mbetura.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Një dukuri edhe më interesante është se qelizat e tjera të gjalla nuk i pastrojnë të gjitha ato të vdekurat. Disa janë lënë qëllimisht të patrazuara, sepse ato nuk i kanë mbaruar ende detyrat e tyre. Për shembull, indet e tilla si thjerrëzat e syrit, sipërfaqja e lëkurës, dhe thonjtë janë të gjithë të përbërë prej qelizave të vdekura. Por ngaqë trupi ka nevojë për to, ato nuk shkatërrohen. Fakti i rëndësishëm që trilionat e qelizave në trup të gjitha vendosin se cilat qeliza të vdekura t'i shkatërrojë e cilat t'i lërë, është një pikë që ia vlen të shqyrtohet.



Kush ia jep qelizës ndërgjegjen që të marrë e të zbatojë vendime kaq jetike? Kush e mëson qelizën të njohë kushtet

që i sjellin dëm organizmit më të madh ku ajo e gjen veten? Dhe kush e frymëzon këtë formë jete mikroskopike që të mënjanojë rrezikun?

Sikurse është shpjeguar këtu, të gjitha qelizat janë programuar në mënyrën më të mirë që t'i lejojë organizmave të vazhdojnë ekzistencën e tyre. Por në atë rast, Kush është Mjeshtri i atij programi?


Evolucionistët janë verbuar mjetueshëm sa të besojnë se mjeshtri i këtij programi të jashtëzakonshëm është rastësia e pandërgjegjshme. Por krijesa fare e veçantë e Zotit dhe dituria e Tij e paanë janë shfaqur në çdo hollësi të një organizmi të gjallë.

MAKINERITË BAKTERIE-SHKATËRRUESE NË MËLÇI.

Bakteriet që ne nuk mund të shohim futen në trupin tonë përmes ushqimit që hamë, nëpërmjet ajrit që thithim, ose përmes një numri mënyrash të tjera. Bakteriet e dëmshme duhet të asgjësohen përpara se ato pengojnë funksionimin e trupit. Për këtë arsye, qeliza të posaçme në trup, detyra e vetme e të cilave është mbrojtja, janë pajisur me kujtesë të përsosur. Megjithatë, mjaft masa të tjera mbrojtëse janë vendosur, si një shembull i dizajnit pa të metë të trupit. Një vijë mbrojtjeje jepet nga qeliza të posaçme që gjenden në mëlçi – një pikë strategjike në sistemin e qarkullimit të gjakut.

Në më pak se 0,01 të sekondës, qelizat Kupffer honepsin dhe neutralizojnë çdo bakterie të dëmshme që kalon nëpër sistemin e qarkullimit të gjakut nga zorrët tek mëlçia. Nga gjithë ato bakterie të panumërta që hyjnë në trup, si mundën këto qeliza të pamend të dallojnë ato që shkaktojnë dëm nga ato që janë të dobishme? Si ka mundësi që këto qeliza të shkatërrojnë disa bakterie, por i lënë të tjerat të paprekura – pa i njohur vetitë e bakterieve ose çka do të bëjnë ato sapo të hyjnë në trup? Në këtë pikë, një tjetër fakt i rëndësishëm kërkon vëmendje: që qelizat Kupffer gjenden në mëlçi. Po pse në mëlçi e jo në ndonjë organ tjetër? Këtu kemi akoma edhe një provë tjetër e trupit tonë si krijesë e përsosur. Po të ishin vendosur këto qeliza në një tjetër organ të trupit tonë, përveç mëlçisë, pastrimi i gjakut nga bakteriet nuk do të ishte aq efikas. Sepse pasi është pastruar në mëlçi, gjaku hyn në sistemin e përgjithshëm të qarkullimit të tij, për të qarkulluar nëpër gjithë trupin. Dhe kështu, më pak se 1/100 e bakterieve ia dalin të mbërrijnë në qarkullimin e përgjithshëm. Ç'lloj rastësie qorre do ta kish siguruar vendosjen e qelizave Kupffer në mëlçi, prej të gjitha organeve në trup? Vetë qelizat nuk mund ta përcaktojnë vendin më të përshtatshëm për to që të shkojnë, aq më pak të shkojnë përnjëmend atje. Trupi është i përbërë prej afërsisht 100 trilion qelizash, dhe është e pamundur për çdonjërin prej tyre të ketë mjaft ndërgjegje sa të përcaktojë një vend për vete dhe të udhëtojë për atje e të vendoset.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Një plan kaq i pa-të-metë lyps ekzistencën e një mendjeje sipërore, një që i përket Atij që di çdo centimetër të trupit tonë dhe i Cili na ka krijuar ne nga hiçmosgjëja në dizajnin më të përshtatshëm – dmth, Zoti.

TI NUK JE KURRË NË KONTROLL TË FYMËMARRJES TËNDE SEPSE DISA PREJ QELIZAVE TUAJA E KONTROLLOJNË ATË PËR TY.


Në qoftë se rregullimi i frymëmarrjes sonë do të ish lënë në dorën tonë ne ndofta do të vdisnim nga asfiksia ngaqë do të harronim të merrnim frymë, kur biem në gjumë ose të zënë me veprimtari të tjera.

Për çdo qenie njerëzore, procesi më vendimtar është rregulluar prej qendrës së frymëmarrjes, e cila është sa një kokërr mozge (thjerrëze) dhe ndodhet në bisht të trurit (një shtesë e trurit). Ajo është e përbërë nga tre grupe të ndryshme neuronesh.

Grupi i parë përcakton ritmin themelor të frymëmarrjes dhe i jep mushkërive dhe krahërorit sinjal që të marrë frymë. Kësisoj ne thithim ajrin që na duhet.

Grupi i dytë i qelizave përcakton shpejtësinë dhe mostrën e frymëmarrjes sonë. Megjithatë, kur vjen radha e grupit të dytë për të luajtur rolin e tij, qelizat sinjalizojnë grupin e parë që ai të ndalë veprimtarinë e tij. Kjo kontrollon kapacitetin e ajrit të mushkërive tona, dhe frymëmarrja përshejtohet.

Grupi i tretë, nga ana e tij, zakonisht nuk është aktiv. Ato hyjnë në punë kur një ritëm i lartë frymëmarrjeje nevojitet dhe ato sigurojnë që muskujt e barkut të marrin pjesë duke u dërguar atyre sinjale.



Këtu, unë përkthyesi, e pashë me vend të sjell një pjesë të marrë nga një tjetër burim mbi frymëmarrjen:

Dhimbja e mbajtur në bark ose në shakrën e dytë.

Heqja e kësaj dhimbjeje është një parakusht përpara se të fillojmë të veprojmë si qenje të vërteta njerëzore.

Kur jemi duke ndenjur ne na duhet të marrim frymë vetëm me bark për të përfutur sasinë e nevojshme të oskigjenit që i duhet trupit. Përdorimi i plotë i mushkërive

neve na duhet vetëm kur punojmë gjatë një ushtrimi të vështirë. Prandaj, kur nuk çojmë dot frymë në bark, ne zakonisht frymëmarrim ose me krahëror ose me klavikulat. Krahërori mund të përçojë oksigjenin në gjendje pushimi, pa nevojën e barkut, dhe ka siklet vetëm gjatë një ushtrimi të lodhshëm. P.Sh: ato mund të stërmundohen gjatë dhe pas diçkaje, si aerobikut. Gjithësesi, kur marrim frymë vetëm me krahëror, atëherë kjo frymëmarrje përbën vetëm gjysmën e oksigjenit që nevojitet kur jemi duke ndenjur. Ne marrim frymë më shpejt. Dhe prapë, oksigjeni shterron në pjesën e pandërgjegjshme të mendjes e cila monitoron nivelin e dyoksidit të karbonit në gjak, nëpërmjet një shqise në arterien karotide, përmes së cilës gjaku hyn në tru. Mendja e pandërgjegjshme thotë: «O trap, merr frymë më shpejt, se po vdes!»

A është e tërë kjo e mjaftueshme për të na mbajtur ne gjallë? Jo.

Frymëmarrja kontrollohet gjithashtu kimikisht. Qëllimi i frymëmarrjes është që të mirëmbajë balancën e rregullt të oksigjenit dhe të dyoksid karbonit në gjakun tonë. Çdo ndryshim në këtë balancë aktivizon një grup qelizash në qendrën e frymëmarrjes, duke e sjellë nivelin prapë normal me një përshtatje mjaft të ndjeshme.

Por sasia e oksigjenit në gjak nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në qendrën e frymëmarrjes. Në atë rast, si vetëdijësohet qendra e frymëmarrjes për ndryshimin e nivelit të oksigjenit në gjak?

Në këtë pikë, një tjetër grup qelizash hyn në veprim, duke shfaqur një ndërgjegje të mrekullueshme. Në venat e

mëdha jashtë trurit, të tilla si damarët e qafës, receptorët me ndjeshmëri të lartë dërgojnë sinjale tek qendra e frymëmarrjes kur niveli i oksigjenit bie poshtë një niveli të caktuar. Në këtë mënyrë, frymëmarrja rregullohet me sintonim mjaft të imët.

Si mundet që një grup qelizash të dijë se sa oksigjen i nevojitet trupit që të mbetet gjallë?

Si e kanë përdorur këto qeliza një mekinzëm të tillë, i cili ka qenë aty në vend qysh prej njeriut të parë e gjer tani, kur vetëm gjatë 20 vjetëve të fundit shkenca ka mundur ta zbulojë këtë mekanizëm?


Veç të tjerash, ky mekanizëm është aq i ndjeshëm saqë për gjatë gjithë jetës sonë, kurrë nuk është bërë gabim kur ulemi, vrapojmë apo flejmë. Ai siguron që në çdo sekondë, oksigjeni jetik dërgohet tek 100 trilionë qelizat e tjera në trupin tonë, dhe që produktet mbetje të dëmshme si dyoksid karboni dhe jonet hidrogjenike hiqen me shpejtësi.

Edhe pse ata e dinë të vërtetën, të përkushtuar fanatikisht ndaj teorisë së evolucionit, për shkak të merakut të tyre me materilizmin, ata thonë se kjo përsosmëri ndodh si rezultat i rastësisë së verbër. Ndërsa Krijuesi i këtij rendi të përkryer është qartësisht Pronari i zgjuarësisë së pafundme – pra, Zoti.

QELIZAT TUAJA MUND TË BËJNË ATË QË TI S'MUNDESH DOT.

Shtiru sikur para teje janë vendosur mostra të ndryshme metalesh pluhur dhe të kërkohet të përcaktosh se cilit metali i përket secili prej tyre. A do të ishin të sakta përgjigjet tuaja?

Nëse nuk je i arsimuar në fushën e metalurgjisë, kjo do të ishte e pamundur për ty. Por kjo analizë, të ciën një qenie e gjallë si ti nuk mund ta kryejë, bëhet fare kollaj prej afërsisht 100 trilionë qelizash në trupin tënd – dhe pa u menduar fare, sorollatur a munduar. Veç kësaj, jo vetëm se qelizat në trupin tënd e kanë këtë aftësi, por kështu bëjnë edhe trilionat e panumërta të qelizave të trupave të miliarda njerëzve që kanë jetuar ndonjëherë në Tokë.



Shumica e njerëzve nuk mund t'i dallojnë mineralet që kanë para syve. Megjithatë, qelizat në trupin tonë mund të dallojnë mes mineraleve, oksigjenit, natriumit dhe kripës, i izolojnë elementët dhe i përftojnë ata.

Qelizat tuaja lehtësisht mund të njohin hekurin, i cili i nevojitet trupit tuaj, dhe mund ta thithë atë për ta përdorur. Me të njëjtën lehtësi, qelizat mund të njohin nitrogjenin fosforik, oksigjenin, natriumin, potasin e substanca të tjera dhe mund t'i mbledhë ato së bashku për përdorim, ose përndryshe të magazinojë tepricën. Ato madje nxjerrin jashtë çdo material të tepërt që nuk nevojitet.

Ki parasysh se qeliza është një strukturë e përbërë prej proteinash, molekulash, e atomeve dhe është gadi një e njëmijta e milimetrit në përmasë. Ajo nuk ka duar apo krahë, as sy e veshë apo tru. Përndryshe nga ju, ajo nuk ka ndërgjegje apo ndërdije. Nëse kështu, si mund t'i njohë ajo këto substanca?

Aftësia është shpënë prej frymëzimit të Zotit tek secila qelizë. Është Pronari i diturisë dhe fuqisë që e jep këtë aftësi që kërkon largpamësi dhe ndërgjegje, mbi atomet qorre dhe të pandërgjegje.

JETA JUAJ VAZHDON FALË NDARJES SË NDËRGJEGJSHME TË PUNËS NË QELIZAT TUAJA.

Vitamina B12 është shumë e rëndësishme për vazhdimësinë e jetës sepse ajo përdoret në prodhimin e gjakut; mungesa e Vitaminës B12 e cila çon në anemi, që çon në vdekje. Megjithatë, trupi nuk mund ta përdorë


këtë vitaminë vetë më vete. Prandaj, mukoza e stomakut sekreton një substancë që lejon përthithjen e vitaminës B12 dhe të luajë rolin e saj jetik në prodhimin e gjakut. Në një vend të posaçëm në zorrën e hollë, ka qeliza, detyra e vetme e të cilave është përthithja e vitaminës B12.

Tani, prodhimi i gjakut, pas një sërë procesesh të ndërlikuara, ndodh kryesisht në palcën e kockave. Por e shumta e palcës së kockave ndodhet larg nga stomaku. Si mundet që përdorimi i një vitamine të nevojshme për palcën e kockave të mvaret nga një substancë e prodhuar nga qeliza stomaku? Dhe si ndodh që ca qeliza, në një vend të veçantë në zorrë, të marrin përsipër detyrën e përthithjes së kësaj vitamine?

Që të ndodhë e gjitha kjo, qelizat si në stomak dhe në zorrë të holla duhet të kenë dituri, të jenë në dijeni dhe në kontroll të hollësive të prodhimit të gjakut – një proces që zhvillohet larg prej aty. Veç kësaj, ata duhet të kuptojnë sa i rëndësishëm ky prodhim është për trupin. Shkurt, në vendet më të thella e më të errëta të trupit tuaj, sistemet dhe porceset çuditërisht të ndërgjegjshme, ndodhin mes qelizave, duke i lënë shkencëtarët të shtangur tek mësojnë për to.

Pa asnjë dyshim, këto qeliza nuk mund të urdhërojnë procese kaq qartësisht të ndërgjegjshme e pa të meta që të ndodhin. Kush e krijoi vitaminën B12 dhe i pajisi qelizat me dituri që ta përdorin atë? Është Zoti, Zoti i qiejve dhe i Tokës.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*




QË GJËRAT TË NDODHIN NË QELIZAT TUAJA, LYPSET DITURI.

Ushqimi i tretur që ka ardhur nga stomaku tek zorrët përmban acide shumë të forta – duke paraqitur një rrezik serioz për duodenin. Sepse, përndryshe nga stomaku, duodeni (pjesa fill pas stomakut që lidh zorrën me të- ship) nuk ka shtresë speciale që ta mbrojë atë nga acidi.

Pra, si ka mundësi që duodeni i shpëton dëmtimit nga këto acide në ushimin e tretur? Që të përcaktohet përgjigja ne na lypset të këqyrim gjërat që ndodhin gjatë tretjes, dhe një dituri mbi proceset mahnitëse që ndodhin në trupin tonë.

Kur niveli i acidit që arrin duodenin nga stomaku bëhet rrezikshmërisht i lartë, muret e duodenit lëshojnë një hormon të quajtur sekretin, i cili e mbron duodenin dhe gjendet në zorrën e hollë në një trajtë jo aktive, e quajtur prosekretin. Në kontakt me acidin, prosekretini kthehet në sekretin.

Ndërgjegje në qelizë – harun jahja



I lëshuar në sistemin e qarkullimit të gjakut, sekretini lëviz drejt pankreasi ku nxit lëshimin e enzimave. Pankreasi, duke mësuar prej pranisë së sekretinit që ai është në telash, i dërgon duodenit jone bikarbonati që neutralizojnë acidin dhe kështu mbron duodenin.

Si ndodhin këto procese kaq jetike për jetën e njeriut? Dituria e substancës së nevojshme për qelizat e duodenit, dhe format për t'i aktivizuar ato, gjenden në pankreas.


Se si e kupton pankreasi mesazhin e dërguar prej duodenit, dhe lëshimi pastaj i joneve bikarbonate, janë të gjitha të mbinatyrshme.

Këtu, duke folur rreth qelizave të zorrës së hollë, ne përdorim terma si dituri dhe kuptim, për të theksuar dukuritë që ndodhin në trupin e njeriut. Gjithësesi, siç çdo njeri i ndërgjegjshëm mund të jetë mirënjohës, për një qelizë është e pamundur të mendojë, të ketë vullnet për të marrë vendime, ose të dijë ç'ndodh me organet e tjera dhe të prodhojë enzima dhe hormone në kundërpërgjigje nga ana e saj.

Poseduesi i vetëmqënë i diturisë, që i ka krijuar këto qeliza së bashku me këto veti, është Zoti. Me këto veçori që Ai ka krijuar në trupin tonë, ai na demonstroi fuqinë e Tij të pafund.


KUR HA SHEQER, NJË FABRIKË GJIGANDE FUTET NË PUNË NË TRUPIN TËND

Nëse ndodh që ti të hashë ushqime që përmbajnë sheqer më shumë sesa ç'të nevojitet, ç'e shmang rritjen e sheqerit në gjakun tënd?



Veç këtyre, në pjesën e brendshme të qelizës ka qeska glukozë.(3). Disa janë afër membranës së qelizës (4). Me marrjesn e sinjalit, këto qeska lëvizin drejt membranës së qelizës dhe bashkohen me të (5) duke ekspozuar bartësit e glukozës (6). Me rritjen e numrit të proteinave bartëse që shpien glukozën në qelizë, niveli i sheqerit në gjak bie dhe prodhohet më pak insulinë. Shumë pak më vonë, një pjesë e membranës së qelizës, bashkë me proteinat bartëse rrokulliset drejt brendësisë së qelizës (7) duke formuar një fshikëz (8). Duke lëvizur drejt mesit të qelizës, ajo bashkohet me endosomiom (8). Këtu, sapo të jenë formuar qeska të reja, ajo pret për një sinjal të ri (10), dhe procesi vazhdon.

Ndërgjegje në qelizë – harun jahja



Para së gjithash, qelizat në pankreas pikasin dhe izolojnë molekulat e sheqerit, nga qindra molekula në gjak. Pos kësaj, ato vendosin nëse numri i këtyre molekulave është shumë i madh apo shumë i vogël – pra, ato janë numëruar efektivisht. Qelizat e vockëla që ti as nuk mund t'i shohësh dot me sy të lirë, që nuk kanë as sy, as tru apo duar, mund të llogarisin numrin e molekulave të sheqerit në plazmën e gjakut – kjo me siguri është diçka që ia vlen të mendosh.

Nëse këto qeliza të pankreasit përcaktojnë se gjaku përmban së tepërmi molekula sheqeri, ato vendosin ta magazinonjë këtë sheqer të tepërt. Megjithatë, ato nuk mund ta kryejnë të vetëm këtë proces depozitimi, ndaj, nxisin të tjera qeliza që ndodhen shumë larg tyre për ta bërë këtë punë për to.

Por këto qeliza të largëta nuk depozitojnë sheqer po nuk morën urdhër për këtë. Kështuqë, qelizat e pankreasit lëshojnë një hormon që u tregon këtyre qelizave të largëta të fillojnë të depozitojnë sheqer. Formula për këtë hormon, të cilën ne e quajmë insulinë, është koduar në ADN-në e qelizave të pankreasit, meqë ato janë të parat që janë formuar.

Më pas, enzima të posaçme, ose proteinat punonjëse që gjenden në qelizat e pankreasit e lexojnë këtë formulë, pastaj fillojnë prodhimin e insulinës sipas udhëzimit të saj. Për të ndikuar në këtë sintezë, qindra enzima të ndryshme futen në punë në detyra të ndryshme.

Insulina e sintetizuar pastaj dërgohet për tek qelizat e synuara, nëpërmjet gjakut – që është mënyra më e shpejtë dhe e sigurt.

Qeliza të tjera që lexojnë porosinë e insulinës për të depozituar sheqer, i binden këtij urdhëri pa dështim. Portat hapen, duke lejuar molekulat e sheqerit të kalojnë nëpër to për në qeliza.

Megjithatë, këto porta nuk hapen të gjitha, pa dallim. Nga qindra molekula të ndryshme në gjak, qelizat depozituese izolojnë, kapin, dhe sjellin brenda vetëm molekulat e sheqerit.

Qelizat në asnjë rrethanë nuk i kundërshtojnë urdhërat që u vijnë atyre. Ato nuk e keqlexojnë urdhërin, ose të mundohen të kapin molekula të tjera, apo të mundohen të depozitojnë më shumë sheqer nga ç'u duhet. Ato punojnë me një disiplinë të lartë.

Kur ti pi çaj që ka shumë sheqer në të, ky sistem i jashtëzakonshëm futet në veprim dhe depoziton tepricën. Po të mos punonte ky sistem, niveli i sheqerit në gjakun tuaj do të rritej gjer në atë pikë sa që ti do të bije në koma e do të vdisje. Ky është një sistem kaq i përsosur sa që po të lindte nevoja, ai punon në drejtim krejt të kundërt. Nëse niveli i sheqerit në gjakun tuaj bie nën normalin, pankreasi prodhon një hormon krejt tjetër që quhet glukagon (glucagon), i cili i jep një komandë të njëjtave qeliza që e patën depozituar atë më parë: *Lësho sheqer në gjak!*- dhe këto qeliza binden.

Si ka mundësi që këto qeliza, q s'kanë tru, sistem nervor, sy ose veshë, mund të kryejnë një qarkullim kaq për së mbari dhe t'i kryejnë ato aq përsosur? Si mundet që ky ind pa ndërgjegje, produkt i proteinës dhe yndyrës, të kryejë funksione mahnitëse që madje as njerëzit nuk i kryejnë


dot? Cili është burimi i ndërgjegjes dukshëm të madhe, shpërfaqur prej këtyre molekulave të pandërgjegje? Të gjitha këto dukuri janë shenja të qarta të ekzistencës dhe fuqisë së Zotit, i cili është Sundimtari i tërë gjithësisë dhe gjithë krijesave.

PROVË E QARTË E KRIJIMIT: VESHKAT QË DALLOJNË MES GLUKOZËS, PROTEINËS DHE NATRIUMIT.

Përgjatë gjithë jetës suaj, dy veshkat tuaja pastrojnë gjakun që ju rrjedh nëpër trup.

Disa prej materialeve që ata filtrojnë jashtë gjakut dërgohen sërish në trup, ndërsa pjesa tjetër, që nuk përdoret më, shkarkohet në fshikëz. Po si e dallojnë veshkat proteinën, urenë, natriumin, glukozën dhe mjaft substanca të tjera?

Struktura që filtron produktet mbetje nga gjaku është një tog kapilarësh, i quajtur *glomerulus*, përndryshe nga kapilarët në pjesë të tjera të trupit, këta janë të rrethuar prej një membrane të përbërë nga tri shtresa. Dhe me përpikmëri të madhe, këto tri shtresa vendosin cilat substanca do të filtrohen dhe të nxirren jashtë, dhe cilat të mbahen e të dërgohen prapë në trup. Tani, në ç' baza – dhe me ç' mekanizma – i analizon një membranë qelize, një për një, substancat që vijnë përmes sistemit të qarkullimit të gjakut dhe të vendosë ku duhet të shkojnë?



Në çdo litër gjaku ka me dhjetra përzierje të tretura që arrijnë veshkat, përfshirë glukozë, bikarbonat, natrium, klorinë, ure, dhe kreatinë. Veshkat nxjerrin nga trupi disa prej këtyre substancave tërësisht, heqin vetëm pjesë të disa të tjerave, dhe akoma të tjera rikthehen krejtësisht në sistemin e qarkullimit të gjakut. Po si mundet një pjesë indi të vendosë cila substanca të hedhë tej, dhe sa? Përgjigja

ndodhet në faktin se indi veshkë është krijuar sipas një projekti të përsosur.

Veprimtaria e glomerulit përcaktohet nga ngarkesa elektrike dhe madhësia e molekulës që ajo zbulon në gjak. Kjo domethënë se glomeruli ka një aftësi të përcaktojë peshën e molekulës së natriumit dhe glukozës dhe ngarkesën negative të proteinave të gjitha të përziara në gjak. Në këtë mënyrë, proteinat jetike për trupin nuk hidhen tej, por mbahen për përdorim të mëtejshëm.

Por glomeruli është i përpërë vetëm prej kapilarësh. Si jua merr mendja juve që një strukturë mund të ketë një dallueshmëri kaq sipërore, edhe pse ajo kurrë nuk është arsimuar në kimi, fizikë apo biologji? Glomeruli mund t'i kryejë funksione të tilla pa gabim sepse ata veprojnë nëpërmjet frymëzimit të dhënë atyre prej Njërit që i ka krijuar ato – pra, Zoti.


Përzgjedhja e substancave prej tyre nuk i është lënë në asnjë rrethanë rastësisë. Po të ishte kështu, gjersa t'i pikasin molekulat e duhura këta organe pa ndërgjegje, trupat tanë nuk do të funksiononin më. E tërë kjo është vetëm një provë e krijesës së përsosur të Zotit.

Ç'NDODH NË TRUPIN TËND KUR TENSIONI I GJAKUT BIE.

Në jetën tonë të përditëshme, shpesh ne dëgjojmë njerëz të ankohen. «E kam tensionin e gjakut shumë të ulët» ose, «Kam tensionin e lartë». Madje, shumë pak prej tyre janë të vetëdijshëm se rregullimi i tensionit të tyre të gjakut është punë e veshkave.

Përpos mjaft funksioneve të tjera trupore, veshkat kanë marrë gjithashtu detyrën e ujdísjes së trysnisë apo tensionit të gjakut. Në përcaktimin e tensionit të gjakut, faktori më i rëndësishëm është sasia e lëngut në enët e gjakut. Së bashku me ndonjë rritje të lëngut në venat dhe arteriet, tensioni i gjakut rritet – duke shkaktuar kështu dëm afatgjatë tek të gjitha organet e trupit. Hipertensioni – dmth, një rritje në sasi e gjakut në sistem paraqet një gjendje të rrezikshme për qeniet njerëzore. Nëse nuk merren masa, kemi vdekje.

Trupi ka aftësi të ndjejë një rritje të lëngut në enët e gjakut, falë receptorëve që ndodhen në dhomat e përparme të zemrës. Zemra bymehet kur në të futet një sasi e madhe lëngu dhe, në përgjigje të kësaj, receptorët dërgojnë një sinjal në tru, i cili reagon duke bërë që arteriet renale (të veshkave, dmth) të rrisin veprimtarinë e tyre filtruese. Një rritje në trysninë e gjakut bën që zemra të bymehet apo tenodset edhe më tepër. Me këtë tendosje, fibrat e muskujve zgjaten, duke lëshuar molekulat



lajmëtare të ngujuara brenda tyre, të cilat pastaj futen në rugët e gjakut.

Kësisoj ky mesazh arrin veshkat përmes çarkullimit të gjakut. Në reagim, sasia e lëngut të nxjerrë nga trupi rritet. Në këtë mënyrë, tensioni i gjakut rikthehet në normal, dhe zemra mund të rifillojë rrahjen e saj normale.

Detyra e veshkave për të rregulluar tensionin e gjakut nuk mbaron këtu. Në rrethana kur tensioni i gjakut është shumë i ulët, një enzimë e quajtur *renin* sekretohet prej qelizave të specilizuara të aparatit pranë-glomerular, ose JGA që ndodhet në veshka. Sidoqoftë, renini nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e tensionit të gjakut. Ai kombinohet me *angioteninogjenin*, një tjetër substancë e sekretuar larg në mëlçi, për të formuar *angiotensinin 1* në gjak.

Edhe një herë, angiotensini 1 nuk ka ndonjë ndikim të madh në tensionin e gjakut. Ky hormon nga ana tjetër shndërrohet në angiotensin 2, prej veprimit të një tjetër substance të pranishme në mushkëri të quajtur enzima angiotensino-konvertuese, ose ACE. Detyra e vetme e kësaj enzime është të zbusë angiotensinin 1.

Dhe kështu, produkti fundor i gjithë këtyre hapave është molekula e vetme që ndikon drejtpërdrejt enët e gjakut dhe zaten e sjell tensionin e gjakut sërish në normal. Nëse kjo molekulë vendimtare nuk sintetizohet, asnjë prej pararendësve të saj nuk mund të ketë ndonjë ndikim në tensionin e gjakut. Prapë, vetëm kur molekula angiotensin 2 i përgjigjet receptorëve të posaçëm në sipërfaqe të qelizës, tkurren enët e gjakut dhe tensioni rritet.

Këtu, pika më e rëndësishme që duhet të kihet parasysh është se secili prej efekteve të këytre substancave është i pavarur. Ngaqë mungesa e një molekule përkthehet si mungesë e të gjithave, si mundet atëherë që, qoftë edhe një prej këtyre hapave të ketë ecur përmes rastësisë? Sepse, ngase edhe një hap nuk mund të hidhet kuturu,

atëhere është e pamundur për të gjitha të tjerat të dalin në të njëjtën kohë, në një trup të vetëm.

Asnjë nuk mund të argumentojë se rastësitë mund t'i dhurojnë veshkave aftësinë e të kuptuarit, ose të kenë kujdes apo të marrin vendime. Që të gjitha këto hollësi ekzistojnë në të njëjtën kohë është një tregues i qartë se ato janë krijuar prej Zotit.




NDËRGJEGJA E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT

Oksigjeni është një prej substancave më të rëndësishme që nevojiten për jetën e indeve të trupit. Për këtë arsye, oksigjeni duhet të shpërndahet nëpër inde vazhdimisht, dhe në sasi të mjaftueshme. Një prej përbërësve më të rëndësishëm të trupit është sistemi i përsosur i qarkullimit të gjakut, i cili kryen pagabueshëm këtë detyrë të bartjes së oksigjenit. Kur oksigjeni nivelohet, indet bien, pason një rritje automatike dhe e konsiderueshme, e menjëherëshme e prurjes së gjakut. Ky është një fakt i njohur që nëse lind nevoja, prurja e gjakut mund të rritet prej faktorit VII.


Komponentët punues në këtë sistem përfshijnë indet, qelizat, enët e gjakut, dhe proteinat – asnjëri prej të cilëve nuk ka ndërgjegje, njohuri, ose mekanizëm vendimarrës. Më të shumtët e njerëzve e çojnë jetën e tyre duke mos e ditur madje se një mekanizëm i tillë ekziston! Pra, Kush është ai Posedues i njohurisë, mendjes, dhe aftësisë për të marrë vendime për të perceptuar zbritjen e nivelit të oksigjenit në inde, të informojë sistemin e qarkullimit të gjakut, të urdhërojë rritjen e prurjes së gjakut, dhe në fund ta sjellë prapë në normalitet prurjen e gjakut, pasi rreziku të kalojë? Kush e përcakton ç'lloj të dhënash duhen dërguar tek secila qelizë? Dhe si munden qelizat që marrin porosinë, e lexojnë, kuptojnë dhe e zbatojnë atë? Asnjë qelizë nuk mundet të ketë aftësinë të lexojë a të kuptojë! Edhe më shumë mud të hulumtohet mbi këtë temë; por

QARKULLIMI I GJAKUT NË TRUP



KAPILARËT

Kur niveli i oksigjenit në organë bie, dërgohet një mesazh për të shpejtuar sistemin e qarkullimit. Si rezultat, prurja e rritur e gjakut në indet u lejon organeve të përmbushin nevojat e tyre për oksigjen



Rruazat e kuqe oksigjen-bartëse

përfundimi do të jetë gjithmonë i njëjtë: Asnjë qelizë nuk ka ndërgjegje të aftë të kryejë këto procese që të mirëmbajë balancën e nivelit të oksigjenit.

Sikurse me të gjitha krijesat e gjithësisë, të gjalla e të pajeta, strukturat dhe sistemet në trupin tonë të gjithë veprojnë sipas urdhrave të Zotit. Ndërgjegja në çdo atom, molekulë, proteinë në qelizë, organe, dhe trupat e të gjitha krijesave është produkt i krijueshmërisë së Zotit.


OXSIDI NITRIK: MOLEKULA MREKULLI QË ZGJERON ENËT E GJAKUT.

Tre shkencëtarët që fituan Çmimin Nobel për Fiziologji ose Mjekësi më 1998 zbuluan se molekula e oksidit nitrik (NO), lëshuar në enët e gjakut, kishin aftësinë t'i shlodhin ato. Molekula NO rregullon tensionin në muret enëve të gjakut, por nuk e kryen këtë veprim vetëvetiu. Përkundrazi, ajo funksionon si ndërmjetëse në lehtësimin e enëve të gjakut.

Për të kuptuar se si punon ky proces kaskadë, këqyr diagramën në faqen tjetër. Që enët e gjakut të zbuten, para së gjithash, disa hormone në gjak e fillojnë procesin duke dërguar një sinjal alarmi, lidhur me receptorët që gjenden në muret e enëve të gjakut. Ne mund ta krahasojmë këtë me një efekt domino, kur një gur bie dhe pas tij rrëzohen të gjithë të tjerët me radhë. Menjëherë fill pasi hormoni jep alarmin duke u lidhur me receptorin, veshja e enës së gjakut kupton ç'i duhet të bëjë dhe fillon të prodhojë oksid nitrik. Disa prej molekulave NO, duke ditur se ç'u duhet të bëjnë sapo janë lëshuar, drejtohen shumë vrik për tek qelizat e muskujve të butë vaskularë. Me këtë veprim të *miosinit* bie dominoja e fundit, dhe qelizat e muskujve shlodhen.

Duke i rishikuar këto hapa , ne shohim se hormonet dhe qelizat pjesëmarrëse në këtë proces veprojnë tërësisht me

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



një sjellje të vetëdijshme. Hormonet alarmuese të gjetura në gjak shkojnë në vendet e duhura, duke ndikuar në veshjet e enëve të gjakut dhe nisur procesin. Një mprehtësi e ngjashme shfaqet përgjatë pjesës tjetër të të gjithë procesit. Çdo sinjal shkon tek vendi i duhur në trup, kurrë nuk humbet në atë vend aq të errët, dhe gjithmonë arrijnë me sukses.

Po si mundën këto qeliza, hormone dhe molekula të kryejnë kaq veprime të ndërgjegjshme? A mundet kjo ndërgjegje të jetë një prej vetive të lindura të tyre? Sigurisht

që jo! Por dituria dhe ndërgjegja është sigurisht e domosdoshme për t'i drejtuar të gjithë këta procese, që t'i njoftojnë qelizat se kur dhe çfarë të prodhojnë dhe të lajmërojnë hormonet dhe molekulat e tjera për adresën e saktë dhe t'u tregojnë rrugën për atje. Frymëzimi i kësaj diturie të pafund, njoftimi i qelizave, hormoneve dhe molekulave të tjera mbi veprimet e tyre të domosdoshme, dalin nga Zoti.

PËR TË PROVUAR GJEPURAT E DARVINIZMIT MJAFTON VETËM NJË SHEMBULL

Është tepër e palogjikshme të thuash se miliona ndodhi, të gjitha të ngjasin rastësisht, i dhanë jetë materjes së pajetë dhe formuan procese të përsosur dhe struktura dizjani pa të metë. Për të kuptuar këtë, duhet vetëm të këqyrësh shembullin në vijim:

Një nga proteinat transportuese në gjak, e quajtur albuminë, lidhet me lipide të tilla si kolesteroli dhe me hormonet, vrerin dhe ilaçet e tilla si penicilina. Pastaj ajo qarkullon nëpër sistemin e gjakut duke kaluar nëpër gjithë trupin pas të cilit arrin në mëlçi dhe depoziton aty toksinën që ka mbledhur e të neutralizohet, dhe pastaj vazhdon të transportojë lëndët ushqyese dhe hormonet kudo që nevojitet të shkojnë.

Tani bëji vetes këto pyetje:


1. Si mundet që një molekulë si albumina, e përbërë prej atomeve dhe pa patur ndërgjegje apo njohuri, dallon mes lipideve dhe toksinave, ilaçeve dhe lëndëve ushqyese?
2. Për më tepër, si mund të njohë ajo mëlçinë, tëmthin, dhe stomakun e pastaj të çojë substancat e duhura për në vendet e duhuara çdo herë, duke mos u ngatërruar kurrë apo të humbë rrugën?

Po të vështrosh me mikroskop toksinat, ilaçet dhe lëndët ushqyese të barten në gjak, nuk do mund të dallosh mes tyre po nuk pate arësim mjekësor. Me siguri nuk do të mund të përcaktosh sa dhe ç'loj substance duhet të shkojë tek secili organ.

Disa atome pa ndërgjegje, përzier në proteinë albumine kanë kryer pa gabime fare këtë detyrë në trupat e qënieve njerëzore me miliona vjetë – një proces që shumica e njerëzve nuk mund ta drejtonin po të mos stërviteshin.

Padyshim kjo shfaqje e qëllimit dhe synimit prej një grupi atomesh është e mundur vetëm prej fuqisë dhe diturisë së pafund të Zotit.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



ÇDO PROTEINË NË TRUPIN TUAJ KA DIZAJN PA TË META DHE DETYRA JETIKE


Mënyra më efikase për të treguar se ndërgjegja nuk ka fuqi të krijojë është si të shpjegosh provat e ekzistencës së Zotit. Merr një shmebull nga trupi yt.

Si të çohesh më këmbë apo të ngresh krahët, të gjitha lëvizjet tuaja kryhen si rezultat i veprimit të muskujve. Që ne t'i kryejmë këto veprime, qelizat e muskujve kërkojnë një furnizim të vazhdueshëm me oksigjen. Detyra e shpënjes së oksigjenit tek qelizat e muskujve është marrë përsipër nga një prej proteinave të trupit tonë, e quajtur mioglobinë. Ajo i ngjan shumë hemoglobinës, një tjetër proteinë detyra e së cilës është të çojë oksigjen në gjak. Por ndryshimi mes këtyre dyjave është se mioglobina ka vetinë të bartë një molekulë të vetme oksigjeni. Për shkak të kësaj veçorie të mioglobinës, prurja e oksigjenit për në qelizat e muskujve kryhet ngadalë, e rregulluar.

Ki parasysh se hemoglobina, proteina që shpie oksigjen në gjak, këmben vendet me mioglobinën që çon oksigjen nga mushkëritë për tek qelizat e muskujve. Në një gjendje të tillë, mioglobina nuk i shpie dot oksigjen të mjaftueshëm trupit. Nga ana tjetër, hemoglobina do të shpjerë shumë më tepër oksigjen tek indet e muskujve dhe do ta depozitojë atë menjëherë, duke përmbysur ekuilibrin e gjithë trupit. Por një gjë e tillë nuk ndodh kurrë, dhe të dyja proteinat gjenden gjithmonë në vendin dhe kohën

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Mioglobina, e caktuar me detyrë të shpjerë oksigjen tek muskujt ka kapacitet të bartë molekulë një oksigjenëshe. Por, hemoglobina, e cila shpie oksigjen tek indet e tjera, ka një kapacitet më të lartë oksigjen-bartës. Kështu çdo lloj indi merr aq oksigjen sa ç'u nevojitet.



e duhur. Si rezultat, ne marrim frymë pa siklet dhe mund të lëvizim lirshëm si të na pëlqejë.

Doemos, hemoglobina dhe miglobina janë vetëm dy prej proteinave që gjenden në trupin e njeriut.

Ngjashmërisht, proteina të tjera në trup kanë vetitë që

përbushin

nevojat e trupit dhe prodhohen aty ku duhen. Sikurse e tregojnë këta shembuj, është e pamundur që dizajni i përkryer i trupit të njeriut të ketë ardhur nga rastësia. Pronari i këtij dizajni është Perëndia, Zoti i botëve.

ENZIMAT QË IDENTIFIKOJNË GABIMET

Për shkak të faktorëve të jashtëm, në ADN, banka e të dhënave të trupit, nganjëherë ndodhin gabime. Por këto gabime ndreqen menjëherë prej mekanizmit të kontrollit ose procesit të riparimit, të ndikuara nga enzimat të sintetizuara sipas të dhënave që gjenden në vetë ADN-në

Radha e punës për riparim përbëhet nga një numër hapash:

1- Një enzimë e quajtur nukleas (bërthamë) ADN-je identifikon pjesën e dëmtuar të fillit të ADN-së

2- Nukleasi i ADN-së heq pjesën e identifikuar si të gabueshme, duke krijuar një hapësirë në fill.

3- Një tjetër enzimë e quajtur polimerasë ADN-je identifikon dhe ndreq të dhënat nga filli i padëmtuar i ADN-s, pastaj ndreq fillin e dëmtuar sipas këtij modeli të padëmtuar.

4- Megjithatë, procesi i ndreqjes nuk mbaron këtu. Një hapësirë është lënë në shtyllën kurrizore të sulfatit të sheqerit në vendet ku është bërë riparimi, por një enzimë e quajtur *ligasë* ADN-je e mbush këtë hapësirë.

Siç mund ta kuptoni nga funksionet që ata kryejnë, enzimat që riparojnë ADN-në kanë mjaft funksione të shumëfishta. Që të riparohet ADN-ja, ato duhet të jenë mjaft të njohura me të. Për më tepër, ato lypset të dinë ku t'i gjejnë të dhënat e sakta, dhe si ta mbushin hendekun që rezulton.

Ndërgjegje në qelizë – harun jahja



1-Gjatë sintezës së ADN-së enzimët e bërthamës së ADN-së, secila më vete këqyr për gabime në secilin çift fijesh.




2-Me të diktuar një gabim, ajo menjëherë heq kimikatin e çrregullt.



3- Në këtë pikë enzima e polimerasit të ADN-së vepron për të sjellë aty kimikatin e duhur


Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



4- Duke përdorur këtë komponent të duhur, polimerasi i ADN-së mbush pastaj këtë të çarë



5- Një enzimë e tretë e quajtur ligasë ADN-je pikas fillin e këputur dhe shkron aty.



6- Dhe duke përdorur materjalin e duhur, ajo mbush të çarën.

Pjesa më mahnitëse është se sinteza e ADN-së dhe enzimat që e kontrollojnë sintezën e saj prodhohen të gjitha sipas të dhënave të depozituara brenda asaj të njëjtte ADN, dhe kontrollohen prej proteinave të bëra nga ajo ADN. Është e pamundur për këtë sistem magjepsës, me procese që ndodhin brenda proceseve, që të kenë dalë me etapa, nga rastësia. Që enzimat të ekzistojnë, duhet që më parë të ekzistojë ADN-ja, dhe që të ekzistojë ADN-ja, enzimat po ashtu duhet të ekzistojnë më parë. Por, me qëllim që ato të dyja të ekzistojnë, qeliza dhe membrana e të gjitha organelet e ndërlukuara duhet gjithashtu që të jenë të pranishme.

Teoria e evolucionit dhe pohimet se gjallesat janë bërë gradualisht, si rezultat i një rastësie të dobishme mohohet vendosmërisht nga paradoksi ADN-enzimë, sepse ADN-ja dhe enzimat e saj duhet të jenë aty në të njëjtën kohë. Kjo tregon evidencën e një krijese të ndërgjegjshme.

A është Ai që krijon njëlloj me atë që nuk krijon?

Pra, nuk do t'i kushtonit vëmendje?

(Kur'ani, 16:17)

BESIMI NË DARVINIZËM ËSHTË AQ LOGJIK SA TË BESOSH PËRRALLËN E ZANAVE

Shkronjat që shihni në faqen tjetër nuk janë në një rend të rastësishëm. Zaten, ato janë pjesë e përshkrimit që mban të dhënat mbi hemoglobinën, proteinën që çon oksigjen në gjak. Ky përshkrim është regjistruar në ADN, i cili përmban të gjitha të dhënat e rëndësishme për të gjithë trupin. Kur hemoglobina duhet të sintetizohet, shkronjat përzgjidhen prej tre miliardë sosh që gjenden në ADN. Ky proces përzgjedhjeje kryhet nga polimerasi RNA, një enzimë aq e përpikët dhe e kujdesshme, saqë kurrë nuk gabon në leximin apo zgjedhjen e shkronjave prej miliarda të tillave. Ajo identifikon çdoherë ato që duhen.

Pas përzgjedhjes së shkronjave të duhura dhe duke përvetësuar përshkrimin e proteinës, ajo shkon tek *ribozomet*, qendra e prodhimit për sintezën e proteinës.

Ribozomet lexojnë përshkrimin me të njëjtën përpikmëri dhe kujdes dhe, duke kuptuar porosinë, ato kësodore fillojnë të sintetizojnë proteinën pa asnjë gabim.

Kjo është një veprimtari e planifikuar dhe mjaft e organizuar, mu ashtu si arkitektët dhe inxhinierët projektojnë një rrokaqiell me teknologjinë më të fundit, plan të cilin pastaj ata e lënë në duart e ndërtuesve specialistë dhe teknikëve.

Darvinisët, nga ana tjetër, thonë se kjo shkallë superiore organizimi është një pjesë e vogël që as nuk mund të

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Shkronjate mëposhtme janë udhëzime për prodhimin e hemoglobinës. Kur trupit i nevojitet hemoglobinë, një enzimë e quajtur polimerase NRA-je i identifikon këto shkronja një për një prej 3 miliardëve sosh të ADN-së, bën një kopje të tyre dhe i rendit ato siç duhen. Më vonë i përcjell udhëzimet e kopjuara tek vendi në qelizë ku do të kryhet prodhimi.

```
CCCTGTGGAGCCACACCCTAGGGTTGGCCAATCTACTCCCAGGAGCAGGGAGGGCAGGAG
CCAGGGCTGGGCATAAAAGTCAGGGCAGAGCCATCTATTGCTTACATTTGCTTCTGACAC
AACTGTGTTCACTAGCAACTCAAACAGACACCATGGTGCACCTGACTCCTGAGGAGAAGT
CTGCCGTTACTGCCCTGTGGGGCAAGGTGAACGTGGATGAAGTTGGTGGTGAGGCCCTGG
GCAGGTTGGTATCAAGGTTACAAGACAGGTTAAGGAGACCAATAGAACTGGGCATGTG
GAGACAGAGAAGAAGCTTTGGGTTCTGATAGGCACTGACTCTCTCTGCCTATTGGTCTAT
TTTCCCACCCTTAGGCTGCTGGTGGTCTACCCTGGACCCAGAGGTTCTTTGAGTCCTTT
GGGGATCTGTCACCTCCTGATGCTGTTATGGGCAACCCTAAGGTGAAGGCTCATGGCAAG
AAAGTGCTCGGTGCCTTTAGTGATGGCCTGGCTCACCTGGACAACCTCAAGGGCACCTTT
GCCACACTGAGTGAGCTGCACCTGTGACAAGCTGCACGTGGATCTGAGAACCTCAGGGTG
AGTCTATGGGACCCTTGATGTTTTCTTTCCCTTCTTTTCTATGGTTAAGTTCATGTCAT
AGGAAGGGGAGAAGTAACAGGGTACAGTTTGAATGGGAAACAGCAATGATTGCATCA
GTGTGGAAGTCTCAGGATCGTTTTAGTTTTCTTTATTTGCTGTTCCATAACAATTGTTTTT
TTTTGTTAAATCTTGCTTTCTTTTTTTTTCTTCTCCGCAATTTTTACTATTATACTTAA
TGCCTTAACATTGTGATAACAAAAGGAAATATCTCTGAGATACATTAAGTAACTTAAAA
AAAACTTTACACAGCTGCCTAGTACATTACTATTTGGAATATATGTGTGCTTATTGTC
ATATTCATAATCTCCCTACTTTATTTTTCTTTATTTTTAAATGATACATAATCATTATA
ATATTTATGGGTTAAAGTGTAATGTTTTAATATGTGTACACATATTGACCAAATCAGGGT
AATTTTGCAATTTGTAATTTTAAAAAATGCTTTCTTCTTTTAAATATACTTTTTGTTTATC
TTATTTCTAATACTTTCCCTAATCTCTTTCTTTTCAGGGCAATAATGATACAATGATCAT
GCCTCTTGTGACCATTCTAAAGAATAACAGTGATAATTTCTGGGTTAAGGCAATAGCAAT
ATTTCTGCATATAAAATTTCTGCATATAAATTGTAACGTGATGAAGAGGTTTCATATTG
CTAATAGCAGCTACAATCCAGCTACCATTCTGCTTTTATTGTTTATGGTTGGGATAAGGCTG
GATTATTCTGAGTCCAAGCTAGGCCCTTTTGCTAATCATGTTCCATACCTCTTATCTTCT
CCACAGCTCCTGGGCAACG.CCCCTTAAAAGGGCCCAAATGAATTGCCCGTCA-
CATTGTGCATCTTTTAAAGTATTCGTAAGGGGGTTTTTTTAAAGGGGGTTAGCACC-
CCCCCCCCCCCCCCCCCTTTTTTTTTTCCCCCCCCCCCCCAGCCCTTTTTTTTT
AAGAGATAATCGATGACTGCATCGTACTGACTGCATGCATCGATCGATCGTACTGACT-
GCATGCATGCATCGATCGATGCACGTACTGACTGACTGACTGACTGCATGCATGCATG-
CATGACTGAGCTGACTGCATCGTACTGACTGTTTGATTTATATACTGACTGCATGCAT
CGTACTGTGCATGACTGTAGTGTATGACTGCATGCATGTTGTGTTGTGTTGTGT
```

shihet me sy të lirë, ka ndodhur prej rastësisë. Ata thonë se molekulat e formuara nga atome të pajetë, qorrë dhe të pandërgjegje, shfaqin vazhdimisht mprehtësi dhe diqysh drejtojnë dhe projektojnë një plan dhe organizim të fillë të pacen.

Të besosh në një pohim të fillë si ky është aq logjik sa të besosh se përrallat e Zanave janë të vërteta. Por Darwinizmi i ka hipnotizuar mjaft njerëz dhe ua ka bllokuar aftësitë e të kuptuarit.

ENZIMAT QË POSEDOJNË NDËRGJEGJE, DITURI DHE MJESHTËRI

Kur një proteine i duhet të sintetizohet në qelizë, një enzimë e quajtur RNA polimerase shkon tek banka e të dhënave të qelizës, gjen të dhënat në ADN që lidhen me proteinën, pastaj bën një kopje të saj për vete. Por të dhënat rreth proteinës nganjëherë gjenden të shpërndara gjithandej vendeve të ndryshme të ADN-së. Ngaqë RNA polimerase bën një kopje të krejt ADN-së – nga ku informacioni fillon aty ku mbaron – pashmangshmërisht përfundon kopjimin e vendeve që nuk nevojiten. Prania e të dhënave të panevojshme pastaj rezulton në fillimin e sintetizimit të një proteine të kotë. Në këtë fazë, enzimat e quajtura *spliceosome* (këtu, *splice*, dmth bashkim me ngjitje, thurje), vijnë në ndihmë për shpëtim dhe, me saktësi të madhe e pikasin dhe heqin informacionin e parëndësishëm prej qindra mijëra grimca të dhënadh, dhe së fundmi i bashkohet zinxhirit të mbetur.

Molekulat, të përbëra prej disa atomeve, shfaqin një vetëdije të madhe në këtë proces të ngjitje-shtesës së RNA-së. Praktikisht ato punojnë si redaktorët, që vendosin dhe ndreqin të metat dhe gabimet në zinxhir. Këta atome e njohin proteinën që polimerasi RNA mundohet të bëjë, mund të dallojë mes të dhënave jetike dhe të


panevojshme që duhet për ta prodhuar atë, dhe mund të sendërtojë prodhimin e proteinës së posaçme në fjalë nga qindra mijëra grimca të dhënash – të gjitha pa gabim. Veç të tjerash, ata e dinë menjëherë kur do të nevojiten dhe menjëherë shkojnë tek vendi i duhur për të filluar punën.

Gjithçka e shpjeguar këtu është vetëm një pjesë e vogël e procesit ndër miliona që ndodhin brenda një qelize. Është krejt e pamundur që atomet të kenë ndërgjegjen, njohurinë, mprehtësinë, mjeshtërinë dhe bashkëpunimin që kërkon një proces i këtillë.


Por pohimet e evolucionistëve – që sistemi më i përosur i natyrës ka ndodhur si rezultat i rastësisë – kundërshton hapur të gjithë logjikën dhe kuptimin shkencor. Evolucionistët, duke besuar në të pabesueshmen, thonë se natyra sjell mrekullira, dhe mbledhjen e protoneve, neutroneve, dhe elektronet mund të veprojnë me ndërgjegje dhe dituri.

Por evolucionistët gabohen. Organizatori dhe regjisori i gjithë kësaj ndërgjegjeje dhe procesi të planifikuar është Zoti.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Në këtë pikë, enzimat e quajtura spiliceozome (shtuese) vijnë për shpëtim dhe zënë e përthyejnë fillin e kopjuar, në mënyrë që pjesa e paduhur formon një bërryl.



Në fund të këtij procesi, pjesa e paduhur e ADN-së shkëputet. Pjesët e rëndësishme pastaj bashkohen, dhe udhëzimet për të bërë proteinë dërgohen tek fabrika e prodhimit në qelizë.


PLANIFIKIMI I SHKATHËT DHE PRODHIMI KRYHEN NGA QELIZAT E KOCKAVE

Kur zënë të zhvillohen kockat, ata fillojnë si inde kërcëjsh. Me kalimin e kohës, pjesa e brendshme e kërcellit fillon të forcohet apo kalçifikohet dhe më vonë mbështillet në enët e gjakut prej qeliza kocke të quajtura *osteoblaste* dhe *osteoklaste*. Funkzioni i qelizave osteoklaste është që të shkërmoqë dhe të riformojë kockat. Këtë ata e bëjnë duke sekretuar enzima të posaçme. Duke mos ndenjur kot sakohë që osteoklastet bëjnë punën e tyre, qelizat osteoblaste formojnë kockën.

Si rezultat i bashkëpunimit mes këtyre dy grupe qelizash, kockat zhvillohen dhe më vonë formojnë kreuji skeletin.

Gjatë fëmijërisë, kur rritja është shumë e shpejtë, detyra e osteoblasteve është shumë më e vullshme. Formimi i kockave duhet të jetë më i shpejtë se shpërbërja apo shkërmoqja e kockave prej osteoklasteve, sapo skeleti ka arritur gjer në një farë shkalle pjekurie, megjithatë, procesi i formimit dhe shpërbërjes fillon të balancohet.

Qelizat që gjenden në kockat e çdo njeriu kryejnë të njëjtën detyrë. Ato të gjitha dinë të bëjnë kocka. Të vetëdijshe për ndryshimet, ato e dinë si t'i japin formë kockeve të kafkës dhe të kofshëve, shkallën e trashësisë secila kockë duhet të ketë, dhe kur të ndalojnë rritjen. Gjithashtu, ato veprojnë në vetëdije se ato kanë akoma punë për të bërë gjatë fëmijërisë. Nuk ka ngatërrim me



Skeleti i njeriut në figurën e mësipëme është ndërtuar hap pas hapi. Mu si skalitësit e vegjël, qelizat e kockës e gdhendin me kujdes skeletin e trupit. Kush i ka frymëzuar ato me diturinë e çdo hapi dhe si e ujdisin ato fortësinë, gjatësinë, formën, zgavrat dhe të dalat, dhe pikat e lidhjes? Ai që e ka projektuar dhe ndërtuar gjithë këtë kaq përsosmërisht është Zoti i Plotfuqishëm.

radhën e punës në secilin prej këtyre proceseve. Çdo grup qelizash hyn në veprim pikërisht në kohën e kërkuar, si rezultat i këtij formimi të planifikuar, çdo kockë përfiton strukturën dhe formën që asaj i duhet për të kryer funksionet e saj sa më me efikasitet.

Si e kanë fituar qelizat e kockës këtë aftësi të planifikimit dhe prodhimit? Një qelizë e formuar nga atome të pandërgjegjshme nuk mund të shohë përpara ose të marrë vendime. Ajo nuk mund të ketë dijeni mbi mundin ose ekuilibrin e trupit, të ndjejë nevojat e tij dhe të marrë masa sipas rrethanave. Por të gjitha trilionat e qelizave në trupit të njeriut veprojnë me një vetëdije të dukshme të qënies njerëzore, dhe madje shfaq një inteligjencë superiore. Ky është tregues që ata drejtohen dhe mbarështohen prej një fuqie superiore. Pronari i Madh i fuqisë që i frymëzon ato është Zoti.

***Ai është Zoti, Zoti juaj. Nuk ka Zot përpos Atij,
Krijuesit të gjithçkaje. Ndaj, adhuroje Atë. Ai
është përgjegjës për gjithçka.***

(Kur'ani, Sure Enam:102)

HARMONIA E MREKULLUESHME NË KRIJESË KUNDËRSHTON DARVINIZMIN




Sipas darvinizmit, çdo gjë e gjallë është një produkt i rastësisë dhe parregullsisë. Por rendi i përsosur, harmonia e mrekullueshme, dhe ekuilibrin i ndjeshëm që ekziston nëpër krejt universin, e shtrydh pohimin darvinist të rastësisë. Një hollësi në trupin tonë, të cilën ju nuk mund ta shihni me

sy të lirë, do të demonstrojë: Çka i jep gjakut ngjyrën e kuqe janë erithrocitet, ose qelizat e kuqe të gjakut. Erithrocitet kanë trajtë disqesh bikonkave dhe tejet elastike – tipare që kanë rëndësi sipërore për jetën njerëzore.

Nëse qelizat e kuqe nuk do të kishin një shkallë kaq të madhe elasticiteti, ato të ngecnin në mjaft kapilarë në të gjithë trupin, sepse diametri i qelizave është pothuajse dyfish i asaj të enëve më të ngushta përmes të cilave ato lëvizin. Por, për shkak të elasticitetit të tyre, kjo nuk është problem dhe ato mund të lëvizin lirshëm përmes tyre.

Ç'do të ndodhte nëse erithrocitet nuk do ta kishin këtë shkallë elasticiteti?

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Përgjigja dramatizohet tek njerëzit me diabet. Qelizat e gjakut të tyre e humbin elasticitetin dhe si rezultat, bllokojnë enët e ngushta të gjakut tek sytë. Si rezultat i këtij bllokimi ndodh qorrimi.

Çdo strukturë dhe sistem në qëniet e gjalla është shumë i ndjeshëm, shumë imtësisht të sintonuara me njëra-tjetrën, dhe shumë e ekuilibruar që nuk lë vend për mundësinë e rastësisë. Kjo ndodh sepse është evidente se secili është krijuar prej Mbajtësit të fuqisë dhe diturisë superiore – dmth, prej Zotit.



Forma dhe elasticiteti i rruazave të kuqe të gjakut u lejon atyre të kalojnë me lehtësi edhe nëpër kapilarët më të ngushtë.


Ai që krijoi shtatë qiejt një mbi një. Ju nuk do të gjeni asnjë të metë në krijesën e të Plotmëshirëshmit. Shih sërish – a shikoni ndonjë të metë? Dhe këqyr sërish e sërish. Shikimi do t'ju kthehet i verbuar e i lodhur

Kur'ani, 67: 3-4


HEMOGLOBINA- GJAHTARI I OKSIGJENIT NË TRUP

Rruazat e kuqe të gjakut çojnë oksigjen tek çdo qelizë e trupit tonë. Ndërsa molekulat e oksigjenit lëvizin lirishëm nëpër gjak, rruazave të kuqe të gjakut u duhet t'i kapin ato, me anë të proteinës së quajtur hemoglobinë.

Një qelizë (apo rruazë) e kuqe gjaku është dizajnuar posaçërisht për të bartur hemoglobinën, e cila zë 90% të qelizës. Organeleve, si nuklet dhe mitokondret, që gjenden në qelizat e tjera, u mungojnë rruazat e kuqe të gjakut, gjë që lë vend për hemoglobinën të kapë oksigjen të mjaftueshëm.



Hemoglobina në asnjë mënyrë nuk mund të bjerë në kontakt me molekulën e oksigjenti, sepse po të ndodhte, ajo do të oksidohej dhe kështu, s'do të lejonte fare oksigjen të mbërrinte qelizat e tjera. Por në rrethana normale asaj nuk do t'i duhej të bjerë në kontakt me oksigjenin pasi ajo është krijuar në një mënyrë të posaçme që të mos e hasë këtë rrezik. Përndryshe, ajo e mban molekulën e oksigjenit si një palë masha.



Si e kap hemoglobina oksigjenin? Proteina e hemoglobinës përbëhet nga nën-njësi, secila përmban një atom hekur i lidhur pas një grupi heme. Këto grupe heme janë masha speciale që i japin hemoglobinës mundësinë për të kapur oksigjen pa kontakt dhe t'ia shpien atë qelizave që i duhet. Këndet torsionale ndryshojnë në një mënyrë të tillë gjatë lidhjes së oksigjenit.

Edhe këtu, brenda grimcave më të vogla të trupit, të padukshme me sy të lirë, kemi një harmoni të përsosur dhe pa të metë. Është e pamundur për një harmoni të tillë të ketë ardhur si rezultat i rastësisë. Zbrazja e rruazave të kuqe të gjakut për t'i bërë vend hemoglobinës, duke patur masha proteine për të kapur oksigjen pa iu nënshtruar një reaksioni kimik, programimi i molekulës së hemoglobinës për të gjuajtur oksigjen pikësëpari, për të njohur molekulat e oksigjenit dhe të dallojë mes tyre dhe molekulave të tjera, bartja e oksigjenit të kapur për atje ku duhet - asnjë prej këtyre nuk është rastësi. Të thuash se është, do të thotë të kalosh kufijtë e logjikës dhe arsyes. Të gjitha këto janë tregues të diturisë së pakufishme dhe urtësisë së Zotit.


QIMET E SISTEMIT TË FRYMËMARRJES PËRCAKTOJNË PAGABUESHËM KAHUN

Së bashku me ajrin, ne zaten thithim brenda mjaft pluhur. Por kjo dhe mjaft substanca të tjera të dëmshme për trupin mbahen në një zonë të veçantë sigurie ku ato neutralizohen përpara se të kenë gjasa të mbërrijnë ndonjëherë mushkëritë.

Që nga hundët deri tek bronkiolet, e gjithë sipërfaqja e rrugëve të frymëmarrjes është e veshur me një shtresë mukose. Kjo substancë, e cila gjithashtu vepron si zbutës apo lagështues i sipërfaqes së rrugëve të frymëmarrjes, zë edhe grimcat e thithura të puhurit, duke i parandaluar ato të mbërrijnë në mushkëri. Megjithatë, pasi këto grimca të huaja janë kapur nga mukoza, ato duhet të nxirren jashtë trupit, që të mos grumbullohen në rrugët e frymëmarrjes. Si ndihmesë për këtë, në lojë hyn edhe një tjetër mekanizëm.

Veshja e sipërfaqes së rrugëve të frymëmarrjes janë flagjela (bishta, zgjatime) të mprehta që njihen si cilia, të pranishme përafërsisht 200 të tilla për qelizë. Duke goditur sa para-mbrapa në valë, nga dhjetë deri në njëzet herë në sekondë, këto cilia lehtësojnë lëvizjen e rregullt – gjithmonë drejt përpjetë kah gurrmazë (rrylli i fyti, dmth). Në këtë mënyrë, çdo mukozë që ka zënë grimca të huaja drejtohet kah fyti me një centimetër për minutë.

Në hundë, megjithatë, mukoza lypset të drejtohet për kah poshtë, dhe kështu cilia lëviz në kah të kundërt. Kësisoj, çdo lëndë e huaj në mukozën hundore lëviz kah fyti. Më



vonë, çdo lëndë e huaj o përcillet bashkë me gëlbazën dhe çohet në sistemin tretës, ose nxirret nga trupi përmes kollitjes.

Siç e

tregojnë këta shembuj, këto struktura të imëta si qime mund të përcaktojnë se ku ndodhet fyti, i cili është, të flasim relativisht, shumë larg, edhe pse ato nuk kanë sy për të parë, dhe as tru për të menduar. Për më tepër, ato e dinë se nëse kjo lëndë e huaj merr për poshtë në mushkëri, ajo fare mirë mund të dëmtojë trupin. Për ta mënjeluar këtë, ato veprojnë në mënyrën më harmonioze, duke goditur gjithmonë në të njëjtin drejtim.

Në eksperimete të ndryshme dhe duke përdorur metoda të ndryshme, shkencëtarët e kanë studjuar këtë mekanizëm për vite me radhë. Megjithatë, ata ende nuk e kuptojnë plotësisht këtë mekanizëm, me të cilin qime fare të vogla vetëm një e miliona e metrit në përmasë e kanë kryer vazhdimisht pagabueshëm qysh prej njeriut të parë.

Duke vepruar me frymëzimin dhënë atyre prej Zotit i cili i krijoi ato, ciliat veprojnë në një mënyrë të pashembullt që nuk mund të bëheshin prova në një sërë rastësish.

Dhe ai ka bërë gjithçka në qiell dhe gjithçka në Tokë që të nënshtrohet
ty. E gjitha është prej Tij. Sigurisht për këtë ka shenja për njerëzit që të
reflekojnë

(Kur'ani, 45:13)


ÇKA DO TË LEXONI TANI, DODH NË TRUPIN TUAJ MU KËTË ÇAST

Hemoglobina është molekula e veçantë, përgjegjëse për dërgimin e oksigjenit tek qelizat e tjera. Hemoglobina e shpie oksigjenin në mushkëri, e lë dyoksidin e karbonit atje, pastaj lëviz në muskuj. Sakaq, qelizat e muskujve kanë djegur lëndët ushqimore dhe kanë prodhuar dyoksid karboni. Kur hemoglobina arrin muskujt, ajo bën të kundërtën e asaj që ka bërë fillimisht në mushkëri, lë oksigjen dhe merr dyoksid karboni, ose gaz karbonik, dmth.


Shkencëtarët e quajnë hemoglobinën si një molekulë të jashtëzakonshme për shkak të këtyre dy proceseve të ndryshme që ajo kryen. Në librin *The Great Evolution Mystery* (Misteri i madh i evolucionit), Gordon Rattray Taylor, për vete një evolucionist, ka shkruar si më poshtë rreth hemoglobinës:

«... kjo është vërtet një molekulë e jashtëzakonshme e cila një çast ka prirje për oksigjen dhe pak sekonda më pas e humb atë tërheqje, që ajo i ndryshon njëkohësisht preferencat e saj përta i përket gazit karbonik, kjo e bën akoma edhe më të shquar...» (Gordon R. Taylor, *The Great Evolution Mystery*, Harper and Row Publishers, New York, f. 108).

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Vetëm një rruazë e kuqe gjaku → përmban 300 milionë molekula hemoglobine, një prej të cilave tregohet këtu



Siç e tregon edhe kjo, molekula e hemoglobinës duket sikur ka ndërgjegje, duke bërë lëvizjen e duhur pikërisht në kohën dhe vendin e duhur, duke mos e ngatërruar kurrë oksigjenin me dyoksidin e karbonit.

Kjo është dukshëm trilluese. Si mundet që një molekulë e vockël, e cila as nuk mund të shihet nën mikroskop, merr vendime dhe ka përzgjedhje.

Si rezultat i ndërgjegjes së

jashtëzakonshme të shpërfaqur nga kjo molekulë, të gjitha krijesat frymëmarrëse në Tokë mund ta vazhdojnë ekzistencën e tyre me lehtësi. Rreth 900 milionë rruaza të kuqe gjaku prodhohen në trupin e njeriut gjatë një ore. Dhe janë rreth 300 milionë molekula të hemoglobinës vetëm në një rruazë të kuqe gjaku. Kur ta mendosh numrin e përgjithshëm të molekulave të hemoglobinës në trup dhe aftësitë që secila prej tyre ka, zë ta kuptosh më qartë rëndësinë e gjithë kësaj.

Çdo njeri me mend në kokë duhet ta pranojë se një përzgjedhje e këfillë nuk mund të ish bërë si rezultat i rastësisë, dhe se rastësia nuk mund t'i kish derdhur këto veti mbi miliarda molekula hemoglobine. Krijuesi i hemoglobinës me të gjitha tiparet e saj, dhe vendosja e molekulave në trupat e qënieve të gjalla është Zoti.


ENZIMAT LISOZOME NË SHËRBIM TË TRUPIT

Mjaft procese për të cilat ne nuk kemi dijeni zhvillohen në trupin tonë. Këto procese kryhen prej 100 trilionë qelizash, të gjitha duke bërë detyrat pa gabim, pa dështim.

Strukturat e shumta brenda këtyre qelizave e dinë detyrën e tyre shumë mirë. Disa prej tyre prodhojnë energji, disa të tjera proteinë, disa shërbejnë si transportues, dhe të tjerat përdoren si depo magazinimi.

Një prej strukturave dukshëm të ndërgjegjshme që gjendet në qelizat është lizozoma, e cila mund të konsiderohet si tretësi (honepsësi) i qelizës. Mjaft procese honepsëse mund të kryhen si rezultat i enzimave që këto organele përmbajnë. Përpos tretjes dhe shkatërrimit të qelizave të vdekura, sëmura, apo të papërdorshme më, dhe çpimin dhe tretjen e membranës që rethon një strukturë, enzimat lizozome shkatërrojnë gjithashtu qeliza të posaçme që vazhdojnë të rriten në trup. Këto procese tretëse që kryejnë enzimat lizozome janë të një rëndësie madhore për shëndetin dhe përfundimisht, për shpëtimin. Për shembull, mitra i një gruaje shtatzanë rritet në një shkallë shumë më të madhe se normalisht, për të mundësuar zhvillimin e embrionit të saj – një hap i domosdoshëm për lindjen e një foshnjeje të shëndetshme. Megjithatë, sapo foshnja lind, nuk ka më nevojë për një

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



mitër aq të madhe. Tani ky organ, i cili qe rritur aq shumë, duhet të rikthehet në përmasën e tij të mëparëshme. Këtë proces e kryejnë enzimat lizome, të cilat edhe ashtu e dinë fare mirë se ç'u duhet të bëjnë dhe fillojnë të sekretojnë enzimat e domosdoshme. Në dhjetë ditë dhe shumë shpejt, enzimat tkurriin masën e mitrës në dyzet herë, duke e rikthyer atë në madhësinë e mëparëshme, për shëndetin e trupit.

Lizozomet gjenden edhe në kryet e spermës. Një qelizë spermatozoidi përdor lizozomet që ajo bart për të çarë

qipen që rrethon vezën të cilën ai kërkon të depërtojë. Kështu këto veti zbërthyesë të enzimave lehtësojnë pllenimin e qelizës së vezës duke çarë nëpër lëmesën e saj mbrojtëse.

Siç tregojnë këta shembuj, çdo mekanizëm në trupin tonë punon asodore që plotësojnë çdo proces tjetër. Mu ashtu si një sistem që lejon zmadhimin e mitrës gjatë shtatzanisë, është edhe një sistem që i lejon asaj kthimin në gjendjen e mëparëshme. Në të njëjtën mënyrë, në spermë është vendosur posaçërisht një enzimë me aftësinë për të përshkuar cipën mbrojtëse të vezës.

Darvinistët gjer tani i kanë ndenjuri larg logjikës dhe arsyes duke thënë se ky sistem përsosmërisht i ndërthurur, i cili vazhdon të ecë në një mënyrë të pagabueshme, është vetëm rezultat i rastësisë. Punët më të përsosura brenda këtyre mekanizmave, dhe punët sistematike dhe të harmonishme me të gjithë trupin, shpërfaqin përsosmërinë e krijesë së Zotit që ta shikojë secili.

TË MARRËSH FRYMË ËSHTË MREKULLI !

Nga çasti që ju lindim, kemi marrë frymë lehtësisht dhe, si rezualtat, kemi mundur të vazhdojmë jetën. Nëse ndalojmë frymëmarrjen vetëm për pak minuta, kjo do të çonte në ndalimin e të gjitha funksioneve trupore, dhe me mjaft gjasa, në vdekje. Vetë jeta jonë mvaret nga një substancë e njohur si surfaktante (gërryes sipërfaqeje), që gjendet në mushkëritë tona.


Kjo substancë mbështjell gadi 300 milionë qeska të imëta ajri, ose *alveoli* që i lejon mushkërive të thithin oksigjen. Surfaktantet ndihmojnë në hapjen dhe mbylljen e këtyre qeskave saherë që marrim frymë – jo punë e lehtë.

Një veçori mjaft e rëndësishme e kësaj substance është se ajo fillon të prodhohet vetëm një muaj para se fëmija të lindë. Dhe këtu zë fill natyra e mrekullueshme e kësaj dukurie.

Si ka mundësi që një foshnje, e cila nuk i ka përdorur mushkëritë ndërkohë që është në mitrën e nënës, mund të parashikojë vështirësinë e frymëmarrjes kur të vijë në këtë botë – dhe pastaj ndjen nevojën të fillojë prodhimin e kësaj substance? Si e di ajo që surfaktanti ka aftësi të ndihmojë alveolin e saj? Ç'njohuri kimie mund të përdorë ajo për të përllogaritur ndihmën e saj në lëvizjen e këtyre qeskave?

Mungesa e kësaj substance – si në foshnjët e lindura parakohe – mund të çojë në vdekjen e foshnjes brenda një

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



kohe të shkurtër. Por kjo shumë rrallë ndodh. Për miliona vjetë, çdo fëmijë i lindur në kohë ka dalë nga barku i nënës me mushkëri të veshura me këtë substancë, duke i mundësuar asaj të marrë frymë kollaj.

Padyshim kjo ngjarje e mrekullueshme nuk realizohet nëpërmjet vullnetit të fëmijës, as përmes këmbënguljes së nënës. Ai i Vetmi që e ka krijuar këtë sistem të përsosur dhe i Cili e lejon atë të nisë mu në kohën e duhur, është Zoti.

O njeri! Çfarë të ka zhgënjyer ty përsa i përket Zotit tënd Fisnik? Ai që të ka krijuar e të ka formuar dhe përpjestimuar e montuar ty në çfarëdo mënyre që ai ka dashur?! (Kur'ani, 82: 6-8)

Allahu ka dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjujt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit.

(Kur'ani 3:18)

RRJETI I NDËRLIDHJES MES QELIZAVE


100 trilion qelizat në trupin tonë punojnë së bashku në një harmoni të përkryer. Që të ndodhë kjo, lypset që qelizat të jenë në dijeni nga afër mbi funksionet e njëra-tjetrës. Për këtë qëllim, ato prodhojnë molekula lajmëtare të njohura si hormone. Hormoni tiroid, për shembull, kontrollon shkallën e metabolizmit në të gjitha qelizat. Hormoni i insulinës rregullon sasinë e glukozës në gjak dhe mundëson futjen e saj në çdo qelizë të trupit. *Aldosteroni* nxit veshkat dhe kësisoj mban të balancuar nivelin e ujit dhe kripës në gjak. Për prodhimin e rruazave të kuqe të gjakut, lypset me doemos porosia e dërguar nga hormoni erithropoietin.

Disa qindra hormone të tjera mundësojnë komunikimin e vazhdueshëm ndërmjet qelizave. Për më tepër, kjo ndodh me të njëjtën përsosmëri në secilin prej miliarda njerëzve e kafshëve në Tokë. Pa hormonet, në trup nuk do të kishte rend, vetëm rrëmujë dhe shkujdes.

Po si mundet që një qelizë të dijë çka duhet të bëjë një qelizë tjetër në një distancë punë centimetrash larg? Si e di ajo ç' hormon do të sjellë efektin e dëshiruar? Dhe për më tepër, si e njih ajo strukturën e këtij hormoni, ose të përftojë materjalin e nevojshëm që duhet për ta bërë atë, pikësëpari?

Ndërgjegje në qelizë – harun jahja

Hormonet janë molekula përgjegjëse për dërgimin e mesazheve tutje-tëhu ndërmejt qelizave. Falë këtyre molekulave të gjithë proceset e trupit ecin pa gabime. Hormonet kontrollojnë dukuri për të cilat ne as nuk kemi vetëdije, që nga tensioni i gjakut e gjer tek rritja.



- | | |
|--------------------------------------------------------------|---------------------------------|
| 1-Rritje | 6- Prodhim i testosteronit |
| 2-Stimulim tiroidi | 7 Kontroll i lëvres së veshkëve |
| 3-Prodhim vezësh dhe estrogjeni | 8- Ujë i mbajtur nga veshka |
| 4-Prodhim sperme | 9-Qumësht i sekretur nga |
| 5-Lëshim veze, dhe sekretim i estrogjenit dhe progjesteronit | 10- Tkurrje e mitrës |

Përgjigja e vetme logjike është se gjithçka në trup është krijuar me një plan të posaçëm diturie dhe ndërgjegjeje. Rregulli që gjendet ndër 100 trilion qelizat në secilin njeri

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

nga miliardat në faqen e tokës është provë dhe dituri e krijesës së Zotit dhe veçantisë së Tij.

BURIMI I DHIMBJEVE TË LINDJES DHE QUMSHTIT TË GJIRIT: NJË HORMON I PRODHUAR NË TRU


Kur periudha e shtatzanisë përfundon, fillimi i menjëhershëm i dhimbjeve të lindjes japin shtatë ditë të një jete të re. një hormon i quajtur *oksitocin* nis lindjen dhe dërgon shenjën e parë të kësaj ngjarjeje të pashmangshme.

Ky hormon, lëshuar nga gjendrra e hipofizës (gjendrra e rritjes, shp), ka ndikimin e saj në dy vende; në muskujt e mitrës së nënës, dhe në qelizat e muskujve që nxjerrin qumësht në gypat e gjijve.

Shtrengimet në rritje të mitrës janë të rëndësishme maksimale për të siguruar që lindja do të ndodhë pa rrezik si për nënën dhe foshnjën. Ky hormon mundëson tkurrje të forta të muskujve të mitrës – por e bën këtë vetëm pas nëntë muajsh e dhjetë ditësh të kenë kaluar qysh prej ngjizjes. Qoftë herët apo vonë mund ta vërë jetën e foshnjës në rrezik. Kur vjen koha e duhur, receptorët në mitër dërgojnë sinjal në tru. Me marrjen e këtij sinjali truri prodhon oksitocinin, pikërisht molekulën e duhur, dhe e dërgon atë tek vendi i synuar – atyre receptorëve të largët.

Në vazhdim të gjithë kësaj, oksitocini ka një tjetër funksion të veçantë, mundësimin e ushqimit të foshnjës së sapoardhur në botë, duke sekretuar qumësht me sasi.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Ki parasysh:

Si munden qelizat në një pjesë të vockël të trurit të nënës vendos të prodhojë një hormon që ia lehtëson mitrës lindjen e fëmijës?

Si mundet ky hormon ta gjejë rrugën nëpër të gjithë sistemin e qarkullimit të gjakut, për tek pikërisht ato qeliza ku ai lypset.

Kush e posedon njohurinë që foshnjes i duhet të zhvillohet e të maturohet për nëntë muaj e dhjetë ditë në mitrën e nënës, dhe ndez mekanizmin e lindjes mu në çastin e duhur?

A e shqyrton vetë hormoni oksitocin nevojën e foshnjes për t'u ushqyer dhe vendos një sistem që siguron sekretimin e qumështit nga nëna?

Oksitocini është veç një hormon prej mija sosh në trupin tonë. Mu si ky, çdo hormon tjetër ndihmon në organizimin e funksioneve të trupit, merr vendime të rëndësishme dhe merr masa për zbatimin e tyre; kumunikon me qelizat e tjera, nxit nevojën e sekretimit, përcakton sasi të domosdoshme, kohën dhe afatin – duke e kryer këtë dhe mjaft porcese të tjera të koklavitura, pa dështim.

Mjaft e dukshme, një planifikim kaq i mrekullueshëm nuk ndodh vetë, ose si rezultat i rastësisë. Planifikuesi, Krijuesi dhe Kontrollori i krejt organizimit të vetëdijshëm të këtyre hormoneve, deri në hollësitë më të imta, është Zoti, Poseduesi i diturisë së pafundme.

PO SIKUR TË MOS NDJEJE KURRË ETJE?

Përgjatë ditës, ka sisteme që pikasin ndryshimet më të vogla të sasisë së ujit në trupin tënd. Kryesori është njëri në një vend, afërsisht sa një bajame, në tru, të quajtur *hipothalmus*. Ndër të tjera, *hipothalmusi* është i ndjeshëm ndaj përmbajtjes së ujit në gjak. Kur niveli i ujit bie, ka një ulje të ndjeshme të tensionit të gjakut, edhepse e vogël. Në këtë pikë, futen në punë baroreceptorët. Të ndodhur në aortë, ku gjaku nis daljen nga zemra, ata janë të përfshirë në pikasjen e ndryshimeve në tensionin e gjakut. Me aktivizimin e tyre, këta receptorë të ndjeshëm dërgojnë menjëherë një njoftim tek *hipothalmusi*, i cili nga ana e tij reagon duke urdhëruar hipofizën, gjëndrrën sa një bizele mu poshtë tij, që të nisë prodhimin dhe sekretimin e hormonit të quajtur *vasopresin*, ose ADH.


Përmes enëve të gjakut, ky hormon nis një rrugë të gjatë dhe dikur arrin në veshka. Ashtu siç përshtatet një çelës në drynin e synuar, veshka ka receptorë të posaçëm që janë shi ashtu siç duhen për këtë hormon. Kur ky arrin receptorët, ata komunikojnë porosinë se veshkat duhet të kalojnë në mjet ujë-kursyes, dhe qelizat e veshkave menjëherë zënë e mbajnë ujë, duke e ulur në minimum sasinë e ujit të humbur.

Ky hormon i njëjtë shkakton gjithashtu ndjeshmërinë e etjes në tru. Dhe si rezultat i këtij sistemi të brenda-ndërtuar, për të cilin ne jemi fare të pavetëdijshëm, ne ekuilibrojmë nevojën e ujit në trup me një gotë uji nga çesma.


Po të mos kishte hormon hipofize, ose në qoftëse qelizat e veshkave nuk do kishin aftësinë të kuptojnë e t'i binden urdhrat të saj që të mbajë ujë, ne do të na duhej të pinim ndërmjet 15 dhe 20 litra ujë në ditë që të mos vdesim nga etja. Dhe ngaqë do të na duhej ta harxhonim këtë sasi uji vazhdimisht, ne s'do të mund as të flinim dot ose të qëndronim në një vend as për pak kohë.

Siç e kemi parë, të gjitha pjesët e sistemit që balancojnë nivelin e ujit të trupit tonë bashkëpunojnë me trurin. Qelizat në aortë njoftojnë trurin për mungesën e ujit. Duke kuptuar menjëherë pasojat e këtij lajmërimi, truri lëshon një sinjal që shkon tek veshkat, organit më të rëndësishëm ndër gjithë të tjerët, dhe u thotë atyre ç'të bëjnë.

Këta procese ndodhin në trupin tonë kushedi sesa herë gjatë ditës, pa patur as vetëdijen tonë për to. Për më tepër, ata ndodhin në trupin e të gjithë njerëzve që na rrethojnë, dhe tek të gjithë nerëzit që kanë jetuar ndonjëherë a do të jetojnë në të ardhmen. Ata të gjithë posedojnë të njëjtët receptorë të ndjeshëm. Receptorët e të gjithë atyre dinë si të reagojnë ndaj ndryshimeve të tensionit të gjakut. Qelizave të çdo qenieje njerëzore iu është dhënë kjo aftësi që të masë ndryshimet në presionin e gjakut.



Nga erdhi ky sistem kaq i ndërlikuar dhe i pa të metë, që shfaqet me të njëjtat cilësi tek çdo njeri?



Që një mekanizëm i tillë nuk mund të dilte si rezultat i një rastësie qorre, është e qartë për çdokënd me mend në kokë. Po kështu, nuk është e mundur për këtë pjesë të sistemit që të kish përfutur këto veti vetëvetiu. Qelizat vetë nuk mund të zbulojnë proceset që edhe një njeriu i lypset vëmendje e kujdesshme të lexojë e të kuptojë. Për më tepër, vasopresini është vetëm një prej qindra hormoneve që gjenden në trup. Secili prej të tjerëve ka mardhënie të ngjashme me organin e përshtatshëm të tij. Dhe asnjë

hormon nuk e shpie mesazhin në vend të gabuar; çdo organ kupton saktësisht dhe plotësisht mesazhin që bart hormoni. Është kjo saktësi dhe dukshme se një sistem i tillë ka ardhur në ekzistencë prej Mençurisë superiore. Pronari i kësaj inteligjence është Zoti, Krijuesi i gjithçkaje.

Çdo njeri është përgjegjës për reflektimin e vet mbi këto mrekulli të krijimit në trupin e tij dhe për t'i shprehur mirënjohjen Zotit, i Cili i krijoi ata me një përsosmëri të tillë.

HORMONET – MOLEKULAT QË MUND TË DALLOJNË MES GJINIVE

Një bashkëpunim harmonioz i madh fare ekziston mes qelizave dhe hormoneve në trupin e njeriut. Trupi i njëjti hormonet dhe menjëherë e kupton mesazhin që bartin ata. Dhe hormonet e dinë fare mirë se ku duhet të shkojnë dhe kur, dhe llojin e ndikimit që ata do të kenë. Ndonëse të njëjtët hormone janë të pranishme si në meshkujt edhe tek femrat, efekti i këtyre hormoneve në të dy gjinitë është tërësisht i ndryshëm. Për shembull, hormoni gjendërr-stimulues i njohur si FSH (*Folicle-Stimulating Hormone*) nxit formimin e vezës tek gratë. Megjithatë, tek meshkujt, i njëjti hormon siguron formimin e spermës.

Nga ana tjetër, hormoni afshndjellës LH (*Luteinizing hormone*) stimulon shkarkimin (*ovulacionin*) dhe shkaktën gjithashtu sekretimin e një tjetër hormoni që quhet progesteron i cili përgatit mitrën për shtatzani. I njëjti hormon merr një rol krejt të ndryshëm tek meshkujt, duke stimuluar qelizat që të prodhojnë testosteron, i cili mundëson zhvillimin të karakteristikave dytësore seksuale dhe formimin e farës.

Si mundet që dy hormone të ngjashme me të njëjtën përbërje, çojnë në efekte krejtësisht të ndryshme në gjini të ndryshme? Pyetja është mendjecytse!

Kur hormoni sekretohet në trupin e mashkullit, ai e njeh se qelizat e trupit aty i përkasin një mashkulli dhe bëjnë


ndryshimet sipas mjedisit. Në trupin e mashkullit, për shembull, ky hormon çon në formim më të madh muskujsh, në ntrashjen e zërit, dhe në fromimin e mjekrrës.

Tek gratë, i njëjti hormon lëshohet, por efekti e tij në të është krejtësisht i kundërt. Nëse i njëjti hormon mund t'i japë një zë femëror një femre dhe të trashë një burri, dhe të çojë në zhvillimin e karakteristikave të ndryshme trupore, atëherë ky hormon duhet të jetë diqysh i *vetëdijshëm* për ndryshimet e përbërjes kimike dhe anatomike mes burrit dhe gruas. Përndryshe, kjo domethënë se hormoni duhet të ketë mend dhe të ketë marrë mësim mbi këto lëndë.

Si mundet që këto hormone të kenë përvetësuar njohuri kimie? Apo, si ndodh që qelizat që i prodhojnë këto hormone kuptojnë jo vetëm përbërjen kimike të trupit të njeriut por edhe, si kimistë të regjur, nga vetja e vet mund të nxjerrin substanca sipas kësaj njohurie dhe i drejtojnë qelizat e tjera që edhe ato të prodhojnë gjithashtu? Si e ka përvetësuar një qelizë e vockël diturinë për të bërë gjithë këtë?

Qartësisht, kjo dituri nuk është pasuri e qelizave apo e atomeve që i përbëjnë ato. Këto rregulla, të bëra veçanërisht për burrat dhe gratë, janë shenjë e një plani dhe dizajni të ndërgjegjes ekzistente. Ai që ndodhet pas këtij koncepti është Pronari i inteligjencës sipërore – dmth Zoti.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



A MUNDET QË FUQIA PAS VEPRIMEVE TË NDËRGJEGJSHME TË QELIZËS T'I PËRKASË NJË HORMONI PA VETËDIJE MBI EKZISTENCËN E TIJ?

Falë hormoneve tiroide, 100 trilionët e qelizave të trupit tonë i kryejnë detyrat e tyre pagabueshëm.

Sa më shumë hormone tiroide në gjak, aq më shpejt do të punojnë qelizat. Nëqoftëse trupi nuk sekreton mjaft tiroide, metabolizmi ngadalësohet ndjeshëm dhe praktikisht ndalon. Për këtë arsye, lypset që gjatë gjithë kohës në gjak të ketë një nivel të caktuar hormonesh tiroide.

Është e pamundur për gjëndrrën tiroide që të marrë përsipër ndikimin tek qelizat e tjera dhe të marrë vetë një vendim të tillë. Ajo nuk ka dijeni mbi ekzistencën e qelizave të tjera. Ajo vetëm i bindet shkronjës që urdhrat shfaqin në ADN-në e qelizave të veta.

Fuqia që i jep këto urdhra të shkruara gjendrrës tiroide dhe që i shkakton ato është Zoti, Ai i vetmi që ka krijuar çdo hollësi të imët. Plani, dizajni dhe ndërgjegja të vëna në punë këtu nuk i përkasin një pjese të pandërgjegjshme, një gjëndrre të pavetëdijshme për ekzistencën e vetëvetes që thirret me emrin *tiroide*. Kjo i përket Zotit.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*




DIAGRAMA E MËSIPËRME PËRMBLEDH EFEKTIN E NIVELIT TË HORMONIT TË TIROIDIT NË METABOLIZMIN E TRUPI

Evolucionistët, megjithatë, mohues të kësaj, thonë se:

- Gjëndrra tiroide *ndjen nevojën* që të nxisë të gjitha qelizat e tjera të trupit, dhe prandaj i ka dizajnuar hormonet që të ndikojnë tek të gjitha qelizat.
- Ajo i ka prodhuar përsosmërisht këta hormone të gjithë vetë, dhe
- Vendos vetë nivelin e hormoneve që duhet të jenë në gjak gjatë gjithë kohës.

Doemos, kjo nuk është asgjë veçse konjunkturë. Kurrësesi nuk është e mundur që një gjëndërr endokrine që të ketë dijeni që të mendojë për cilëndo nga këto, ose ta sjellë këtë. Krijuesi i gjithçkaje në harmoni me gjithçka, dhe Ai i Vetmi që ka bërë gjërat të jenë të ndërvarura, është Ai me diturinë për të gjitha gjërat – dmth, Zoti.

Allahu i bën shenjat e qarta për ju, dhe Ai është i Gjithëdituri, më i Urti.

(Kur'ani, 24:18)


ASNJË FORMULË NUK KA ARDHUR VETË, RASTËSISHT

Insulina është edhe një tjetër hormon pa të cilën njerëzit nuk mund të jetojnë. Në rastet kur ky hormon nuk sekretohet mjaftueshëm, niveli i sheqerit në gjak rritet dhe nuk mund të balancohet. Kjo mund të çojë në rënien e personit në glaukoma (diabetike). Diagrama e mëposhtëme (fut figurë 1) tregon radhën e aminoacideve (treguar në rrathët) që gjenden në insulinë. Po të ndodhë edhe gabimi më i vogël në këtë radhë amino acidesh, insulina nuk do mund ta kryejë detyrën e saj.

Nëse një person lexon një formulë të shkruar në letër, ai ose ajo do ta dijë se ajo nuk është çfaqur aty vetiu, që dikush duhet ta ketë shkruar atë. Hormoni i insulinës nuk ka një formulë të veçantë. Për më tepër, në çdo njeri që ka jetuar, insulina ka qenë prodhuar sipas kësaj formule. Kjo mafton për të provuar se insulina nuk ka ardhur me kalimin e kohës, përmes rastësisë. Asnjë rastësi e pandërgjegjshme nuk do të mund të kish çuar në të njëjtën formulë që është prodhuar në miliarda njerëz, pa përmendur kafshët. Një pohim i tillë bie ndesh me çdo arsye, inteligjencë dhe shkencë.

Krijuesi i insulinës, Përcaktuesi i veçorive që ajo bart, është Një, Ai e ka krijuar insulinën qysh kur njeriu i parë erdhi në jetë – dmth, Zoti.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



A KA MUNDËSI QË VESHKAT TUAJA TË KENË NJOHURI MJEKËSORE?

Veshkat, në vetëvete, sanojnë numrin e rruazave të kuqe të gjakut që pompohen në to. Të dhënat e përcaktura nga receptorët e ndjeshëm vlerësohen menjëherë, dhe merren masat në përputhje me rrethanat.

Kur veshkat vërejnë një rënie të numrit të rruazave të kuqe të gjakut, qeliza të posaçme të veshkave sekretojnë një hormon të quajtur *erithropoietin*, i cili ndihmon rritjen e prodhimit të gjakut. Hormoni e ka efektin e tij jashtë veshkave, në qelizat kryesore të prodhimit të gjakut në palcën e kockës. Kur ky hormon njofton se niveli i erithrociteve është i ulët, palca e kockës ndihmon ritmin e prodhimit dhe lëshimit të erithrociteve në sistemin e qarkullimit të gjakut. Kësisoj, sasia e rruazave të kuqe të gjakut mbahet në ekuilibrin e duhur.


Shkurtimisht, veshkat mund të bëjnë një numër matjesh, vlerësim të dhënash dhe merr nismë të zbatojë masat e nevojshme paraprake... dhe hormoni që ka detyrën e dërgimit të mesazhit mund të udhëtojë nëpër trup pa e humbur rrugën, duke mbërritur palcën e kockës pa telash apo vonesë. Qelizat e palcës së kockës dinë gjithashtu se si ta deshifrojnë mesazhin që hormoni i dërgon atyre nga veshkat, dhe veprojnë sipas porosisë.

Për më tepër, të gjithë këto procese ndodhin në secilin prej miliarda njerëzve. Në të gjithë ata, ky operacion zhvillohet në të njëjtën mënyrë.

Gjatë gjithë këtyre proceseve, qelizat shfaqin një zgjuarësi të dallueshme dhe veprojnë si përbërëse të disiplinuar dhe të bindura të një organizimi pa një të metë. Kjo gjendje kërkon përgjigje: cili mund të jetë burimin i kësaj zgjuarësie dhe bashkëpunimi? Askush s'mund të thotë se qelizat e posedojnë këtë inteligjencë vetë

ose ashtu kot, rastësisht. Ai që i ka frymëzuar këto qeliza me këtë inteligjencë dhe njohuri se si të veprojnë është Zoti, i cili mban nën kontroll të gjitha gjërat.

Nuk ka fuqi apo forcë përveç Zotit.



HORMONI QË HEDH POSHTË DARVINIZMIN

Pa e kuptuar as vetë ju, mijëra urdhëra kalojnë nëpër trupin tënd çdo sekondë, për ta bërë jetën tuaj sa më të lehtë dhe praktike që të jetë e mundur.

Kur je i eksituar apo i frikësuar, për shembull, sistemi yt nervor i ngacmuar nervor, me shpejtësi të madhe dhe pa e humbur, aktivizon gjëndrrën mbi veshkat. Me marrjen e mesazhit, këto gjëndrra adrenale, sekretojnë një hormon të quajtur *adrenalinë* e cila, duke hyrë në rrugët e gjakut, i thërret vëmendjen të gjithë trupit. Ajo pengon veprimtarinë e stomakut dhe zorrëve dhe ndalon procesin e honepsjes. Në këtë mënyrë, një sasi e konsiderueshme gjaku, e përfshirë në tretjen tani është e lirë të furnizojë muskujt. Në të njëjtën kohë, rrahjet e zemrës dhe tensioni i gjakut rriten. Bronkiolat në mushkëri zmadhohen, duke shpejtuar thithjen e oksigjenit dhe furnizimin me të të gjakut. Edhe niveli i sheqerit në gjak rritet, që çon në rritje të energjisë në muskuj. Së fundmi, bebëzat e syrit hapen dhe ndjeshmëria e syve ndaj dritës rritet.


Rezultati i të gjithë këtyre faktorëve së bashku është se ti je pajisur për të reaguar në çdo situatë, qoftë për të ikur, të mbrosh veten, apo të sulmosh.

Qelizat nervore formohen nga atome të pajetë, pa ndërgjegje. Por këto struktura e kapin situatën ku trupi

është në nevojë dhe menjëherë dërgojnë porosi tek vendet e duhura në trup. Pjesët që e marrin mesazhin, po ashtu janë bërë prej atomesh të pajetë, por megjithë këtë, ato menjëherë e kapin porosinë dhe veprojnë për të prodhuar hormonin e domosdoshëm. Pastaj ky hormon, që e di fare mirë qëllimin për të cilin është bërë, udhëton nëpër trup për të aktivizuar organet e duhura.

Të mendosh se një sistem i tillë qëllimplotë, i planifikuar me ndërgjegje, i

organizuar mund të kish ardhur përmes rastësisë është si të mbyllësh një sy ndaj logjikës dhe kuptimit praktik. Darwinistët, duke pretenduar se gjithë ky sistem ka ndodhur




si rezultat i rastësisë, e kanë vendosur veten në një pozicion qesharak ku edhe fëmijët do t'i përqeshnin për çka thonë ata.

Në fakt edhe shkrimtari dhe filozofi britanik me nam Malcom Muggeridge ka thënë këtë:

«Unë për vete jam i bindur se teoria e evolucionit, sidomos shkalla në të cilën ai është zbatuar, do të jetë një nga batutat më të forta në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen sesi një hipotezë e tillë kaq joserioze dhe e dyshimtë të pranohej me kaq lehtëbesim të habitshëm, siç ka ndodhur. (Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, f. 43)

E vërteta e qartë dhe e dukshme është se Zoti, Krijuesi Epror, ka krijuar këtë sistem pa të metë.



MUSHKËRITË KANË REPARTIN E TYRE TË VEÇANTË TË MBROJTJES

Disa qeliza në mushkëri në fakt spërkasin një biocid mbi bakteriet dhe mikrobe të tjera. Kësisoj, mikrobet dhe bakteriet që hyjnë përmes rrugëve të frymëmarrjes dhe mundin të mbërrijnë mushkëritë të gjalla, vriten atje.

Qelizat në mushkëri kanë sistemin e vet të mbrojtjes. Fill pasi identifikojnë mikrobet që hyjnë në trup përmes rrugëve të frymëmarrjes, ato çlirojnë një substancë që i neutralizon këto mikrobe.



Që një qelizë e imët, e padukshme me sy të lirë, të dallojë mes mikrobeve dhe lëndëve të tjera, kjo është një mrekulli e madhe, sepse nëse ajo merr vendim të gabuar, ajo mund të neutralizojë një lëndë tjetër që trupit i duhet.



Dukshëm, për qelizat e mushkërive është e pamundur që të njohin lëndët e dëmshme, aq më pak të dijnë të prodhojnë çfarëdo që nevojitet për t'i neutralizuar ato. Qelizave u mungojnë aftësitë si të menduarit, njohja, vendimarrja, ose planifikimi. Këto janë të gjitha produkte të Zotit, Atij të Vetmit që e krijoi gjithçka në harmoni dhe barazpeshë, dhe në rregullin në qiej e në Tokë. Duke bërë një qelizë e vetme të kryejë veprime me kaq ndërgjegje saqë i lë me gojë hapur qëniet njerëzore, Zoti shpërfaq shenjat e diturisë dhe mençurisë së pakufishme të Tij .

PO TË MOS ISHIN ENZIMAT, JUVE DO T'JU DUHEJ 40.000 VJET PËR TA LEXUAR KËTË

Enzimat janë molekula proteine që bëjnë të mundur jetën, që nxisin reaksionet e domosdoshme kimike për jetën duke u dhënë atyre pikërisht shpejtësinë e duhur.

Një enzimë mund të përshpejtojë një reaksion gjer në shkallën 10¹⁰ – dmth 10 miliardë më shpejt. Po të mos ndodhte ky përshpejtim, atëhere ato pesë sekonda që duhen për të lexuar këtë fjali mund të duheshin 1500 vjetë! Gjatë kësaj kohe, edhe mjaft reaksione kimike të paduhura mund të ndodhin, që jeta jo vetëm se do të ngadalësohej, por do të bëhej e pamundur.

Për më tej, çdo enzima mund të përshpejtojë vetëm reaksionet kimike në të cilët molekula të posaçme marrin pjesë. Një enzimë mund të ngjitet vetëm në vende të veçantë të një molekule të caktuar. Për këtë arsye, enzima duhet t'i rrijë mirë vendit të veçantë në molekulë, ashtu si çelësi në dry. Çdo enzimë duhet ta njohë molekulën e saj të veçantë, dhe vendin e saj të posaçëm ku lypset të bashkëngjitet.

Pse këto enzima, të bëra prej atomeve të pandërgjegjshme karboni, hidrogjeni dhe oksigjeni dhe të cilat nuk kanë tru, sy mendje a ndërgjegje, kanë marrë përsipër përgjegjësinë të përshpejtojnë reaksione në trup?

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Dhe si mund ta përcaktojnë ata molekulën e duhur ku të futen dhe vendin e posaçëm ku të bashkëngjitet?

Si e kanë vendosur rastësitë dhe atomet e pandërgjegjshme se që të vazhdojë jeta nevojiten enzimat?


Teoria e evolucionit, që i pranon rastësitë dhe atomet pa mend si perëndi, nuk ka përgjigje për këto pyetje. E vërteta është se këto enzima kanë qenë dizajnuar dhe krijuar për jetën nga Fuqia eprore dhe Krijuesi – dmth, Zoti.



ANTI-TRUPAT MUND TË LUFTOJË MIKROBE QË S'I KANË HASUR KURRË MË PARË

Çdo ditë, mijëra mikrobe depërtojnë në trup, dhe sistemi vetëmbrojtës i njeriut, imuniteti, menjëherë mundohet t'i neutralizojë ato. Megjithatë, disa mikrobe dhe lëndë të huaja që nuk mund të parandalohen së hyri në enët e gjakut dhe paraqesin rrezik të madh. Këto lëndë të huaja quhen antigjene. Por sistemi i imunitetit prodhon substanca që quhen antitropa, që veprojnë kundër këtyre antigjenëve; dhe mundohen t'i shkatërrojnë ata dhe i ndalojnë ata të shumohen.

Vetia më e rëndësishme e antitropave është aftësia e tyre për të njohur – dhe pastaj të pregatiten që t'i shkatërrojnë – qindra mijëra mikrobe të ndryshme që gjenden në natyrë. Më e çuditshmja fare, disa antitropa mund të njohin madje edhe antigjentët sintetikë, të pregatitur në laboratore dhe pastaj të injektuara në një subjekt prove. Si mundet që një qelizë të njohë qindra mijëra të huaja të tilla? Për më tepër, si e përfiton ajo aftësinë e njohjes së një substance që është sintetizuar artificialisht? Edhe nëse ne pranojmë se antitrupat mundet që diqysh ta njohin një antigjen në trup me të cilin kurrë nuk janë hasur më parë. Veç këtyre, ngaqë antitrupat mund t'i njohin lëndët e huaja që kanë depërtuar në trup, ato pastaj prodhojnë armën më efikase për ta përdorur kundër saj.



Rastësia nuk mund ta shpjegojë se si një mekanizëm brenda trupit mund të ketë të dhëna kaq habitëse mbi botën e jashtme. Ky fakt i qorron evolucionistët.

Këta, pasi kanë dështuar të shpjegojnë me teoritë e tyre aftësinë e antitropave që të njohin të gjitha llojet e lëndëve të huaja që futen në trup, mundohen

ta Ilustrojnë temën me shpjegime të kota, të paparanueshme shkencore.

Një shembull i shpjegimeve se si një antitrop mund të njohë antigenet sintetike mund të shihet në fjalët e një evolucionisti turk Profesor Ali Demirsoy:

... Një qelizë që ka zhvilluar aftësinë të sintetizojë një antitrop kundër një agjenti kimik i cili është prodhuar në mënyrë sintetike në shekullin e 20-të, patjetër duhet të jetë

fallxhore. (Professor Ali Demirsoy, *Kalitim ve Evrim* (Inheritance and Evolution), Meteksan Publications, Ankara 1995, f. 420).

Sikurse sygjeron Profesor Demirsoy, evolucionistët pranojnë përsosmërinë e gjallesave, por mundohen ta shpjegojnë atë me metoda imagjinare. Ata orvaten të hipnotizojnë popullin me deklarata fallxhorësh si: «Kjo është një mrekulli e evolucionit» ose «Kjo qelizë duhet të jetë magjistare». Sidoqoftë, këtu kemi të bëjmë me një gjendje të jashtëzakonshme. Fjala *magjistare* përdoret për njerëz që pretendojnë se kanë aftësi parashikuese apo paranjohëse. Fakti që një qelizë ka dijeni rreth gjërave që ndodhen shumë larg prej saj, është tejet e jashtëzakonshme. Prej një qelize të përbërë prej atomesh pa jetë nuk mund të pritet të ketë fuqi të forta paranjohëse apo dijeni rreth së ardhmes rastësisht, në mënyrë të vetëvetishme. Të bësh një pohim të tillë do të thotë të kapërcesh kufijtë e arsyes dhe logjikës. Kaq gjë është e dukshme: Këta antitropa i kanë dhuntitë e tyre prej Zotit, Ai i Vetmi që ka dijeni për gjithçka gjer në hollësinë më të vogël.

QELIZAT E SISTEMIT TË IMUNITETIT JANË KRIJUAR ME KUJTESË TË MADHE

Kur qelizat njoftohen për sulm mikrobial, ato menjëherë kumtojnë sistemin e imunitetit.

Saherë që ju infektoheni – për shembull – kur mikrobet pushtojnë një plagë të hapur – qelizat e sistemit të imunitetit aktivizohen menjëherë. Këto qeliza mbrojtëse, të njohura si *makrofagje*, përcaktojnë vendin e infektimit në kohë sa më të shkurtër dhe nisin reagimin kundër sulmit të mikrobeve dhe pastaj shpejtojnë për tek ky vend. Makrofagjet janë të ndjeshme ndaj një numër ndryshimesh.


Kur lëndohemi, ne e dimë se së shpejti do të shërohemi.
Por, sa pak mendojnë se kush e shëron atë plagë?



Për shembull, ata identifikojnë mbetjet bakteriale në një vend të caktuar, së bashku me praninë e lëndëve shkatërruese të prodhuara nga indet e infektuara, si edhe faktorët e

përfshirë në mpiksjen e gjakut. Nëse makrofagjet nuk do të mund të identifikonin ndryshimet në indet e infektuara, ata s'do të mund të reagonin dot ndaj rreziqeve të panumërta që trupit i kanosen çdo ditë.

Por ka diçka interesante: shumica e makrofagjeve ndeshen ballë për ballë me të tilla sulme për herë të parë.



Atëherë, si e mësuan këto qeliza të gjalla mikroskopike se çfarë përbën rrezik? A janë ushtruar ato për këtë punë?

Dukshëm, është e pamundur për këto makrofagje mikroskopike që të jenë arsimuar-kurrësesi. Të gjitha këto të dhëna kanë qenë në

kujtesën e tyre qysh në zanafillë të makrofagjeve. Një fuqi u ka dhënë atyre këtë kujtesë dhe i ka frymëzuar ato me njohuritë se si ta mbrojnë trupin nga armiqtë e jashtëm. Ai që i ka njohur ata me ndikimin e sulmeve nga jashtë është Perëndia e botëve, i Cili i ka krijuar ata bashkë me këtë njohuri – dmth, Zoti.

NË ATË QË SHEH – POR QË S'MENDON PËR TË- FSHIHET DITURIA E PAFUND DHE MREKULLITË

Po të presësh gishtin, për një kohë të shkurtër gjaku do të mpikset dhe rrjedhja e tij ndalet. Por si ngjet kjo mpiksje kështu në një kohë aq të shkurtër? Dhe çfarë ndodh në trupin tuaj?

Dukuria e mpiksjes së gjakut është e ngjashme me atë çka ndodh kur makinat e ambulancës dhe të policisë nxitojnë për tek një aksident autostrade.


Saherë që gjakosja fillon në një pjesë të trupit, ndihma e parë vjen nga pllakëzat e gjakut të quajtura thrombocyte, të cilat janë të shpërndara në gjithë sistemin e qarkullimit të gjakut. Kudo që të ndodhë gjakosja në trup, thrombocitet me siguri gjenden aty që të patrollojnë nga afër.

Një proteinë e quajtur *faktori von Willebrand* (vWF) ose glukoproteinë gjaku, që përfshihet në hemostasi, vepron si një polic trafiku që thërret për ndihmë, duke treguar vendin e aksidentit dhe duke u ndal përpara thrombocyteve që ata të mbesin në vendin me të lënduar. Sikur të ndërldheshin *wireless* (pa tela), thrombociti i parë që mbërrin në vend, thërret për ndihmë duke lëshuar apo sekretuar një substancë të veçantë, që thërret thrombocyte të tjera që të vijë tek vendi në fjalë. Sakaq, njëzetë enzima që gjenden në trup bashkohen që të

qeliza në mpiksje



mpiksje gjaku



kur gjakosja ndodh kudo në trup, proteinat e besuara me ndalimin e gjakut, menjëherë mbërrijnë në atë vend



prodhojnë një proteinë të quajtur *thrombinë* mbi plagën e hapur.

Thrombina prodhohet vetëm në atë vend ku është plaga, si një ekip i ndihmës së shpejtë që përgatit ilaçet e nevojshme për pacientin aty ku ndodhet. Për më tepër, kjo lypset të prodhohet aq sa duhet, dhe prodhimi i

thrombinës duhet të fillojë në kohën e

duhur dhe të ndalojë prodhimin po në kohën e duhur. Urdhrat për të filluar dhe përfunduar prodhimin shifrohen ndërmjet enzimave që përbëjnë këtë proteinë.

Sapo të jetë prodhuar *thrombinë* e mjaftueshme, formohen fibrat e imëta të fibrinogjenit. Ato kanë pikërisht

rolin e rëndësishëm të formimit të një rrjete mbi gjak, me atë të së cilës kapen, mblidhen thrombocitet që fillojnë të mbërrijnë. Sapo të jenë mbledhur sa duhen fibra, gjaku ndalon derdhjen nga plaga. Me shërimin plotësisht të plagës, mpiksja e gjakut zë e hollohet përmes metodave të ngjashme.


Këto enzima dhe proteina janë struktura që bashkohen me urdhra të ndryshme nga atome qorre, pa jetë, dhe pa ndërgjegje. Secili prej këtyre ndodhet në një gjendje të organizuar nga koha që shkaktohet plaga, dhe merr përsipër një detyrë të posçme të ndalimit të rrjedhjes së gjakut sa më shpejt që të jetë e mundur. Së bashku, ato sintetizojnë proteinat e nevojshme dhe pastaj *thërrasin për ndihmë*. Sikur ta kuptonin gjendjen se ç'po ndodh, proteinat e tjera menjëherë vijjnë tek plaga, ku secila kryen detyrën e vet pa dështuar.

Le të mos harrojmë që enzimat që kryejnë *organizimin, sintetizimin, thirrjen për ndihmë, dhe dhënies dum*, kanë ndodhur si rezultat i bashkimit të atomeve. Kjo shfaqje e ndërgjegjjes së dukshme prej një molekule atomesh të pandërgjegje, sigurisht, është një mrekulli e madhe.

Sigurisht është e pamundur për një sistem të tillë që të ketë dalë në jetë si rezultat i rastësisë. Çdo hollësi e këtij sistemi është një produkt i planifikimit dhe përllogaritjes, provë e diturisë, fuqisë dhe mençurisë së pafund të Zotit. Të thuash se ky sistem ka ardhur si rezultat i rastësisë është një shembull i logjikës së gabuar që shfaq darvinizmi.

PËR TË SHKATËRRUAR TEORINË E DARVIZMIT MJAFTON MADJE VETËM MOLEKULA MË E VOGËL

Proteina thrombin lejon gjakun të mpikset duke kthyer fibrinogjenin në fibrin. Megjithatë, ndonëse kjo proteinë gjithmonë



qarkullon nëpër gjak, ajo nuk çon gjithmonë në mpiksje të gjakut, duke penguar kështu gjakun që të lëvizë. Nëse ka gjakrrjedhje në vetëm një enë gjaku, ajo kupton se atje nevojitet

Mjaft proteina të ndërvarura hyjnë në veprim për të mpiksuar gjakun tek plaga. Këto proteina, të aktivizuara kur trupi merr plagë, nga ana e tyre aktivizojnë secilën proteinë tjetër që duhen për mpiksen.

mpiksje dhe fillon mpiksjen e gjakut. Nëse thrombina gjithmonë do të shkaktonte mpiksje, gjithë gjaku në enët e tij do të mpiksej, si rezultat i pranisë së thrombinut, dhe trupi nuk do të shpëtonte prej bllokimit të plotë të tij. Pra, si e përfiton thrombini aftësinë që të shkaktojë mpiksje vetëm në vendin ku nevojitet? Thrombini zakonisht është i pranishëm në plazmën e gjakut në një formë inaktive të quajtur *prothrombin*. Duke qenë inaktiv, ai nuk mund të kryejë detyrën e mpiksjes dhe kështu ne jemi të mbrojtur nga pasojat vdekjeprurëse të mpiksjes së pakontrolluar.

Por, ama, ç'e aktivizon *prothrombin* dhe ta shndërrojë atë në faktor mpiksës, thrombin, kur ndodh gjakosja?

Një proteinë në gjak, e quajtur *faktori Stuart*, ka vetinë e shndërrimit e *prothrombinut* në thrombin. Megjithatë, vetë faktori Stuart është i pranishëm *fjetur*, dhe lypset të *zgjohet*.

Në këtë pikë kemi të bëjmë me skenarin pulë-dhe-vezë. Prapë, një proteinë tjetër e quajtur *akselerin* (*accelerin*, ose përrshpejtues, nëse e pranojmë) nevojitet para se faktori Stuart mund të zgjohet dhe ta kthejë *prothrombin* në thrombin – për të ndaluar kështu gjakosjen në organizëm. Por ajo është vërtetë mahnitëse është se edhe akselineri është i pranishëm në një formë të fjetur për vete, e quajtur *proakselerin* (*proaccelerin*). Dhe ç'e aktivizon *proakselinerin*?

Thrombini!

Por nëse ju kujtohet, thrombini vjen pasi *proakselinerin* në këtë reaksion zinxhir. Kjo radhë ngjarjesh, në të cilën thrombini luan një rol në prodhimin e akselinerit, është si një fëmijë fëmije (nip, mbesë?) që ka lindur para gjyshes së

vet. Por ngaqë efekti i faktorit Stuart në thrombin është shumë i ngadaltë, sasi e vogël thrombini është gjithmonë e pranishme në gjak. Si rezultat, kjo sasi e vogël thrombini fillimisht aktivon akselerinin dhe pastaj, secila prej proteinave të nevojshme për mpiksjen futen në veprim, si dominotë në rrëzim e sipër.

Ne kemi shpjeguar këtu vetëm faktet fare sipërfaqësorë të procesit të mpiksjes. Të thuash se i tërë ky proces – i përbërë prej mjaft pjesëve që punojnë së bashku të ndërvarur, ku çdo pjesë kryen detyrën pa shpërfillje – është si rezultat i rastësisë, është pa logjikë dhe pa arsytim.

Evolucionistët thonë se gjallesat, së bashku me të gjithë sistemet e tyre, përfshirë mpiksjen e gjakut, kanë evoluar hap pas hapi. Por që të ndodhë mpiksja, të gjitha proteinat dhe enzimat të përfshira në të mvaren nga njëra-tjera. Hiq një përbërës, dhe të gjithë të tjerët dalin të papërdorshëm – zaten shkohet drejt vdekjes së organizmit. Si rezultat, çdo organizëm me një sistem mpiksjeje me mangësi nuk do të kishte kohë që të plotësoheshin pjesët e tjera dhe do të vdiste para se të riprodhonte. Rjedhimisht, ky shembull zhvlerëson pohimin se organizmat kanë evoluar nga specie të ndërmjetme. Por ne mund t'i shumëfishojmë shembujt shterrues, sepse trupat e gjallë e vazhdojnë ekzistencën e tyre në saj të qindra sistemesh të tilla të pavarura.

Krijuesi i të gjithë këtyre sistemeve është Zoti.

JETA JUAJ MVARET NGA DIÇKA AQ E IMËT SA NJË FILL PAMBUKU

Në mungesë të vetëm një enzime, speciet njerëzore mund të zhdukeshin. Vetëm një shembull do të mjaftonte për ta dramatizuar këtë.

Qelizat nervore, të quajtura neurone, mbështjellin trupin tonë, duke formuar një rrjetë të ndërlikuar. Një rrjedhë e vazhdueshme të dhënash kalon nëpër këtë rrjetë neuronesh. Sinjale elektrike kalojnë përgjatë çdo neuroni që përçojnë urdhëra e paralajmërime të panumërta mes trurit dhe organeve të tjera.


Por neuronet nuk formojnë një kabëll të gjatë që të shtrihet nga një pjesë e trupit tek një tjetër. Ata janë vendosur nga fundi në fund, por edhe nuk e takojnë njëri-tjetrin direkt. Mes tyre ka hapësira.

Por si rrjedh elektriciteti nga një qelizë nervore tek tjetra?

Kjo e bën këtë falë një sistemi mjaft të ndërlikuar që hyn në punë. Mes qelizave nervore ka një lëng të posaçëm që përmban enzima kimike tejet të veçanta, aftësi të jashtëzakonshme për të përçuar elektrone. Kur një sinjal elektrik arrin fundin e nervit, elektronet e tij depozitohen në këto enzima. Enzimat, që bartin elektronet e tyre, pastaj lëvizin nëpër lëngun dhe i kalojnë elektronet tek nervi pranë, duke përcjellë kështu sinjalin elektrik. Ky proces ndodh brenda nënndarjes më të vogël të sekondës, dhe rryma e elektricitetit nuk ndërpritet kurrësesi.

Prapë, edhe sikur të gjitha pjesët e trupit të ishin të

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



plotësuar, mungesa e kësaj enzime do të ishte e njaftueshme ta pengonte fare organizmin që të kryente funksionet e tyre. E njëjta do të ndodhte edhe nëse cilado enzimë e vetme, prej mijërave sosh, do të mungonte. Asnjë organizëm nuk e ka luksin të presë miliona vjetë për një

rastësi qorre që të plotësojë aftësinë e tij për të shpëtuar, siç është pretenduar nga teoria e evolucionit.


Ajo e vërtetë e dukshme këtu është se të gjitha gjallesat, përfshi njerëzit, janë krijuar me strukturën e tyre të përsosur dhe pa të metë gjithë njëherësh – që dmth, ato janë krijuar përsosmërisht prej Zotit.

RRJETI MË I NDËRLIKUAR NË BOTË NDODHET NË TRURIN TONË

Me ndihmën e strukturave të përsosura në trurin e njeriut, ne kemi aftësinë të kryejmë një numër punësh në të njëjtën kohë. Për shembull, ti mund të ngasësh automjetin ndërkohë që merresh me butonat e radio-kasetofonit, etj... dhe je në kontroll të timonit. Edhe pse bën një numër gjërash njëherësh, ti nuk përplasësh me makinën tjetër përpara teje në rrugë. Ndërsa kontrollon shpjetësinë me pedalin e gazit tek këmbët, ti kupton saktësisht çfarë raportohet në lajmet e transmetuara në radio. Ti mund të vazhdosh një bisedë me një pasagjer aty ku e patët lënë pak më parë. Me pak fjalë, mund të kryesh një numër bajagi të madh gjërash të ndryshme njëkohësisht, falë aftësisë së jashtëzakonshme të trurit tuaj.

Mundësimi i këtij bashkëpunimi është ndërvartësia e qelizave nervore të trurit, të cilat numërojnë afro 10 miliardë sosh. Nja 100 trilionë lidhje mundësojnë komunikimin ndërmejt këtyre qelizave. Në librin e tij «*In Evolution: A Theory in Crisis*», i Michael Denton (Evolucioni një teroi në krizë), Majkëll Dentoni shpjegon bash sa i madh është vërtet numri 100 trilionë.

Numrat që kalojnë rendin 10¹⁵, doemos, janë tërësisht përtej rrokjes me mend. Përftytyro një vend afërsisht sa gjysma e SHBA-ve (një milionë milje katrorë), mbuluar me një pyll drunjsh që përmbajnë 10.000 drurë për një milje katrorë. Nëse çdo pemë përmban njëqind mijë gjethe,



shumatorja e gjetheve në pyll do të ishte 1015, e barazvlefshme me numrin e lidhjeve në trurin e njeriut.

Veçoria e jashtëzakonshme e trurit tonë nuk mbaron me numrin e qartë të lidhjeve të tij neurale, sepse

secili prej 100 trilionë sosh ndodhet pikërisht në vendin ku ai duhet të jetë. Në rast se qoftë edhe një prej këtyre lidhjeve do të ishte në vend të gabuar, do të kishte një difekt në këtë rrjet, me pasoja mjaft të rënda. Por kjo nuk ndodh. Përveç fare pak sëmundjesh të veçanta, njerëzit vazhdojnë ekzistencën e tyre si rezultat i trilionave proceseve të mrekuëllueshme që vijnë natyrshëm tek ta.

Darvinistët pohojnë se këto 100 trilionë lidhje janë kryer si rezultat i rastësisë. Sipas tyre, nja 10 miliardë prej 100 trilionë qelizave në trupin e njeriut, diqysh, vendosën ashtu vetë, të bëhen qeliza nervore dhe pastaj morën një formë të duhuar dhe ndryshuan tiparet e tyre – të gjitha njëherësh! Të pakënaqur me këtë pamje, ato u lidhën me njëra-tjetrën në mënyrë të përkryer, duke përdorur 100 trilionë lidhje, pa asnjë gabim. Ky pretendim darvinist është njësoj si të thuash se rrejtja elektrik e qytetit të Nju Jorkut është

krijuar ashu rastësisht pas një stuhie një natë dhe bëri që rryma të mbërrijë çdo shtëpi, pa përjashtuar asnjë.

Është e qartë dhe e pranishme se një fuqi eprore e ka formuar dhe e kontrollon këtë sistem të përsosur. Kjo Fuqi është Krijuesi i të gjithë neve – Zoti.


GJITHÇKA QË TI MËSON ËSHTË NJË SHEMBULL I MADHËSHTISË SË KRIJESË SË ZOTIT

Qelizat nervore në trupin tënd janë si një rrjet, nëpër të cilin komunikohen urdhëra e komanda të panumërta mes trurit dhe organeve të tjera. Ky rrjet, megjithatë, nuk është i bydevi i pandërprerë. Sikurse sapo e përmendëm, ndërmjet këtyre neuroneve ka boshllëk, dhe kur një mesazh mbërrin këto boshllëqe, enzimat elektron-bartëse, apo neurotransmitera, e kalojnë mesazhin tek neuroni pasues.

Sapo këta neurotransmitera ta kenë lënë ngarkesën mbi fundin e fibrës së nervit pasues, ata janë të lirë. Por nëse do të të mblidheshin atje, ata do të bllokonin rrugën për palën tjetër të tranzmiterave që vijnë nga pas. Në një situatë të tillë, sinjali elektrik nuk do kalohet dot tek neuroni i radhës, dhe rryma do të ndërpritej. Por një problem i tillë nuk ndodh kurrë sespe një enzimë e posaçme e quajtur *acetilkolinesterazë* shkatërron kimikatet që grumbullohen me kohë në fund të fibrës nervore. Me fjalë të tjera, ajo fshin e pastron vendin. Kësisoj, rruga vazhdimisht mbetet e kthjellët për tranzmiterat që vijnë nga pas, duke eliminuar ngërçet apo ndërprerjet në transmetimin e impulseve.

Dhe kështu, prej mijëra enzimave në trupin tonë, qoftë edhe sikur vetëm kjo, *acetilkolinesteraza*, po të mungonte, kjo do të nënkuptonte prishjen e sinjalizimit elektrik nëpër gjithë trupin, nuk do të mund të jetonim.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Në këtë pikë, secili prej nesh duhet të pyesë veten: Kush i ka formuar këta sisteme pa të meta në trupin e të gjitha qënieve të gjalla, në të cilët as hollësia më e vogël nuk është shpërfillur? Kush i ka programuar molekulat që nuk kanë ndërgjegje, njohuri ose vullnet, të shpalosin sjelljen më të përshtatshme dhe inteligjente?

Asnjë nga këto: inteligjencë, dituri dhe mjeshtëri e përsosur nuk është rastësore. Evolucionistët, domeos heshtin me përgjigjet e tyre ndaj këtyre pyetjeve. Sepse Ai i

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Vetmi që ka krijuar enzimën – dhe Ai që ka frymëzuar secilën me detyrën e saj, dhe i Cili krijoi këtë jetë të përsosur nga e paqëna – është Zoti.

SHTOJCË

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera, teoria e evolucionit, u nxor me synim që të mohojë faktin e krijimit, por që në të vërtetë, nuk është asgjë veçse një dokërr joshkencore, e dështuar. Kjo teori, e cila pretendon se jeta ka dalë rastësisht nga materja e pajetë, është zhvlehtësuar prej evidencës shkencore të *dizajnit* të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca ka konfirmuar faktin se Zoti e krijoi gjithësinë dhe gjërat e gjalla në të. Propaganda që bëhet sot me qëllim që ta mbajnë gjallë teorinë e evolucionit, bazohet sall në shtrembërim të fakteve shkencore, interpretime të njëanshme, dhe gënjeshtër e të pavërteta, maskuar si shkencë.

Dhe prapë, kjo propagandë nuk mund ta fshehë dot të vërtetën. Fakti që teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës, është shprehur gjithnjë e më shumë në botën shkencore përgjatë 20-30 vjetëve të fundit. Hulumtimet e kryera, sidomos pas 1980-ës, kanë zbuluar se pretendimet e darvinizmit janë krejt të pabazuara, diçka që është thënë prej një numri të madh shkencëtarësh. Veçanërisht në SHBA, mjaft shkencëtarë nga fusha të filla si biologjia, biokimia dhe paleontologjia njohin pavlefshmërinë e darvinizmit dhe përdorin faktin krijimit për llogari të zanafillës së jetës.

Ne e kemi shqyrtuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit si një hollësi me shumë vlerë shkencore në mjaft prej veprave tona, dhe vazhdojmë të bëjmë të njëjtën gjë. Duke patur parasysh rëndësinë e këtij subjekti, do të ishte një dobi e madhe që ta përmbledhim këtu:



Luigj Pastër

Dështimi shkencor i darvinizmit

Edhe pse doktrina vjen larg qysh prej Greqisë së Lashtë, teoria e evolucionit u shty përpara me të madhe në shekullin e 19-të. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri atë temën kryesore të botës së shkencës, ishte ajo e Çarls Darvinit, *Origjina e specieve*, botuar më 1859. Në këtë libër, ai e mohon se Zoti krijoi speciet e ndryshme të gjalla në Botë, të ndara, por ai pohon se të gjitha qëniet e gjalla kanë një paraardhës të përbashkët dhe është shumëllojshmëruar me kalimin e kohës përmes ndryshimeve të vogla. Teoria e Darvinit nuk bazohet në ndonjë gjetje konkrete shkencore, siç e pranonte edhe ai, kjo ishte vetëm një *supozim*. Për më tepër, sikundër Darvini e pranon në një kapitull të gjatë të librit të tij «*Vështirësi në teori*», teoria dështoi përballë mjaft pyetjeve kritike.

Darvini i investoi gjithë shpresat tij në zbulimet shkencore, me të cilat ai i priste të zgjidhte këto vështirësi. Megjithatë, përkundër pritshmërive të tij, gjetjet shkencore i zgjeruan

përmasat e këtyre vështirësive. Humbja e darvinizmit përballë shkencës mund të shqyrtohet nën këto tri tema themelore:

- 1) Teoria nuk shpjegon dot se si jeta zuri fill në Tokë
- 2) Asnjë gjetje shkencore nuk tregon se *mekanizmi evolucionar* i paraqitur prej teorisë kanë ndonjë fuqi evolucionare, fare.
- 3) Të dhënat e fosiljeve provojnë krejt të kundërtën e asaj çka sugjeron teoria.

Në këtë pjesë, ne do t'i këqyrim këto tri pika themelore në skicim të përgjithshëm.

Hapi i parë i pakapërcyeshëm: Origjina e jetës.

Teoria e evolucionit parashton se të gjitha speciet evoluon nga një qelizë e vetme që doli në tokën primitive para 3.8 miliardë vjetëve. Si mundet që një qelizë e vetme mund të gjenerojë miliona specie të gjalla të ndërlikuara dhe, nëse një evolucion i tillë vërtet ka ndodhur, përse gjurmët e tij nuk mund të vërehen në të dhënat fosile, janë disa prej pyetjeve që teoria nuk mund t'i përgjigjet. Megjithatë, pikësëpari dhe mbi të gjitha, ne duhet të pyesim: Si zuri fill kjo qelizë e parë?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çdo lloj ndërhyrjeje të mbinatyrëshme, ajo mbron se qeliza e parë zuri fill rastësisht brenda ligjeve të natyrës, pa asnjë dizajn, plan apo ujdj. Sipas teorisë, materia e pajetë duhet të ketë prodhuar një qelizë të gjallë si rezultat i rastësisë. Një pohim i tillë, sidoqoftë, është në mospërputhje me rregullat më të pacënueshme të biologjisë.

«Jeta vjen nga Jeta»

Në librin e tij, Darvini asnjëherë nuk i referohet origjinës së jetës. Kuptimi primitiv i shkencës në kohën e tij mbështetej në marramendjen se qëniet e gjalla kishin një strukturë të thjeshtë. Qysh në mesjetë pohoimi se materiale të pajetë u mblodhën bashkë për të formuar organizma të gjalla, vetëvetiu të gjeneruara, është pranuar gjerësisht. Qe besuar praktikisht se insektet erdhën nga mbeturinat ushqimore, dhe minjtë nga gruri. Eksperimente interesante u kryen për të provuar këtë teori. Mbi një copë leckë të ndotur u vendos ca grurë, dhe besohej që pas një farë kohe prej saj do të dilnin minj.

Ngjashmërisht, krimbat që dalin nga mishi i qelbur merrej si provë e lindjes të vetëvetishme. Megjithatë, më vonë u kuptua se krimbat nuk u shfaqën në mish vetëvetiu, por u çuan aty prej mizave në formë larve, të padukshme me sy të lirë.

Edhe kur Darvini shkruajti *Origjinën e specieve*, besimi se bakteria mund të vinte në jetë nga materie pa jetë, pranohej gjerësisht në botën e shkencës.

Gjithësesi, pesë vjet pas botimit të librit të Darvinit, Luis Pastëri (Louis Pasteur) njoftoi rezultatet pas studimesh dhe eksperimentesh të gjata, që përgënjeshtrojnë lindjen spontane, një gurthemel i teorisë së Darvinit. Të leksionin e tij fitmtar në Sorborne më 1864, Pastëri tha: Doktrina e lindjes spontane nuk do të shërohet kurrë nga goditja vdekjeprurëse prej këti eksperimenti të thjeshtë (1 – shih në

fund të librit për referencat përkatëse me numrat në kllapa)

Për gjatë kohë, mbështetësit e teorisë së evolucioni i bënë qëndresë këtyre gjetjeve. Megjithatë, sikurse zhvillimet e shkencës e shplepsën strukturën e koklavitur të qelizës së një qenie të gjallë, idea se jeta mund të vijë rastësisht hasi një pengesë edhe më të madhe.

PËRPJEKJET SHTERPË TË SHEKULLIT TË NJËZETË



Aleksandër Oparin

Evolucionisti i parë që u mor me temën origjinës së jetës në shekullin e njëzetë ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin. Me teza të ndryshme që ai çoi përpara gjatë viteve 1930, ai u mundua të provojë se një qelizë e gjallë mund të lindë rastësisht. Këto studime, gjithësesi, ishin të dënuara të dështonin, dhe Oparinit iu desh të pranonte se:

«Megjithatë, fatkeqësisht, çështja e origjinës së qelizës është ndoshta pika më e turbullt e krejt studimit të evolucionit të organizmave.» (2)

Pasuesit evolucionistë të Oparinit u përpoqën të kryejnë eksperimente për ta zgjidhur këtë problem. Eksperimenti më i njohur u krye nga kimisti amerikan Stanley Miller më 1953. Duke kombinuar gazra që ai pretendonte se kishin

ekzistuar në atmosferën e qëmotshme të tokës, në një eksperiment të sajuar, dhe duke shtuar energji në përzierje, Milleri sintetizoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Zor se kishin kaluar disa vite kur u zbulua se ky eksperiment, i cili atëherë qe paraqitur si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, u bë i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në atë eksperiment ishte shumë e ndryshme nga kushtet reale të Tokës. (3)

Pas një heshtjeje të gjatë, Milleri pranoi se mjedisi atmosferik që ai kish përdorur ishte jo realist. (4)


Të gjitha përpjekjet e evolucionistëve përgjatë shekullit të njëzetë, për të shpjeguar origjinën e jetës, përfunduan me dështim. Gjeokimisti Xhefri Bada, nga Instituti Scripps i San Diegos pranon se ky fakt ndodhet në një artikull të botuar në revistën Earth (Toka) më 1998.

Sot, sikurse lëmë shekullin e njëzetë, ne vazhdojmë të ndeshemi me problemin më të madh të pazgjidhur që patëm kur hymë në shekullin e njëzetë:

Si nisi jeta në Tokë?

Struktura e ndërlikuar e jetës

Arsyeja kryesore pse teoria e evolucionit përfundoi në një ngërç kaq të madh, përse i përket origjinës së jetës, është se edhe ato organizma të quajtura të thjeshta kanë struktura tejet të ndërlikuara. Qeliza e qënies së gjallë është më e ndërlikuar se të gjithë produktet e bëra nga njeriu teknologjikisht. Sot, madje edhe në laboratorët më të



Një nga faktet që e zhvlerëson fare teorinë e e evolucionit është struktura tejet e ndërlikuar e jetës. Një shembull për këtë është molekula e ADN-së që ndodhet në bërthamën e qelizave të qënieve të gjalla. ADN-ja është, si të thuash, një bankë të dhënash, formuar me ujdinë e katër molekulave në renditje të ndryshme. Kjo bankë të dhënash përmban kodet e të gjitha prirjeve të qënieve të gjalla. Kur ADN-ja njerëzore hidhet në shkrim, llogaritet që të na dalë një encikolpedi të përbërë prej 900 vëllimesh. Pa diskutim, të dhëna kaq të jashtëzakonshme, përfundimisht e hedhin poshtë konceptin e rastsisë.

përparuar të botës, një qelizë e gjallë nuk mund të prodhohet duke bashkuar kimikate organike.

Kushtet që kërkohen për formimin e qelizave janë aq të mëdha në sasi për t'i shpjeguar me anë të rastësisë. Gjasat që proteinat, blloqet ndërtuese të një qelize, të jenë sintetizuar rastësisht, janë 1 në 10^{950} për një proteinë mesatare të përbërë prej 500 amniocidesh. Në matematikë, një gjasë më e vogël se 1 mbi 10^{50} trajtohet si e pamundur në kuptimin praktik.

Molekula e ADN-së, e cila ndodhet në bërthamën e qelizës dhe e cila mban të dhëna gjenetike, është një bankë e jashtëzakonshme të dhënash. Sikur të dhënat e shifruara në ADN të shkruheshin, kjo do mbushte një

bibliotekë me afërsisht 900 vëllime enciklopedish me nga 500 faqe secili.

Një mydyshje del në këtë pikë: ADN-ja mund ta kopjojë veten vetëm me ndihmën e disa proteinave të posaçme (enzimat). Megjithatë, sinteza e këtyre enzimave mund të kryhet vetëm përmes të dhënave të shifruara në ADN. Sikurse ato të dyja mvaren nga njëra-tjetra, atyre u duhet të ekzistojnë të dyja në të njëjtën kohë për kopjimin. Kjo e sjell në një qorrsokak skenarin se jeta ka nis vetë. Profesorja Leslie Orgel, një evolucioniste me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, pranon këtë fakt në numrin e shtatorit 1994 të revistës *Scientific American* (Amerikani shkencor):

«Është skajshmërisht e pagjasë që proteinat dhe acidet nukleike, të cilat të dyja janë struktura të ndërlikuara, të jenë formuar spontanisht në të njëjtin vend, në të njëjtën kohë. Dhe prapë, po ashtu, duket e pamundur të keshë njëren e të mos keshë tjetrën. Dhe kësisoj, në pamje të parë, mund të dalësh me përfundimin se jeta, në fakt, asnjëherë s'mund të ketë nisur me mënyra kimike. (6)

Padyshim, nëse jeta është e pamundur të ketë nisur nga shkaqe natyrore, atëhere duhet pranuar se jeta u krijua në një mënyrë të mbinatyrëshme. Ky fakt zhvlefëton shprehimisht teorinë e evolucionit, synimi kryesor i së cilës është të mohojë krijimin.

MEKANIZMI I PËRFYTYRUAR I EVOLUCIONIT

Pika e dytë e rëndësishme që hedh poshtë teorinë e darvinizmit është se të dy konceptet e parashtruara nga teoria si *mekanizma evolucionarë* u kuptuan se, në realitet, nuk kishin fuqi evolucionare.

Darvini i bazoi pretendimet e tij të evolucionit tërësisht mbi mekanizmin e *përzgjedhjes natyrore*. Rëndësia që ai dha këtij mekanizmi ishte i dukshëm në emrin e librit të tij: *Origjina e specieve: Nëpërmjet seleksionimit natyror...* (*The Origin of Species, By Means of Natural Selection*).


Seleksionimi natyror mbahet pas idesë se ato qenie të gjalla që janë më të forta dhe më të përshtatur ndaj kushteve të mjedisit ku jetojnë do të ngadhëjnë në luftën e tyre për jetë. Për shembull, në një tufë drerësh të kërcënuar nga një sulm prej kafshësh të egra, ato që mund të vrapojnë më shpejt do të shpëtojnë. Prandaj, tufa e drerëve do të përbëhet prej individësh më të shpejtë e më të fortë. Ky mekanizëm, megjithatë, pa asnjë diskutim, nuk do të bëjë që drerët të evoluojnë dhe të transformojnë veten në specie të tjera, psh, kuaj.

Prandaj, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk ka fuqi evolucionare. Darvini gjithashtu ishte i vetëdijshtë për këtë fakt dhe iu desh ta thotë në librin e tij: *Origjina e specieve*.

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë derisa të ndodhin ndryshime apo variacione të favorshme individuale. (7)

NDIKIMI LAMARCK

Atëherë, si mund të ndodhin këto *variacione të favorshme*? Darvini u orvat t'i përgjigjet kësaj pyetjeje nga këndvështrimi i kuptimit primitiv të shkencës në atë kohë. Sipas biologut francez Chevalier de Lamack (1744-1829), i cili vdiq para Darvinit, krijesat e gjalla i kalojnë brezit të ardhshëm veçoritë që ata fitojnë gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto veçori, të cilat mbledhen nga një brez tek tjetri, ka bërë që të formohen specie të tjera. Për shembull, ai pohonte se xhirafat kanë evoluar nga antilopët, u zgjatën nga brezi në brez, sikurse përpiqeshin të hanin gjethe të pemëve të larta.



Lamarcku besonte se xhirafat kanë evoluar nga kafshë të tilla si antilopa. Në këndvështrimin e tij, qafat e këtyre kafshëve barrngrënëse, dalëngadalë u zgjat, dhe më pas u shndërruan në xhirafa. Ligjet e trashëgimisë, zbuluar prej Mendelit më 1865 provuan se ishte e pamundur që vetitë e fituara gjatë jetës t'u kalohen brezave pasardhës. Përralla e xhirafave të Lamarckut u hodh në koshin e plehrave të historisë,

Edhe Darvini jep shembuj të ngjashëm. Në librin e tij *Origjina e specieve*, për shembull, ai thotë se disa arinj duke shuar në ujë urinë për ushqim, me kalimin e kohës u shndërruan në balena. (8)

Megjithatë, ligjet e trashëgimisë të zbuluara nga Gregor Mendeli (1822-1884) dhe të verifikuara nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzetë, e rrëzoi krejtësisht legjendën se vetitë e fituara i kaloheshin brezave të ardhshëm. Kështu, selksionimi natyral ra si i parapëlqyer i mekanizmit evolucionar.

Neo-darvinizmi dhe çrregullimet gjenetike. (Mutacionet)

Me qëllim që të gjejnë një zgjidhje, darvinistët e çuan përpara *Teorinë bashkëkohore sintetike (the "Modern Synthetic Theory")*, ose siç njihet zakonisht Neo-darvinizmi, në fund të vitieve 1930. Neo-darvinizmi shtoi ndryshimet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e qënieve të gjalla për shkak të faktorëve të jashtëm si radiacioni ose gabimet e kopjimit, si pasojë e *llojshmërisë të favorshme* përpos ndryshimeve natyrore.

Sot, modeli që qëndron për evolucionin në botë është Neo-darvinizmi. Teoria i përmbahet asaj që miliona qenie të gjalla të formuara si rezultat i proceseve përmes të cilëve një numër i madh organesh të ndërlikuara të këtyre organizmave (si, veshë, sy, mushkëri dhe krahë) kanë pësuar ndryshime, apo *mutacione*, dmth, çrregullime

gjenetike. Megjithatë, për këtë nuk ka një fakt të qartë shkencor që ta minojë këtë teori krejtësisht: Çrregullimet gjenetike nuk shkaktojnë zhvillimin e qenieve njerëzore, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është fare e thjeshtë: ADN-ja ka një strukturë shumë të ndërlikuar, dhe efekte të rralla vetëm se mund ta dëmtojnë atë. Gjenetisti amerikan B.G. Ranganathan e shpjegon këtë si më poshtë:



Mutacionet (ndryshimet) janë rezultat i ndikimeve të jashtme të filla si radiacionet ose veprimet kimike.

Ky djalë i ndryshuar vietnamez është viktimë e armëve bërthamore

Së pari, mutacionet e vërteta si natyrë janë shumë të rralla. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme ngaqë ata janë të rastësishëm, dhe jo ndryshime të rregullta në strukturën e gjenit, çdo ndryshim i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të jetë për më keq dhe jo për më mirë. Për shembull, në qoftëse një tërmet do të tundte një strukturë mjaft të rregullt, si psh një ndërtesë, do të kishim një ndryshim të rastësishëm në skeletin e

ndërtesës, i cili me të gjithë gjasat, nuk do të përmirësohet.(9)

S'është çudi që asnjë shembull mutacioni i cili është i dobishëm, dmth, që është vërejtur të zhvillojë kodin gjenetik, nuk është parë gjer tani.

Të gjithë mutacionet kanë vërtetuar se janë të dëmshëm. Është kuptuar se mutacionet, që janë paraqitur si një *mekanizëm evolucionar*, zaten është një dukuri gjenetike që i dëmton qëniet e gjalla, dhe i lë ato të paafta. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qëniet njerëzore është kanceri). Një mekanizëm shkatërrues, doemos, nuk mund të jetë një *mekanizëm evolucionar*. Seleksionimi natyral, nga ana tjetër, *nuk mund të bëjë asgjë vetë më vetë*, sikurse edhe Darvini e pranoi. Ky fakt na tregon neve se nuk ka *mekanizëm evolucionar* në natyrë. Meqenëse mekanizmi evolucionar nuk ekziston, as edhe ndonjë proces i tillë imagjinar, i quajtur *evolucion*, nuk mund të ketë ndodhur.

Të dhënat fosile: Nuk ka shenja të formave të ndërmjetme

Provat më të qarta që skenari sygjeron përmes teorisë së evolucionit nuk gjendet në të dhënat fosile.

Sipas kësaj teorie, çdo specie e gjallë ka dalë nga një paraardhës. Një specie paraekzistuese u shndërrua në diçka tjetër me kalimin e kohës dhe të gjitha speciet në

jetë në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky proces transformimi përparon gradualisht për gjatë miliona vjetë.



Fosile 100-150 milionë vjeçare
peshk ylli.
(Epoka Kretacioza e Vonë)



Fosile 450 milionë vjeçare:
Gaforre patkua nga epoka
Ordoviciane.



Fosile Pilivese
150-200 milionë vjeçe.
(Epoka Jurasike e Mëvonshme)



Fosile karkaleci deti, 100-150
milionë vjeçe. (Epoka Kretaciozë e
Vonë).

Grupe të ndryshme qëniesh të gjalla janë shfaqur befas, pa paraardhës pas tyre, dhe mbetën të pandryshuar, për miliona vjetë, pa pësuar asnjë ndryshim.



Fosilja e pelivesës para 150-200 milionë vjetësh (Epoka Jurasike e vontë) nuk ndryshom nga gjallesa e sotme e të të njëjtit lloj.

Po të kishte qenë kështu, një numër specimesh të ndërmjetme duhet të kenë ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe transformimi.

Për shembull, disa gjysëm-peshk/gjysëm-zvarranikë duhet të kenë jetuar në të kaluarën të cilët kanë përfutur disa veçori zvarraniku përveç atyre të peshkut që i kishin. Ose duhet të kenë ekzistuar disa shpend-zvarranikë, të cilët kanë përfutur disa tipare shpendi përpos atyre të zvarranikut që kishin tanimë. Meqë këto do të ishin në një fazë transformimi, ato duhet të ishin qenie të gjalla të gjymtë, të paralizuar, difektivë. Evolucionistët referohen këtyre krijesave imagjinare, që ata besojnë se kanë jetuar në të kaluarën, si *forma kalimtare*.

Nëse kafshë të tilla kanë ekzistuar vërtet, atëherë duhet të kishte miliona, e madje miliarda sosh, në numër dhe llojshmëri. Më e rëndësishme, mbetjet e këtyre krijesave të

çuditshme duhet të jenë të pranishme në të dhënat fosile.

Në librin *Origjina e specieve*, Darvini shpjegon:

Nëse teoria ime është e vërtetë, shumëllojshmëritë e panumërta të ndërmjetme, që lidhin më së afërmi të gjitha speciet e të njëjtit grup së bashku duhet të kenë ekzistuar patjetër. Rrjedhimisht, evidenca e ekzistencës së tyre të mëparëshme mund të gjendet vetëm nëpër mbetjet fosile.
(10)

Shpresat e Darvinit të shpartalluara

Megjithatë, edhe pse evolucionistët kanë bërë përpjekje të mundimshme për të gjetur fosile qysh prej mesit të shekullit të 19-të, nëpër të gjithë botën, asnjë formë kalimtare nuk është zbuluar akoma

Të gjitha fosilet, përkundër pritshmërisë së evolucionistëve, tregojnë se jeta në tokë është shfaqur përnjëherësh dhe e plotformuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, ndonëse është një evolucionist, e pranon këtë fakt.

Kuptimi del që nëse ne këqyrim të dhënat fosile në hollësi, qoftë në nivel radhe apo speciesh, do të mësojmë se – në mënyrë të përsëritshme – jo evolucion gradual, por shpërthim të menjëherëshëm i një grupi në dëm të një grupi tjetër. (11)

Kjo do të thotë se në të dhënat fosile, të gjitha speciaet e gjalla befaz dalin njëherësh të formuara plotësisht, pa forma të kalimtare në mes. Kjo është krejt e kundërta e hamendjes së Darvinit. Kjo gjithashtu është një provë e fortë se të gjitha qëniet e gjalla janë krijuar. I vetmi shpjegim që një qenie e gjallë ka dalë përnjëherësh dhe e plotë me çdo imtësi, pa ndonjë paraardhës evolucionar, është se ajo është krijuar. Ky fakt është pranuar gjithashtu edhe prej biologut evolucionist gjerësisht të njohur Douglas Futuyma:

Krijimi dhe evolucioni, ndërmjet tyre, nxjerrin shpjegimet e mundshëm për origjinën e qënieve të gjalla. Organizmat

ose janë shfaqur në tokë plotësisht të zhvilluara ose jo. Nëse jo, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie parakzistuese përmes ndonjë procesi modifikimi. Nëse janë shfaqur në gjendje të zhvilluar plotësisht, ato duhet vërtet të jenë krijuar prej ndonjë zgjuarsie të gjithëditur. (12)

Fosilet tregojnë se qëniet e gjalla kanë dalë të zhvilluara plotësisht dhe në një gjendje të përsosur në tokë. Kjo nënkupton se *origjina* e *specieve*, në kundërshtim me supozimin e Darwinit, nuk është evolucion por krijim.


Përralla e evolucionit njerëzor

Subjekti më shpesh i sjellë prej mbështetësve të teorisë së evolucionit është ai i origjinës së njeriut. Pohimi darvinist mbron se njeriu modern ka evoluar prej krijesave si majmunë. Gjatë këtij procesi të supozuar evolucionar, i cili duhet të ketë filluar 4-5 milionë vjetë më parë, disa *forma kalimtare* supozohet të kenë ekzistuar ndërmjet njeriut modern dhe paraardhësve të tij. Sipas këtij skenari tërësisht imagjinar, janë rreshtuar katër *kategori* bazë:

1. *Australopithecus*
2. *Homo habilis*
3. *Homo erectus*
4. *Homo sapiens*

Evolucionistët i quajnë paraqrdhësit e ashtuquajtur *si* majmun të njeriut *Australopithecus*, që do të thotë majmun i Afrikës së Jugut. Këto qënie të gjalla zaten nuk janë asgjë përveçse specie të vjetra majmuni që janë zhdukur. Hulumtimet e gjera bërë me mostra gjedhësh

Australopitheus prej dy anatomistëve më me emër në botë, nga Britania dhe SHBA, pra, Lord Solly Zuckerman dhe Profesor Charles Oxnard, tregojnë se këta majmunë i përkasin një specieje të zakonshme majmunash që u zhdukën dhe nuk bartnin ngjashmëri me njerëzit. (13)



Nuk ka mbetje fosile që të mbështesin përrallën e evolucionit njerëzor. Përkundrazi, të dhënat e fosileve tregojnë se ka një pengesë të pakapërcyeshme mes majmunëve dhe njerëzve. Përballë kësaj të vërtete, evolucionistët i kanë gozhduar shpresat e tyre në vizatime e forma. Ata më kot u vënë maska mbetjeve fosile dhe fabrikojnë fytyra të imagjinuara gjysëm-majmun e gjysëm-njeri.

Evolucionistët e klasifikojnë etapën tjetër të evolucionit njerëzor si *homo*, që dmth njeri. Sipas pohimit të tyre, qëniet njerëzore të sërës *Homo* janë më të zhvilluara sesa *Australopithecus*-ët. Evolucionistët përdorin një skemë të

çuditshme evolucioni duke ujdísur fosile të ndryshme të këtyre krijesave në një rend të posaçëm. Kjo skemë është imagjinare sepse nuk është provuar asnjëherë të ketë një marrdhënie evolucionare mes këtyre klasash të ndryshme. Ernst Mayr, një prej evolucionistët më të rëndësishëm të botës, debaton në librin e tij *Një argument i gjatë* (*One long argument*), se *problemet e veçanta historike, siç është origjina e jetës ose e Homo sepians-ëve, janë tejet të vështira dhe mund t'i rezistojnë edhe një shpjegimi përfundimtar, të kënaqshëm.* (14)

Duke e përshkruar lidhjen zinxhir si *Australopithecus > Homo habilis > Homo erectus > Homosepiens*, evolucionistët nënkuptojnë se secili prej këtyre specieve është paraardhës i njëri-tjetrit. Megjithatë, gjetjet e kohëve të fundit të paleontologëve kanë zbuluar se *Australopithecus, Homohabilis dhe Homo erectus* kanë jetuar në pjesë të ndryshme të botës në të njëjtën kohë. (15)

Për më tepër, një segment i veçantë i njerëzve të klasifikuar si *Homo erectus* kanë jetuar deri vonë në kohët moderne. *Homo sapiens neandarthalensis* dhe *Homo sapiens sapiens* (njeriu modern) kanë bashkëekzistuar në të njëjtin rajon. (16)

Duket qartë se kjo gjendje tregon pavlefshmërinë e pohimit se ata janë paraardhës të njëri-tjetrit. Stephen Jay Gould e shpjegon këtë qorrsoak të teorisë së evolucionit, ndonëse edhe vetë ishte një prej krerëve mbështetës të evolucionit në shekullin e njëzetë.

Ç'bëhet me shkallën tonë nëse janë tri prejardhje të përbashkëta hominids-ish (A-africanus, australopithecines-at e fuqishëm, dhe H – habilis), qartësisht, asnjëri nuk ka dalë nga një tjetër? Për më tepër, asnjë prej këtyre nuk shfaq ndonjë prirje evolucionare përsakohë që janë në tokë. (17)

E thënë shkurt, skenari i evolucionit njerëzor, i cili *mbahet* me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të disa krijesave *gjysëm majmuni - gjysëm njeri* që shfaqen në media dhe libra shkollorë, dmth, e thënë troç, nëpërmjet propagandës, është hiç më pak se një përrallë pa themele shkencore.

Lordi Solly Zuckerman, një prej shkencëtarëve më me emër dhe të respektur në Mbretërinë e Bashkuar, i cili kreu hulumtimet mbi këtë subjekt për disa vite radhë dhe studjoi fosilet e *Australopithecus-ve* për 15 vjetë, pas së gjithash, doli me përfundimin, megjithëse ishte vetë një evolucionist, se në fak, nuk ka asnjë pemë biologjike prej të cilës nga krijesa si majmun të degëzojë njeriu.

Zuckermani bëri gjithashtu një *gamë të shkencës* që varionte nga ato që ai i konsideronte shkencore tek ato joshkencore, sipas tij. Sipas spektrit të Zuckermanit, më «shkencorja» - dmth, mbështetur në të dhëna konkrete – fusha të shkencës janë kimia dhe fizika. Pas tyre vijnë shkencat biologjike dhe shkencat shoqërore. Fare në fund të spektrit, i cili konsiderohet si më jo-shkencori, janë «perceptimet jashtë-shqisore» - koncepte të tilla si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe përfundimisht «evolucionin njerëzor». Zuckermani shpjegon arsyetimin e tij:

Pastaj ne kalojmë menjëherë prej regjistrit të së vërtetës objektive në këto fusha të shkencës së supozuar biologjike, shi si perceptimi jashtë-shqisor ose interpretimi i historisë fosile të njeriut, atje ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit) nganjëherë mund të besojë disa gjëra kundërthënëse në të njëjtën kohë. (18)

Përralla e evolucionit njerëzor, pas së gjithash, avullon si një interpretim i njëanëshëm i disa fosileve të gërrmuara prej disa njerëzish të veçantë, të cilët mbështesin qorrazi teorinë e tyre.

Formula darviniane

Krahas gjithë evidencës teknike me të ciën ne jemi marrë deri tani, le ta këqyrim një herë të vetme, sa bestytë janë evolucionistët, me një shembull aq të thjeshtë aq sa mund ta kuptojnë edhe fëmijët:

Teoria e evolucionit pretendon se jeta është formuar rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pandërgjegje u mblodhën për të formuar qelizën dhe pastaj diqysh formuan të tjera gjallesa, përfshirë njeriun. Le ta mendojmë pakëz këtë. Kur ne bashkojmë elementët që janë blloqet ndërtues të jetës, të fillë si karbonin, fosforin, azotin dhe kaliumin, vetëm një piring bëhet. Çfarëdo trajtimi t'i nënshtrohet ky piring atomik, nuk mund të formojë as edhe një qenie të vetme të gjallë. Po të duash, le të formulojmë një *eksperiment* mbi këtë subjekt dhe le të

këqyrim në emër të evolucionistëve çka ata vërtet supozojnë pa e deklatuar hapur nën emrin «Formula Darwiniane».

Le të vendosin sa të duan materjale të pranishme në kompozimin e gjallesave si fosfor, kalium, azot, karbon, oksigjen, hekur, dhe magnez në fuqi të mëdha. Veç të tjerash, le të shtojnë ata në këto fuçi edhe çdo material që nuk gjendet në kushte normale, por që ata e mendojnë si të domosdoshëm. Lëri të shtojnë në këtë përzierje aq sa të duan aminoacide e po aq proteina – vetëm një e vetme prej të cilave ka probabilitetin e fomimit 10⁻⁹⁵⁰ – si të duan ata. Le t'i vënë këto nën nxehtësi a lagështi sa të duan. Le t'i trazojnë këto me çdo lloj pajisje të avancuar teknologjike që të duan ata. Le të vendosin shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspertë në radhë përmbri këtyre fuçive për miliarda, e madje edhe trilion vjetë. Le të jenë të lirë të përdorin çdo lloj kushtesh që ata besojnë se janë të domosdoshme për formimin e njeriut. Çfarëdo që të bëjnë ata, nga këto fuçi nuk mund të prodhojnë njeri, thotë një profesor që këqyr strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektroni. Ata nuk mund të prodhojnë xhirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, hurma, mollatarta, bostan, shalqinj, fiq, ullinj, rush, pjeshkë, bizele, pallonj, fazanë, flutura shumëngjyrëshe, ose miliona qenie të tjera të gjalla të tilla si këto. Në të vërtetë, ata nuk do të mund të përftojnë dot qoftë edhe një qelizë të vetme të çdonjërës prej tyre.

Shkurtimisht, atomet pa ndërgjegje nuk mund të formojnë qelizë duke u bashkuar. Ata nuk mund të marrin një vendim të ri e ta ndajnë këtë qelizë më dysh, dhe pastaj të marrin vendime të tjera dhe të krijojnë profesorat të cilët fillimisht shpikin mikroskopin e elektronit dhe pastaj këqyrin strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materja është një piring pa ndërgjegje, i pajetë, dhe që vjen në jetë me krijesën eprore të Zotit.

Teoria e evolucionit, e cila pretendon të kundërtën, është një fallsitet i plotë, tërësisht në kundërshtim me arsyen. Vetëm pak të mendosh rreth pretendimit të evolucionistëve, e zbulon këtë realitet, sikurse në shembullin e mësipërm.

Teknologjia në sy dhe veshë

Një tjetër subjekt që mbetet pa përgjigje nga teoria evolucionare është cilësia e përkryer e ndjeshmërisë në sy dhe vesh.

Përpara se të kalojmë tek subjekti i syrit, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes sesi shohim ne. Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt bien përballë retinës së syrit. Këtu, këto rreze drite kthehen në sinjale elektrike prej qelizave dhe arrijnë një vend të vockël prapa trurit, *qendra* e *shikimit*. Këta sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër si një figurë pas një sërë procesesh. Me këtë njohuri teknike, le të mendojmë pakëz.



Krahasuar me kamerat dhe pajisjet e inçizimit të zërit, syri dhe veshi janë shumë më të ndërlikuar, shumë më të suksesshme dhe bartin tipare tejet më sipërore se këto pajisje të teknologjisë së lartë.


Truri është i izoluar nga drita. Kjo domethënë se brenda tij është krejtësisht errësisrë, dhe aspak dritë mbërrin atje ku ndodhet truri. Kështu, *qendra e shikimit* nuk preket kurrë nga drita, dhe mund të jetë gjëja më e errët që mund të keni njohur ndonjëherë. Megjithatë, ju këqyrni një botë të shkëlqyer, të ndriçuar në këtë errësi sterrë.

Pamja e formuar në sy është aq e mprehtë dhe e dallueshme saqë edhe teknologjia e shekullit të njëzetë nuk ka mundur ta përftojë dot. Për shembull, shih librin që po lexon, duart me të cilët e mban atë, dhe pastaj ngre kryet she shiko rrethrotull vetes. A keni parë ju ndonjëherë një pamje kaq të mprehtë e të shquar si kjo diiku tjetër? Madje as ekranet televizivë më të zhilluar të prodhuar në botë nuk mund të japin një pamje kaq të kjartë. Kjo është

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*



Kur dikush sheh përmes dritares, ai zaten shikon pamjet e natyrës që formohen në trurin e tij, në vend të vetë botës përjashtë.



Drita që mbërrin sytë shndërrohet në sinjale elektrike prej qelizave optike dhe i transmetohen qendrës pamore prapa trurit. «Ndërgjegjja» në trutë tanë i merr këta sinjale si pamje

tre dimensionale, me ngjyrë, dhe një pamje tejet të mprehtë. Për më shumë se 100 vjetë, mijëra inxhinjerë janë munduar të arrijnë mprehtësi. Fabrika, stabilimente, kërkime shkencore të kryera, plane e projekte janë bërë për këtë qëllim. Prapë, shih një ekran televizori dhe librin që mban në dorë. Do të shohësh një ndryshim shumë të madh në mprehtësi dhe shquarje. Për më tepër, ekrani televiziv të jep një pamje dy dimensionale, kurse me sytë tuaj ti sheh një pamje tredimensionale me thellësi.

Për vite të tëra, dhjetëra mijëra inxhinjerë janë munduar të bëjnë një televizor tre-dimensional dhe të arrijnë një cilësi shikimi si e syrit. Po, kanë bërë një sistem televiziv 3-dimensional, por ai nuk është i mundur të shikohet pa vënë syze të posaçme 3-D, veç të tjerash, është vetëm një 3-dimension artificial. Sfondi është më i mjegullt, pahu duket si një letër e shtypur. Kurrë s'ka qenë e mundur të prodhohet një figurë e mprehtë dhe e qartë si ajo e syve. Si në telekamera dhe në televizor, ka humbje të cilësisë së figurës.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë figurë të shquar e të mprehtë është formuar rastësisht. Tani, nëse dikush do të thoshte ty se televizori që ti ke në dhomë është formuar si rezultat i rastësisë, se të gjithë atomet e tij thjesht u mbledhën dhe bënë këtë pajisje që prodhon figurë, çfarë do të mendoje? Si ka mundësi që atomet të bënë atë çka mijëra njerëz s'munden dot?

Nëse një pajisje që prodhon një figurë më primitive se syri nuk mund të bëhej rastësisht, atëherë është fare e dukshme se syri dhe pamja e shikuar prej tij nuk mund të

jetë formuar rastësisht. E njëjta shkon edhe për veshin. Veshi i jashtëm kap tingujt e disponueshëm nëpërmjet aurikulës dhe i drejton ato tek veshi i mesëm, ky i përcjell dridhjet e tingujve duke i smadhuar ato, dhe veshi i brendshëm i dërgon këto dridhje në tru duke i përkthyer ato në sinjale elektrike. Ashtu sikurse me syrin, veprimi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit, në tru.

Situata në sy është gjithashtu e vërtetë edhe për veshin. Pra, truri është i izoluar nga tingulli ashtu si edhe nga drita. Ai nuk lejon asnjë tingull në të. Kësodore, sado zhurmë të ketë jashtë, brenda trurit është heshtje e plotë. Megjithatë, tingujt më të hollë perceptohen në tru. Në trurin tënd krejt të heshtur, ti dëgjon simfoni, dhe të gjitha zhurmat në një vend plot njerëz. Megjithatë, po të matej niveli i zhurmës në trurin tënd me anë të një pajisjeje të saktë në atë çast, atje do të sundonte heshtje e plotë.

Sikundër me rastin e shikimit, dekada të tëra përpjekjesh i janë kushtuar prodhimit dhe riprodhimit të tingujve që të jenë si origjinali. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë inçizues tingujsh, sisteme të cilësisë së lartë, dhe sisteme për të ndjerë tingullin. Megjithë këtë teknologji dhe mijëra inxhinjerë dhe ekspertë që kanë punuar në këtë sipërmarrje, akoma nuk është arritur tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli i perceptuar nga veshi. Mendo sistemin e cilësisë më të lartë Hi-Fi prodhuar nga kompania më e madhe në industrinë e muzikës. Edhe me këto pajisje, kur regjistrohet zëri, diçka nga cilësia e tij humbet, ose kur e ndez një sistem të tillë, përpara se të fillojë muzika, dëgjihet një *hiss*. Megjithatë, tingujt që

janë produkt i teknologjisë trupore jannë tejet të mbprehtë dhe të qartë. Një vesh njeriu kurrë nuk dëgjon një tingull të shoqëruar me tingull *hisssi* ose me shkarkesa atmosferike sikurse i ndjen një Hi-Ffi, në vend të kësaj, ai e ndjen tingullin saktësisht ashtu siç është, të mprehtë e të qartë. Kështu ka qenë qysh prej krijimit të njeriut.

Deri tani, asnjë aparat i bërë nga njeriu, pamor a zanor, nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm me të dhëna shqisore siç janë syri dhe veshi. Sidoqoftë, përsa i përket shikimit dhe dëgjimit, një e vërtetë shumë më e madhe ndodhet përtej gjithë kësaj.

Kujt i përket ndërgjegja që sheh dhe dëgjon brenda trurit?

Kush shikon një botë joshëse në tru, dëgjon simfoninë dhe cicërimën e zogjve, dhe nuhat trëndafilin?

Ngacmimet që vijnë nga sytë e një njeriu, veshët, dhe hunda kalojnë tek truri si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë, dhe biokimisë, mund të gjeni mjaft hollësi se si formohet kjo figurë në tru. Gjithësesi, nuk do të ndeshësh kurrë me faktin më të rëndësishëm: Kush i percepton këto ngacmime nervore elektro-kimike si figurë? Ka një ndërgjegje në tru që e percepton krejt këtë pa ndjerë aspak nevojë për një vesh, sy apo hundë. Kujt i përket kjo ndërgjegje? Doemos, kjo nuk i takon nervave, shtresës së dhjemit, dhe neuronet që përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse materialistët darvinistë, të cilët besojnë

se gjithçka përbëhet nga materia, nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Zotit, të cilit nuk i duhen as sy për të shikuar pamjet, as veshë për të dëgjuar tingujt. Veç kësaj, nuk i duhen tru për të menduar.

Secili që e lexon këtë fakt të veçantë dhe shkencor duhet të mendojë mbi Zotin e Plotfuqishëm, dhe t'i frikësohet e të kërkojë mbrojtje tek Ai, sepse ai e shtrydh krejt gjithësinë në një vend të zi pisë të vogël sa pak centimetra kubë në formë 3-dimensione, me ngjyrë, hije dhe të shkëlqyer.

Një besim materialist

Të dhënat që kemi paraqitur gjer tani na tregojnë se teoria e evolucionit është në kundërshtim me gjetjet shkencore. Pretendimet e teorisë në lidhje me origjinën e jetës është në mospërputhje me shkencën, mekanizmi evolucionar që ajo propozon nuk ka fuqi evolucionare, dhe fosilet demonstrojnë se format e domosdoshme të ndërmjetme nuk kanë ekzistuar kurrë. Kështu, rrjedhimisht del se teoria e evolucionit duhet të shtyhet mënjatë si një ide joshkencore. Kështu janë hequr mjaftë ide nga agjenda e shkencës, të tilla si modeli i gjithësisë me qendër Botën, jashtë nga agjenda e shkencës përgjatë gjithë historisë.

Megjithatë, historia e evolucionit është mbajtur në agjendën e shkencës. Disa njerëz madje mundohen ta paraqesin kritikën kundër saj si një *sulm mbi shkencën*. Pse?

Arsyeja është se kjo teori është një besim dogmatik i domosdoshëm për disa qarqe. Këto qarqe i janë përkushtuar verbërisht filozofisë materialiste dhe të përshtasin Darwinizmin sepse ky është i vetmi shpjegim materialist që mund të parashtrohet për të shpjeguar punët e natyrës.

Është mjaft interesante, ata gjithashtu e pranojnë këtë fakt herëpashere. Një gjenetist i mirënjohur dhe një evolucionist i zëshëm, Riçard C. Levontin (Richard C. Lewontin) nga Unversiteti i Harvardit, e pranon se ai është *së pari dhe mbi të gjitha një materialist dhe pastaj një shkencëtar*.

Nuk është se metodat dhe institucionet e shkencës diqysh na detyron neve të pranojmë një shpjegim material të botës fenomenale, por, përkundrazi, që ne jemi detyruar prej mbështetjes apriori të kauzës materiae për të krijuar një aparat hetimi dhe një seti konceptesh që prodhojnë shpjegime materiale, sado zhgënjyese, sado shastisëse për të papërvojët. Për më tepër, që materializmi është absolut, që ne të mos lejojmë një Këmbë Hyjnore në derë. (19)

Këto janë thënie të posaçme që darvinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë vetëm për hir të mbështetjes ndaj materializmit. Kjo dogmë mbron se nuk ka qenie përveç materies. Prandaj, argumenton ajo, materia e pajetë, pa ndërgjegje ka krijuar jetën. Ajo këmbëngul se milionat e

specieve të gjalla të ndryshme (siç janë zogjtë, peshqit, xhirafat, tigrat, insektet, pemët, lulet, balenat, dhe qëniet e gjalla) zunë fill si rezultat i një ndërveprim ndërmjet materies si rënia e shiut, vetëtimat, e kështu me radhë, prej materieje të pajetë. Kjo është një normë në kundërshtim si me arsyen dhe me shkencën. Dhe prapë darvinizmi vazhdon ta mbrojë atë që të mos lejojë *Këmbë Hyjnore në derë*.

Cilido që s'e sheh origjinën e qënieve të gjalla me një paragjykim materialist do ta vërejë këtë të vërtetë të dukshme. Të gjitha qëniet e gjalla janë vepra të Krijuesit, i cili është i Plotfuqishëm, i Gjithëdituri, më i Urti. Ky Krijues është Zoti, i cili krijoi krejt gjithësinë nga hiçi, i dha asaj formën më të përsosur, dhe krijoi të gjitha qëniet e gjalla.


TEORIA E EVOLUCIONIT: MAGJIA MË E FORTË NË BOTË

Cilido i çliruar nga paragjykimi dhe nga ndikimi i çdo ideologjie të posaçme, i cili përdor vetëm logjikën dhe arsyen e tij apo saj, do ta kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, e cila të sjell në mendje bestytnitë e shoqërive pa njohuri mbi shkencën ose qytetërimin, është krejt e pamundur.

Ashtu siç u shpjegua më lart, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një kade të madhe mund të prodhojnë të menduarit, profesorë arsyetues dhe studentë universiteti, shkencëtarë të tillë si Ajnshtajni dhe Galileo, artistë të tillë si Humfri Bogart, Frank Sinatra dhe Luçiano Pavaroti, sikurse antilopët, pemët e limonit dhe karafilat. Për më tepër, sikurse shkencëtarët dhe profesorët që besojnë në këtë dokërr janë njerëz të arsimuar, është fare e justifikueshme të flasësh për këtë teori si *magjia më e fortë në histori*. Kurrë më parë nuk ka mundur ndonjë besim apo ide t'i heqë fuqitë e arsyes së njerëzve, t'i ndalojë ata të gjykojnë me mend në kokë, dhe t'u fshehin atyre të vërtetën sikur t'u jenë zënë sytë me shami. Kjo është edhe më keq akoma, dhe verbëri e pabesueshme, sesa egjyptianët që adhuronin Zotin Diell Ra, adhuresit të totemit (atij të cilit i jep qëllimin, kuptimin dhe qënien – ship) në disa pjesë të Afrikës, njerëzit e Sabës që adhurojnë Diellin, tribuja e Abrahamit (pqmt) që adhuronin idhujt e bërë vetë nga

ata vetë me dorë, ose njerëzit e Moisiut (paqmt) që adhuronin Viçin e Artë.

Ne e jetojmë krejt jetën tonë në tru. Njerëzit që shohim, lulët që nuhasim, muzika që dëgjojmë, pemët që shijojmë, lagështinë që ndiejmë me duart tona – të gjitha këto përshtypje bëhen «realitet» në tru. Por aty nuk ka ngjyra, zëra apo figura. Ne jetojmë në një mjedis impulseesh elektrike. Kjo nuk është teori, por shpjegimi shkencor se si e kuptojmë ne botën e jashtme.



Zaten, Zoti ka folur për këtë mungesë arsyeje në Kur'an. Në mjaft sure, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishëm të shohin të vërtetën. Disa nga këto sure janë si më poshtë:

Përsa u përket atyre që nuk besojnë, atyre nuk u bën përshtypje, si t'i paralajmërosh ose jo, ata do të besojnë. Zoti ua ka vulosur zemrat dhe dëgjimin dhe sytë u janë errësuar. Ata do të kenë një ndëshkim të tmerrshëm. (Kur'ani, 2: 6-7)

... Ata kanë zemra me të cilat nuk ndejnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shikojnë. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Njerëz të tillë janë si shtazë. Jo, ata janë akoma edhe më të larguar nga rruga! Ata janë të pavetëdijshëm. (Kur'ani 7:179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim një derë në parajsë, dhe ata e kalojnë ditën duke u ngjitur në të, ata vetëm do të thonë: Shikimi na është trullësuar! Ose më mirë të na kishte zënë një magji! (Kur'ani, 15:14-15)

Fjalët nuk e shprehin dot sa e habitshme është që kjo magji të mbajë një bashkësi të gjerë në skllavëri, t'i mbajë njerëzit larg së vërtetës, dhe të mos priset për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz mund ta besojnë një skenar të pamundshëm dhe pohime plot marrëzira e gjepura. Megjithatë, *magjia* është i vetmi shpjegim i mundshëm për njerëzit nga e gjithë bota që beson se atomet e pajetë dhe pa ndërgjegje, befas vendosën të mblidhen bashkë dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem pa të meta në organizim, disiplinë, arsye dhe ndërgjegje, një planet i quajtur Tokë, me të gjitha veçoritë e saj aq përsosmërisht të përshtatura, dhe qëniet e gjalla plot me sisteme të panumërta të ndërlikuara.

Në fakt, Kur'ani tregon një ndodhi të Moisiut (pqmt) dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët mbështesin filozofitë ateiste, zaten, ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur Faraonit i treguan për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Moisi (pqmt) që të takohet me magjistaret e vet.

Kur Moisiu (pqmt) takoi me ta, ai u tha atyre të shfaqin aftësitë e tyre përpara. Sureja vazhdon:

Ai tha: «Ju hidhni». Kur hodhën ata, ata hodhën një magji në sytë e njerëzve dhe bënë që ata të ndjejnë frikë të madhe prej tyre. Ata prodhuan një fuqi tejet të fuqishme. (Kur'ani, 7:116)

Siç e kemi parë, magjistarët e Faraonit patën aftësi t'i mashtrojnë të gjithë, përveç Moisiut (pqmt) dhe atyre ë besonin tek ai. Megjithatë, prova e tij e prishi magjinë, ose e gëlltitën atë që ata kishin sajuar, siç e thotë sureja:

Ne i thamë Moisiut: «Hidhe purtekën tënde poshtë». Dhe kjo menjëherë e gëlltit atë çka ata kishin sajuar. Kështu e vërteta zuri vend dhe ajo çka ata bënë tregoi se ishte e rremë. (Kur'ani 7:117-118)

Siç mund ta shikojmë, kur njerëzit e kuptuan se atyre u qe bërë magji, dhe se ajo çka ata panë ishte një iluzion, magjistarët e Faraonit e humbën krejt kredibilitetin. Edhe në ditët e sotme, përveç atyre nën ndikimin e së njëjtës magji, njerëzit besojnë në këta pohime qesharake nën maska shkencore dhe e kalojnë jetën e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin bestytnitë e tyre, ata gjithashtu poshtërohen kur e vërteta e plotë del dhe magjia priset. Në fakt shkrimtari dhe filozofi britanik i njohur në gjithë botën Malkom Mugerixh (Malcolm Muggeridge), i cili ishte një ateist që e mbrojti evolucionin për 60 vjet, por i cili më pas

e kuptoi të vërtetën, zbulon pozicionin në të cilin teoria e evolucionit do ta gjente veten në të ardhmen e afërt në këto kushte.

Unë vetë jam i bindur se teoria e evolucionit, sidomos shkalla në të cilën ajo është zbatuar, do të jetë një shaka e fortë në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen që një hipotezë aq e kotë dhe e dyshimtë mund të pranohej me aq lehtëbesim të pabesueshëm siç ka ndodhur. (20)

Ajo e ardhme nuk është shumë e largët. Përkundrazi, së shpejti njerëzit do të shohin se *rastësia* nuk është perëndi, dhe do të shohë pas në teorinë e evolucionit si mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tanimë ka filluar të hiqet me shpejtësi nga shpatullat e njerëzve anembanë botës. Mjaft njerëz të cilët e shohin fytyrën e vërtetë të saj po pyesin me habi se si ka mundur vallë që ata të ishin tërhequr ashtu prej saj.

**Ata (engjujt) thanë «Ti qofsh i lëvduar! Ne nuk kemi dijeni përveç çka ju na keni mësuar. Ti je i Gjithëdituri, më i Mençuri»
(Kur'ani, 2:32)**

Legjenda dhe shpjeguese:

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darwin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, New York, p. 127.
8. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record," *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.

12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, New York, 1983, p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt," *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Walker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, p. 19.
19. Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World," *The New York Review of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43.

KAPAKU I PASËM

Në shekullin e 19, kur u shfaq teoria e evolucionit, niveli i shkencës dhe teknologjisë ishte vetëm primitive. Kjo bëri që përkrahësit e teorisë të mbronin se organizmat e gjallë kishin një strukturë të thjeshtë. Për shembull, Ernst Haeckel, përkrahësi më i madh i Darvinit, besonte se qeliza ishte një bungël e thjeshtë e vogël kombinimi albuminoz karboni, jo shumë e ndryshme nga një grimcë mikroskopike xhelatini. Autorët e teorisë besonin se ngaqë jeta ishte e përbërë prej një strukture të thjeshtë, ajo mund të ishte bërë vetëvetiu, rastësisht. Por ata ishin gabim, doemos...

Gjatë 150 vjetëve të fundit, si shkenca dhe teknologjia kanë hedhur hapa gjigandë. Shkencëtarët kanë zbuluar strukturën e vërtetë të asaj çka Haeckel e përshkruante si një bungël e vogël e thjeshtë. Ata janë habitur të shikojnë se qeliza nuk është aspak aq e thjeshtë sa ç'besohej dikur, por përmban një numër sistemesh papërfytyrueshmërisht të ndërlikuara të cilët kurrë nuk mund të silleshin dot në mend, e jo më të kuptoheshin, në kohën e Darvinit.

Ky libër paraqet mrekullinë e krijimit në qelizën e gjallë – një kryevepër në miniaturë. Ju do të shihni se si organelet brenda qelizës, së bashku me enzimën, proteinat dhe substancat e tjera që ajo prodhon, të kryejë funksione qëllimplota që kurrë nuk mund të prisje prej tyre. Do të lexoni shembuj të bukalisht trilionave qelizave që gjenden në trupin e njeriut, çdonjëra prej së cilave shfaq inteligjencë dhe dituri mbinjerëzore. Edhe njëherë, ju do të dëshmoni se si e gjitha kjo nuk mund të jetë një rastësi e pandërgjegjshme, por një produkt i fuqisë supreme, mençurisë dhe mjeshtërisë të Zotit.

Ndërgjegje në qelizë – *harun jahja*

Libri u përfundua së përkthyeri më
5 Nëntor 2013
Në Durrës, Shqipëri.
Përktheu Halit Beka (Methasani)

Nuk lejohet përdorimi apo dhënia falas tërësisht apo pjesërisht e këtij libri, pa miratimin paraprak prej përkthyesit
Halit Beka (Methasani)
Përkundrazi, ligjet e rrepta Mbi të drejtë e autorit do të zbatohen mbi shkelësit e këtij ligji



Dy fjalë lexuesit nga
autori i shqipërimit.

HALIT BEKA
(METHASANI)

I dashur lexues:

M'u desh t'ju
drejtohem me nja dy
fjalë rreth vetes. Nuk
e pashë të udhës të
gjuaj për dikë që të
flasë në vetën e tretë
për mua, për të më
thur lavde e nxjerrë
në pah cilësitë që i
kam e s'i kam.

Jam nga fshati
Kodrasej i

Rrogozhinës. Kam mbaruar Shkollën e Mesme Mekanike
Bujqësore, dega Ndërtim, Shkozë, Durrës, 1977-1981.

Kam emigruar në SHBA më 1990 dhe qysh atëhere iu
futa mësimi të anglishtes që ta di si atë në rrugë edhe atë
në shkollë. Dhe them se ia arrita me mund. Kam punuar si
përkthyes/shoqërues nja 7 vjet për DASH. «Aventura» e
përkthimit të literaturës me volum më ka tërhequr
qyshkur, por nuk e ndieja veten të sigurt, gjersa një ditë i
hyra shqipërimit të disa poezive dhe prozës poetike të
poetit e filozofit libanez, Khalil Gibran. U mora kryesisht
me kryeveprën e tij, Profeti. Dhe, pa mburrje, them se kam

arritur të bëj diçka me të. Por sa më shumë lexoja dhe shqipëroja Profetin, aq më shumë më hynte dëshira për të përkthyer materjale me përmbajtje fetaro-spiritualiste. Kështu, një ditë, kur endesha rrugës Wayndote të qytetit Windsor të provincës Ontario të Kanadasë, më 2011, në vitrinën e një dyqani librash pashë të ekspozuar librin: «Jesus – the Prophet of Islam». Ishte kjo shkëndja që më tundoj t'i futem përkthimit të atij libri, pra, Jezusi – Profet i Islamit.

Pastaj, ashtu siç «oreksi vjen duke ngrënë», ishte «*Daxhali? – Qytetërimi Judeo Kristian*», pasoi dhe, «*Ndërgjegja në qelizë*» më nxiti edhe më shumë ta sjell para jush me kënaqësinë kurrë më parë të ndjerë. Falë Zotit që më ka dhënë vullnetin dhe aftësinë për ta përkthyer, e sjell në shqip këtë libër kaq të vyer.